

Allagjozovski për abuzimet

Përgjegjësi deri në fund

Fq.4



DËSHMIA E EKSPERTËVE

Rreziku i Selës nuk ka kaluar

Fq.5



Interi e merr me parametra zero

De Vrij

Fq.21



Koha

www.koha.mk



Monstra me shumë emra

Fq.17

EDITORIAL

Gjithologjia!



A mundet një njeri të jetë ekspert për shumëçka: edhe për politikë, edhe për ekonomi, edhe për kulturë, edhe për sport, edhe për korrije-shirje, edhe...edhe...

Dikush këtë "shkencë të gjithçkasesë" do ta shpjegojë me faktin se te ne mund të mungojnë ekspertët e fushave të caktuara, prandaj, si kompensim, na paraqiten njohës enciklopedik të çështjeve që fillojnë nga politika e mbarojnë te tredhja e mizave. Një tjetër mund të thotë se ka shumë individë që janë tretur nëpër labirinthe të politikës (nëpër borde e apanazhe) dhe...

Fq.2

RAJON

Qeveria e Kosovës tërheq demarkacionin nga Kuvendi

Fq.14

GLOBI

Ku përfundoi thesari i Gadafit?

Fq.15



PARLAMENTI I KTHEHET DINAMIKËS SË PUNËS

27 SHKURTI, DITA E GJUHËS SHQIPE?



Burime të sigurta parlamentare kanë thënë për gazetën KOHA se Ligji për gjuhët do të vihet në diskutim në lexim të tretë më 27 shkurt, por mund të ndodh që edhe një ditë përpara - më 26 shkurt të ketë diçka në këtë drejtim. Se Ligji për gjuhët është çështje ditësh, të martën e tha edhe lideri i BDI-së, Ali Ahmeti gjatë takimit me ambasadorin e Holandës, Vauter Plomp

Fq.3

Universitetet, fabrika diplomash

Shkup, 20 shkurt - Misioni i universiteteve nuk është vetëm të pajisë studentët me diploma dhe ti aftësojë ato për një profesion të caktuar. Ato nuk janë as vetëm për t'u marrë me shkencë dhe hulumtime. Përtej dimensionit arsimor dhe shkencor, universitetet duhet të kontribuojë edhe në zhvillimin socio-ekonomik të një vendi, respektivisht në gjenerimin e vendeve të reja të punës dhe në plotësimin e nevojave

që ka tregu i punës. Nëse nuk arrin ta bëjnë këtë, misioni i tyre ka dështuar, vërejnë profesorët universitar. Prof.dr.Avzi Mustafa, thotë se cilësia e gjithçkaje matet me rezultatin që jepet në fund. "Kështu është edhe me arsimim e lartë. Universitetet duhet t'u paraprijnë proceseve, të jenë pararendëse të zhvillimeve shoqërore, të nxisin zhvillimin ekonomik dhe të zgjerojnë tregun e punës. Me këtë matet..."

Fq.7



EDITORIAL

GJITHOLOGJIA!



Emin AZEMI

A mundet një njeri të jetë ekspert për shumëçka: edhe për politikë, edhe për ekonomi, edhe për kulturë, edhe për sport, edhe për korrije-shirje, edhe..edhe...

Dikush këtë "shkencë të gjithçkasë" do ta shpjegojë me faktin se te ne mund të mungojnë ekspertët e fushave të caktuara, prandaj, si kompensim, na paraqiten njohës enciklopedik të çështjeve që fillojnë nga politika e mbarojnë të tredhja e mizave. Një tjetër mund të thotë se ka shumë individë që janë tretur nëpër labirintet e politikës (nëpër borde e apanazhe) dhe duke qenë argatë të politikës, ata e kanë vështirë ta thonë mendimin e tyre kompetent (kuptohet, nëse e kanë). Por, ka edhe të atillë që mendojnë se jo që mungojnë njerëz të ditur te ne, por atyre iu mungon guximi (kurrizi) qytetar për të shprehur publikisht një mendim, i cili dikujt mundet të mos i pëlqejë. Në këtë grup bëjnë pjesë edhe individë që janë "kandidat potencial" për ndonjë angazhim dhe oportuniteti publik (e jo ndonjë meritë profesionale) është garanca e vetme që iu siguron atyre të jenë burokrat të ndonjë institucioni.

"Suma sumarum" do të thoshim se mendimi publik (me përfshirje) te ne vuan pasojat e një paqëndrueshmërie intelektuale, morale, e pse jo edhe qytetare. Dikush do ta kuptonte mbrapsht këtë konstatim, nëse nuk i ndajshohen edhe shkaqet që e kanë sjellë mendimin tonë publik në këtë gjendje. Parasegjitash, do të ishte gabim të fajësohen intelektualët, ata që janë (dhe janë pak), nëse nuk studiohen pak a shumë rrethanat në të cilat vepron ata. Pastaj, do të ishte luks i madh të pretendojmë se me këtë traditë të shkurtër arsimimi (universitar) këtu në Maqedoni, do të arrijmë majat e mendimit publik e shkencor, me sens konkurrues me të tjerët, për çështje e fusha të caktuara. Dhe, krejt i veçantë na paraqitet një problem që ka të bëjë me mendimtarët që gdhihen si intelektualë shqiptar e ngrysen si maqedonas. Krejt kjo dikotomi rrethanash e faktorësh e bëjnë të pamundur "kondenzimin" e mendimit publik (që rezonon shqip) në qarqe e institucione të caktuara dhe për pasojë - mungesa e elitës intelektuale na paraqitet si produkti më deficitar i shoqërisë sonë.

Por, nuk janë pa faj edhe vetë intelektualët (ata pak që janë), të cilët nuk arritën të organizohen në një mekanizëm veprues që do ti vinte në lëvizje idetë e tyre. Mund ta marrim me mend edhe përgjigjen e tyre, por nuk është vonë të provohet, të paktën prezencën e tyre të shpërndarë ta përqendrojnë në një FORUM a INSTITUT, i cili do të detektonte, në radhë të parë të kualifikuarit e fushave të caktuara dhe pastaj do të hartonte një Program aksional, me tema e ide konkrete, afatshkurtra e afatgjata.

Tani, kur po jetojmë në një "fshat global", ku komunikimi nuk paraqet kurrfarë problemi, do të ishte e pafalshme që mendimin tonë publik të mos e menaxhojmë brenda mekanizmave adekuatë veprues dhe në funksion të prishjes së kësaj skeme të rrejtshme që e ka krijuar politika se vetëm ajo është kompetente të flet për çështje madhore. Në kuadër të këtij menaxhimi gjithësesi nuk do të duhej të mungonte edhe "inventarizimi" i potencialit shkencor e akademik me prejardhje nga hapësira shqiptare e Ballkanit që ndodhet në shtetet e ndryshme të botës, i cili pa mëdyshjen më të vogël do të pranonte të jetë pjesë e ndonjë mekanizmi veprues këtu në Maqedoni, duke ofruar përvojat dhe dijet e tyre të avancuara që tash më po i zbatojnë nëpër klinika, institute, zyra avokati, studio projektimi e laboratore të ndryshme të botës.

Një popull që e ka gjithë këtë potencial nëpër botë dhe nuk e angazhon për projekte e ide të caktuara, është i destinuar të nënshtrohet dhe nënçmohet ndaj atyre që prej balte mundohen të nxjerrin quadro e histori të shpifura. Vetëm ky mund të jetë ilaçi që do të asgjësonte gjithologët e lagjeve tona që po na e zënë frymën.

NIMICI I "FORMULAVE"AFRIKANE..!

"Zgjojemi e pyesim këto ditë,ky "negociatori" Metju Nimic që nisi gjoja t'i pajtojë dy fqinj gërnjare të kotshëm për "riemërimin" e Maqedonisë dhe ka qitur fjalën se është në rrugë për t'i pajtuar duke i bërë bashkë kundër shqiptarëve,ashtu edhe si kanë qenë gjithherë, ka ndërruar ,vallë,pak mendje,ka nisur ,vallë, të lexojë ndonjë libër për ne shqiptarët dhe Evropën, se me njato propozimet e fundit doli që, si "negociator" më shumë di për syrin e majtë te tij afrikan se sa për syrin e tij të djathtë evropian, ndaj e ka marrë gabueshëm që neve na hamendëson të vdektë e të përgjunjur me dashje në tokën tonë dhe nuk na vë në hesap se "negocimin" e tij me sherre fqinjësh kundër shqiptarëve mund t'ia shpallim si hesap pa hanxhiun,qe vjen me thënë, t'ia çojmë për lesh dhe t'i humbë edhe "buka" e negociimeve të radhës ndërmjet dy fqinjëve në kumet e Afrikës nga i merr pakuptueshëm për Ballkanin "formulat e zgjidhjeve"...!", shkruan në profilin e tij në Facebook, publicisti Nijazi Muhamedi.

PSE VETON SURROI "KORRIGJON" AHTISARIN?

"Në shkrimin e tij të fundit flamurit të Kosovës, Veton Surroi i referohet si flamur shtetëror (të paligjshëm). Veton Surroi mund të jetë ndër të rrallët që ka lexuar Planin e Ahtisarit, për me tepër në origjinal, sepse e njëj anglishten. Por megjithëkëtë në gjithë këtë shkrim ai e anashkalon atë se çfarë shkruan Ahtisari për flamurin: 1.7 Kosovo shall have its own, distinct, national symbols, including a flag, seal and anthem... (Kosova duhet të ketë simbolet e veta të dallueshme kombëtare, përfshi flamurin, stemën dhe himnin...). Pra Ahtisari bënë fjalë për FLAMUR KOMBËTAR TË KOSOVËS. A thua pse Veton Surroi parapëlqen t'i referohet Kushtetutës së Kosovës, e cila i është shmangur Pakos së Ahtisaarit duke zëvendësuar fjalën 'national' (kombëtar) me 'state' (shtet, shtetëror) edhe pse këto nuk janë sinonime. Article 6 [Symbols] 1. The flag, the seal and the anthem are the state symbols of the Republic of Kosovo. E Veton Surroi e di se nëse ka shpërputhje mes Ahtisarit dhe Kushtetutës, vlen Ahtisari dhe jo Kushtetuta. Pra, pse Veton Surroi i referohet Kushtetutës e jo Ahtisarit në këtë pikë shpërputhjeje?", shkruan në profilin e tij në FB, publicisti Nexhmedin Spahiu.

RUGOVA, VIZIONARI I PASHOQ

"Ibrahim Rugova. Edhe pse sa ishte gjallë nuk kam qenë votues i pas luftës i tij, më duhet ta pranoj tani se ai ka qenë: Diplomati e rrallë që nuk do të lind më në trojet shqiptare, që arriti ti përfiton zemrat e të gjithë liderëve botërorë dhe të njerëzimit deri në atë masë sa që NATO - ja bëri hapin të cilin se kishte bërë kurrë më parë! Dhe, ai kish qenë vizionar i pashoq dhe jam i befashuar se sa i saktë ka qenë kur iu ka treguar miqve të vetë se pse dikush nuk duhet të lejohet të vjen ndonjëherë në krye të Kosovës, hallall i qoftë! Sot kur vendi është izoluar i tëri duke u nisur nga koka e deri në çdo gjymtyrë dhe organ, po e shoh se sa i mungon Kosovës një njeri si Rugova (e kam fjalën solo Rugova pa familje)", shkruan në profilin e tij në FB, biznesmeni i njohur nga Kosova, Burim Piraj.

MEDIACitate

Ministri i Jashtëm i Rusisë, Sergei Lavrov, akuzoi Shtetet e Bashkuara dhe disa vende evropiane për nxitjen e tensioneve Lindje-Perëndim në Ballkan. Në një intervistë për agjencinë serbe të lajmeve Beta, Lavrov tha se vendet "anti-ruse" në Perëndim po i bëjnë shtetet e Ballkanit të zgjedhin midis Perëndimit dhe Rusisë, si kusht për t'iu bashkuar Bashkimit Evropian dhe NATO-s. Lavrov i tha transmetuesit serb N1 se detyrimi i vendeve të Ballkanit për të zgjedhur anë është "politikë shumë e gabuar" dhe se Rusia synon t'i mbajë interesat dhe lidhjet e saj me vendet si Serbia. Bashkimi Evropian, së voni, ka caktuar vitin 2025 si datë për pranimin e mundshëm të Serbisë dhe Malit të Zi në radhët e tij. Udhëheqësit e BE-së u kanë caktuar kushte të vështira dy vendeve, veçanërisht në vendosjen e sundimit të ligjit, garantimin e të drejtave themelore dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve territoriale rajonale, por nuk kanë nxitur hapur politika anti-ruse si kusht për anëtarësim. Serbia, në veçanti, ka vazhduar të ushqejë lidhje të ngushta me Moskën dhe ka thënë se nuk do t'iu bashkohet sanksioneve ekonomike të BE-së kundër Rusisë, për shkak të agresionit të saj në Ukrainë. Beogradi po ashtu nuk ka bërë përpjekje t'i bashkohet NATO-s, si vendet e tij fqinje Maqedonia dhe Mali i Zi, i cili i është bashkuar aleancës ushtarake vitin e kaluar. Politika neutrale ushtarake e Beogradit nuk është kundërshtuar haptazi nga udhëheqësit amerikanë apo evropianë. Vendet perëndimore, megjithatë, kanë ngritur dyshime për krijimin e një qendre të përbashkët humanitare Rusi-Serbi, në qytetin e Nishit, për të cilën zyrtarët perëndimorë dyshojnë se mund të përdoret nga Rusia për të fshehur spiunë dhe për të shpërndarë propagandë në Ballkan. Një ligjëvendës amerikan, i cili ka vizitur Serbinë vitin e kaluar, ka thënë se për të siguruar rrjedhën e investimeve nga Perëndimi, zyrtarët amerikanë duan të shohin indikacione se Serbia synon kah demokracitë perëndimore dhe kapitalizmi i tregut të lirë dhe anohet kundër agresionit që, fatkeqësisht, presidenti rus, Vladimir Putin, po demonstroi me Rusinë aktualisht.

(beta, 20 shkurt)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

SI ËSHTË QUAJTUR VENDBANIMI I SHQIPTARËVE NË MESJETË?

Emri mesjetar i vendbanimit të shqiptarëve, sipas burimeve bizantine, ka qenë Arbanon. Përmendet për herë të parë në shek.XI. Në fillim emërtimi Arbanon-Albanon shtrihet mbi viset në lindje e në verilindje të Durrësit dhe në perëndim të Ohrit e të Dibrës, duke përfshirë kështu bërthamën fillestare ku gjeografi aleksandrin Ptolemeu, në shek.II

vendos fisin ilir Albanoi, nga i cili mesa duket ka marrë emrin treva. Në shek.XI përmendet edhe peshkopata e Arbanonit, qendër e së cilës mendohet të ketë qenë Kruja. Në shek.XIV ky emërtim, duke u përgjithësuar, përfshiu treva të banuara nga shqiptarët që nga Tivari e Prizreni e deri në krahinat e Çamërisë.

PARLAMENTI I KTHEHET DINAMIKËS SË PUNËS

27 SHKURTI, DITA E GJUHËS SHQIPE?

Burime të sigurta parlamentare kanë thënë për gazetën KOHA se Ligji për gjuhët do të vihet në diskutim në lexim të tretë më 27 shkurt, por mund të ndodh që edhe një ditë përpara - më 26 shkurt të ketë diçka në këtë drejtim. Se Ligji për gjuhët është çështje ditësh, të martën e tha edhe lideri i BDI-së, Ali Ahmeti gjatë takimit me ambasadorin e Holandës, Vauter Plomp


Koha

Fatos RUSHIT

Shkup, 20 shkurt - Pas dy javë pauzë, Parlamenti iu kthye dinamikës së punës duke vazhduar seancën e 34-të me radhë për një sërë propozim-ligjesh me procedurë të shkurtuar dhe vendimesh tjera mes të cilëve edhe zgjedhja e nënkryetarëve të Parlamentit. Frosina Ramenski nga LSDM, Goran Mileski nga PRSD dhe Vesel Memedi nga RDK pritej të zgjidheshin nënkryetarët e rinj të Parlamentit të Maqedonisë, ndërsa VMRO edhe pse i takon me Rregulloren njëri nga nënkryetarët, nuk ka dhënë propozimet e saj për këtë post. Si zakonisht, në seancë plenare kishte problem me kuorumin ku u desh disa herë kryeparlamentari Talat Xhaferi të bëjë thirrje për hyrje të deputetëve në sallë. Siç pritej, Parlamenti nuk vazhdoi seancën e 32-të më radhe ku në rend dite është edhe Ligji për gjuhët, si dhe disa ligje nga sfera e gjyqësorit. Por në rrugë jozyrtare, burime të sigurta parlamentare gazetës KOHA i kanë thënë se Ligji për gjuhët do të vihet në diskutim në lexim të tretë më 27 shkurt, por mund të ndodh që edhe një ditë përpara - më 26 shkurt të ketë diçka në këtë drejtim. Deri atëherë, sipas këtyre burimeve, në rast se nuk ka ndonjë marrëveshje me VMRO-në për tërheqjen e amendamenteve, shumica parlamentare BDI-LSDM ka mundësi të hedh poshtë të njëjtat edhe përkundër vërejtjeve të presidentit Gjorge Ivanov ose të akumulojë diskutimet e 35 mijë amendamenteve në një apo në disa.

AHMETI: LIGJI PËR SHQIPEN, ÇËSHTJE DITËSH

Se Ligji për gjuhët është çështje ditësh kur edhe do të miratohet, të martën e theksoi edhe lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, gjatë takimit me ambasadorin e Holandës në Maqedoni, Vauter Plomp. "Ahmeti dhe ambasadori Plomp diskutuan për zhvillimet politike, kontestin e emrit, Ligjin për gjuhët si dhe për integrimin euroatlantik. Ahmeti elaboroi qëndrimet e BDI-së rreth negociatave për çështjen e emrit me Greqinë, të ndërmjetësuar nga Nimic. BDI inkurajon zgjidhje të shpejtë të këtij problemi të stërzgja-



LSDM NUK E PËRJASHTON ZGJERIMIN E KOALICIONIT ME PDSH DHE BESËN

Partia më e madhe në pushtet - LSDM, nuk përjashton mundësinë e zgjerimit të Koalicionit qeveritar edhe me dy partitë opozitare shqiptare, Besën dhe PDSH-në. Megjithatë negociata serioze në këtë drejtim, nga LSDM-ja paralajmërojnë pasi Qeveria të përfundojë punët me prioritet që ka. "Kur bëhet fjalë për interesin shtetëror, të gjitha opsionet janë të hapura, në këtë rast është i hapur opsioni i zgjerimit të Qeverisë. Konkretisht, opsioni i përfshirjes të Besës në pushtetin ekzekutiv është i hapur. Ndërsa nuk e

përjashtojmë as mundësinë e përfshirjes të PDSH-së", bëjnë me dije nga LSDM-ja. Mundësinë e zgjerimit të Qeverisë nuk e konfirmuan, por as e përjashtuan nga BDI-ja. Nga partia e integristëve thanë se momentalisht janë të fokusuar në realizimin e reformave dhe se nuk ka asgjë konkrete në këtë drejtim. Kryetari i sapozgjedhur i Lëvizjes BESA, Afrim Gashi, ka theksuar gatishmërinë për t'iu bashkëngjitur koalicionit qeveritar dhe paralajmëroi se për këtë do të negociojë me kryeministrin Zoran Zaev.

tur dhe mbështet plotësisht dialogun e drejtpërdrejt drejt zgjidhjes. Ahmeti përsëriti qëndrimin për Ligjin për gjuhët duke theksuar që miratimi përfundimtar është çështje ditësh dhe që të gjithë duhet të japin kontribut në rrumbullakimin e suksesshëm të pjesës normative të Marrëveshjes Paqësore të Ohrit", thuhet në njoftimin e BDI-së për media. Sipas këtij njoftimi, bashkëbiseduesit gjithashtu shkëmbyen opinione rreth punës së Parlamentit dhe ekzekutivit, me këtë rast, Ahmeti theksoi pritjet e tij më të mëdha në adresim të sfidave të përditshme. Por kundër që Ligji për gjuhët që të miratohet tani është shprehur deputeti i VMRO-së, Antonio Milloshoski. Gjatë në konferencë për shtyp në Parlament, ai hodhi idenë që Ligji për gjuhët të mund të prolongohet për disa muaj, ndërsa partia e tij VMRO ti jep përkrahje në këtë kohë ligjeve prioritare reformuese. "Vetë fakti që votojnë për 19 propozim-ligje në rendin e ditës me procedurë të shkurtuar, flet për diktat dhe për makineri votuese të LSDM-së dhe BDI-së. Në lidhje me Ligjin për gjuhët, ne i kemi të njohura qëndrimet tona se ai Ligj është kundër të gjitha procedurave parlamentare duke shkelur hapur Rregulloren e punës. Nuk mundet shumica të

anashkalojë amendamentet tona, sipas Rregullores duhet për çdo amendament të hapet diskutim", tha Milloshoski. Në pyetjen e gazetarëve nëse ky është bllok total i punës së Parlamentit për ligjet reformuese, sidomos pjesa me 35 mijë amendamentet, Milloshoski përsëriti se mund të pranojnë të marrin pjesë në seancë plenare për të votuar ato ligjet reformuese në rast se Ligji për gjuhët prolongohet për disa muaj. "Ne nuk jemi për bllokim, por Ligji për gjuhët nuk mund të kalojë ashtë siç kaloi dy herë. Jemi të gatshëm të kthehemi në seancë dhe të përkrahim ligjet reformuese në rast se shumica pranon prolongimin e Ligjit për gjuhët për tre apo më shumë muaj", tha deputeti i VMRO-së. I njëjti kritikoi

BDI-në dhe LSDM-në se duke ndërruar pikën e dytë të rendit të ditës për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të KSHZ-së, veprojnë në mënyrë anti-ligjore duke pamundësuar, siç tha Milloshoski, funksionimin e KSHZ-së për një kohë të gjatë.

GRUBI ZIHET ME ZENDELIN PËR KUORUMIN

Nga BDI, deputeti Artan Grubi i bëri apel VMRO-së që të heq dorë nga 35 mijë amendamentet e Ligjit të gjuhëve, të kthehet në Parlament dhe të ndryshojë qasjen. Por qëllimi kryesor i konferencës për shtyp të deputetit Grubi ishte kritika ndaj deputetëve të Lëvizjes BESA se po bllokojnë Parlamentin, duke mos marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit për zgjedhje dhe emërimet.

"Shpreh keqardhje që BESA nuk erdhi dhe nuk mundësuan punën e Komisionit për zgjedhje dhe emërimet që të zgjidhet Naser Ajdini për gjykatës dhe me këtë - të kompletet Gjykata Kushtetuese si dhe të zgjidhen dy anëtarë të Këshillit për prokurorë. Deputetët e BESËS nuk janë as në seancë plenare që të votojnë ndryshimet e Ligjit për ndërtim me qëllim të rregullohet vendkalimi kufitar Bellanoc-Staçiq. BESA vetëm deklarativisht angazhohet për reforma, ndërsa në fakt - frenon proceset", ka thënë Grubi nga pres qendra e Parlamentit. Sipas Grubit, janë duke ecur mirë negociatat e grupeve të punës mes VMRO-së dhe LSDM për ligjet reformuese, veçmas të Ligjit për mbrojtje të dëshmitarëve. Por me Grubin nuk u pajtua deputeti i Lëvizjes BESA, Fadil Zendeli, njëherësh dhe anëtar nga kjo parti në Komisionin për zgjedhje dhe emërimet. Ai tha se nuk mund të bëhet makineri votuese as i pushtetit dhe as i ndonjërit nga partitë opozitare. "Kur është dashur ti përkrahim, i kemi përkrahur. Shpesh në komisione edhe në seancë plenare i kemi bërë kuorumin kur kanë qenë në pyetje ligjet për reforma e jo për dëshirë të Artanit dhe BDI-së. Nuk mundem gjithmonë unë t'ua bëj kuorumin atyre. Nuk mundem unë ti bëhem makineri votuese askujt nga pushteti e aq më pak BDI-së, por edhe partive opozitare", theksoi deputeti Zendeli. Ndërkaq po kundër qasjes së deputetit Grubi ishte edhe deputeti nga Aleanca për Shqiptarët, Syrija Rashidi. "Ata nuk mund të flasin për ne se jemi kundër reformave, sepse ne ishim kur u desh për thelbin e reformave në Qeveri, ndërsa BDI hyri për t'ua mbrojtur nga reformat. Nëse është reformë vjedhja e fondeve në Ministrinë e Kulturës, ne nuk jemi për reforma. Nëse është reformë zëvendësimi i drejtorëve shqiptarë me ata maqedonas, ne nuk jemi për reforma. Nëse është reformë rikualifikimi i veprës në aksident komunikacioni të vogëlshmit Almir Aliut, ne nuk jemi për reforma", tha deputeti nga Aleanca për Shqiptarët, Syrija Rashidi.

ZAEV SOT TAKON MERKELIN

Kryeministri Zoran Zaev sot (e mërkurë) në Berlin do të takohet me kancelaren gjermane Angela Merkel. Takimi është në suaza të vizitës zyrtare të delegacionit qeveritar të udhëhequr nga Zaev në Gjermani. Pas takimit, ashtu siç kumtoi pres shërbimi qeveritar kancelarja Merkel dhe kryeministri Zaev do të kenë konferencë të përbashkët për shtyp. Gjatë vizitës në Berlin, Zaev është parashikur të takohet edhe me presidentin e Gjermanisë Frank Ualter



Shtajnmajer. Zaev do të mbajë edhe fjalim në zyrën qendrore të Fondacionit "Fridrih Ebert". Takimi i parë bilateral i kryeministrin Zaev me kancelaren gjermane Merkel u mbajt në Trieste, në korrik të vitit të kaluar, në margjinat e Samitit "BE-Ballkani Perëndimor". Merkel atëherë shprehu përkrahje për Qeverinë e re të Maqedonisë për vendosmëri për reformat thelbësore dhe për përcaktimin e integritetit të Republikës së Maqedonisë në BE.

Hiqen tabelat me emrin "Aleksandri i Madh"

Shkup, 20 shkurt - Ndërmarrja Publike "Rrugët e Maqedonisë" në terren i hoqën tabelat e komunikacionit me emrin e deritanishëm të autostradës "Aleksandri i Madh" në Korridorin 10, ndërsa të cilat sipas vendimit të Qeverisë duhet të zëvendësohen me të reja që do ta mbajnë emrin "Miqësia". Nga ndërmarrja publike për rrugë shtetërore informojnë se veçmë i kanë porositur 19-të tabelat e komunikacionit me emrin e ri. Furnizimi i tabelave të reja do të kushtojë 4.940.000 denarë. Me vendimin e Qeverisë, emër të ri mori edhe aeroporti i Shkupit, por ende nuk ka informata zyrtare konkrete për procedurën e ndërrimit të emrit "Aleksandri i Madh" në "Aeroporti Ndërkombëtar Shkup". "E ndjekim zhvillimin e ngjarjeve. Kur të marrim instruksione detajore nga Qeveria, për kryerjen e Vendimit, do të veprojmë sipas tre instruksioneve. Sipas instruksioneve do të rrjedhë edhe procedura për ndryshim të shenjës me emrin e aeroportit, që është aktiviteti i cili do të kërkojë realizimin e procedurave teknike adekuate, para se të ndodhë vetë faktori i ndryshimit", informuan kohë më parë nga TAV, koncesioneri i aeroporteve të Maqedonisë. Vendimi për riemërimin e autostradës dhe të aeroportit hyri në fuqi në datën 14 të këtij muaji, prej se ishte publikuar në "Gazetën zyrtare". Ndryshimi i emrave të autostradës dhe aeroportit, ashtu siç publikoi kryeministri Zoran Zaev pas takimit në Davos me homologun e tij grek Aleksis Cipras, është në shenjë të vullnetit të mirë dhe përmirësimit të marrëdhënieve me Greqinë. Emri i deritanishëm i autostradës "Aleksandri i Madh" përdoret që nga korriku i vitit 2008, ndërsa kjo ishte përcaktuar me vendimin e Qeverisë paraprake. Nga dhjetori i vitit 2006, sërish, gjithashtu me vendim të Qeverisë paraprake, aeroporti i Shkupit e mori emrin "Aleksandri i Madh".

ALLAGJOZOVSKI PËR PARADOKSET E PROGRAMIT 2018

PËRGJEGJËSI DERI NË FUND

Allagjovzovski ka shtuar se ministria ka kërkuar mendim edhe nga Antikorrupsioni dhe po ashtu është e hapur për të bashkëpunuar edhe me Prokurorinë publike dhe institucione të tjera nëse një gjë e tillë do të lipset

Koha

Evis HALILI

Shkup, 20 shkurt - Për të gjitha parregullsitë e konstatuara në Programin për financimin e projekteve me interes nacional, Ministria e Kulturës është e gatshme të ndërmarrë hapat e duhur për marrjen e përgjegjësive. Kështu ka deklaruar ministri i Kulturës, Robert Allagjovzovski i pyetur lidhur me rastet abuzive dhe parregullsitë në një sërë projektesh të miratuara në Konkursin vjetor. Allagjovzovski ka shtuar se ministria ka kërkuar mendim edhe nga Antikorrupsioni dhe po ashtu është e hapur për të bashkëpunuar edhe me Prokurorinë publike dhe institucione të tjera nëse një gjë e tillë do të lipset.

"Ne nuk fshehim asgjë dhe as nuk e shmangim përgjegjësinë. Thjesht i apelojmë edhe një herë të gjithë qytetarëve, të punësuarve nëpër institucione dhe jashtë tyre që në rast se janë në dijeni të çfarëdolloj shkeljesh, të na informojnë. Ne do të veprojmë sipas procedurave dhe ligjit", ka thënë

ministri. Duke folur për Konkursin, ai ka potencuar se transparencja ka qenë maksimale në këtë proces, duke publikuar shumat e kërkuara dhe ato të miratuara, subjektet që konkurruan dhe projektet fitues.

"Në këtë aspekt ne jemi plotësisht të hapur për bashkëpunim të mëtejshëm, edhe me opinionin, ashtu edhe me të gjitha institucionet kompetente. Gjithsesi, komisionet do të shqyrtojnë të gjitha ato projekte për të cilat do të vërtetohen parregullsitë dhe po ashtu do të merren edhe me rishqyrtimin e atyre projekteve për të cilat u nxorën në opinion. Disa projekte janë tërhequr dhe ne jemi maksimalisht të disponuar që të gjitha parregullsitë t'i korrigojmë", ka thënë ministri.

Më të stuhishme janë reagimet për shkak të mjeteve të ndara nga bashkëpunëtorët e ngushtë të Kabinetit të sekretarit shtetëror, Valmir Aziri, por Allagjovzovski në konferencë për shtyp tha se nuk mund të përgjigjet për projekte individuale dhe për të

gjithë ata vlen qëndrimi se janë të hapur të pranojnë njoftim për çfarëdo qoftë parregullsisht.

"Maksimalisht jemi të hapur dhe ndërmorëm hap të guximshëm sepse i publikuam edhe emrat e fituesve, dhe mjetet e ndara dhe të kërkuara. Nuk fshehim asgjë, as i shmangemi përgjegjësisë. Jemi të disponuar dhe bëjmë thirrje deri te të gjithë qytetarët dhe të punësuarit në institucionet dhe jashtë tyre, nëse kanë njohuri për çfarëdo qoftë parregullsisht të na njoftojnë. Ne do të veprojmë në pajtim me procedurat dhe ligjet", përsëriti Allagjovzovski.

Lidhur me vërejtjet paraprake të anëtarëve të komisioneve dhe refuzimin e anëtarit të Komisionit të muzikës për të nënshkruar listën me projekte fituese për shkak të parregullsisht, Allagjovzovski pohon se nuk është vënë në dijeni.

"E kam ditur që mes anëtarëve në komisione mund të ketë pasur mosmarrëveshje, por se nuk ka nënshkruar rezultatet me projektet fituese, por as edhe se

listat janë kontestuese, nuk më kanë informuar", ka sqaruar Allagjovzovski. Deklaratat e ministrit janë bërë gjatë prezantimit të Strategjisë për zhvillimin e kulturës, dokumentit të miratuar gjatë seancës të së martës në Qeveri. Me këtë Strategji të re të kulturës synohet demotropolizimi dhe decentralizimi i kulturës, si dhe akses i barabartë i të gjithë qytetarëve. Si disa prej pikave kryesore të planit aksionar që do të vihen në zbatim janë përshtetimi i procesit të decentralizimit të kulturës, mbrojtja e trashëgimisë dhe aktivitetit muzeal, e të tjera.

"Gjatë muajve të kaluar ndryshuam katër ligje, ndaluan rrënimin e trashëgimisë kulturore, i pamundësuar privilegjet klienteliste dhe ndërpreme derdhjen e fondeve për Projektin Shkupi 2014", ka thënë ministri. Strategjia për zhvillimin e kulturës është hartuar nga një grup pune disa muaj më parë dhe përpara miratimit në Qeveri u prezantua në disa debate publike.

Optimist se do të gjendet zgjidhje deri në Samitin e NATO-s është edhe kryeministri i Maqedonisë Zoran Zaev, i cili në një intervistë për radiostacionin austriak ORF, thotë se beson që me sukses do të përfundojnë negociatat në korrik

INTENSIFIKOHEN NEGOCIATAT, KOXIAS VJEN NË SHKUP

paralajmërimeve për ardhjen e shefit të diplomacisë greke Nikos Koxias në Maqedoni. Nga Ministria e Punëve të Jashtme të Maqedonisë për MIA-n kumtuam se Koxias do të vijë në Shkup deri në fund të shkurtit apo në fillim të marsit, e jo siç paralajmëruan paraprakisht mediat greke, gjatë kësaj jave. Si arsye për prolongimin e vizitës në Shkup theksohen agjendat e dendura dhe tashmë të dakorduara paraprakisht të dy ministrave, Nikolla Dimitrov dhe Nikos Koxijas.

Paraprakisht televizioni grek

"Alfa" publikoi se shefi i diplomacisë greke në ditët në vijim do të vijë në Shkup. Në një kronikë në edicionin qendror të lajmeve, gazetarja duke iu referuar burimeve të televizionit, thotë se fillon java kyçe për negociatat, ndërsa Koxias homologut të tij nga Maqedonia do t'ia dorëzojë propozim marrëveshjen që e përpilon pala greke. Optimist se do të gjendet zgjidhje deri në Samitin e NATO-s është edhe kryeministri i Maqedonisë Zoran Zaev, i cili në një intervistë për radiostacionin austriak ORF, thotë se beson që me sukses do të

përfundojnë negociatat në korrik. Kryeministri thekson se hyrja e Maqedonisë në NATO, është më se e sigurt, nëse gjendet zgjidhje për kontestin. "Kemi thirrje automatike, që do të thotë se anëtarët e NATO-s do të fillojnë me ratifikimin e inkuadrimin tonë, pasi që ne dhe Greqia do të njoftojmë se kontesti është zgjedhur", thotë Zaevi.

Sipas ish ambasadorit gjerman në SHBA dhe kryesuesit aktual me Konferencën e Sigurisë të Munihut Wolfgang Ishinger, rruga e Maqedonisë drejt BE-së dhe NATO-s është dashur shumë më herët të

zhbllokohet. "Rruga e Shkupit drejt BE-së dhe NATO-s duhet të zhbllokohet. Kjo është dashur shumë herët të bëhet", shkroi Ishinger në profilin e tij në Twitter. Optimizëm i arsyeshëm për të gjetur zgjidhje për emrin shpreh edhe ish ambasadori grek në Maqedoni, Jorgos Kaklikis, i cili gjatë një bisede për CNN.GR, përkujton periudhën kur ka qenë ambasador në Maqedoni dhe momentin kur në vitin 2001 të dy vendet kanë qenë një hap afër zgjidhjes pasi qeveria greke ka ngritur nismë për negociatat në Shkup.

Shkup, 20 shkurt - Po intensifikohen negociatat në nivel ministror për zgjidhjen e kontestit të emrit pas

EKSPERTËT DËSHMOJNË PËR DHUNËN NDAJ KREUT TË ALEANCËS PËR SHQIPTARËT



Eksperti i dytë profesional i Institutit për mjekësisë ligjore, Verica Popovska, në dëshminë e dhënë para Trupit gjykues tha se lëndimet e rreth syrit të djathtë të të dëmtuarit, gjegjësisht kafkës të asaj pjesë të kokës, edhe më tej paraqesin rrezik për jetën e tij

RREZIKU I SELËS NUK KA KALUAR

Koha

Omer XHAFERI

Shkup, 20 shkurt - Lëndimi i indit të trurit është plaga më rëndë dhe më serioze, të cilën kreu i Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela, e ka pranuar gjatë sulmit të 27 prillit që ndodhi në Parlament. Personat ekspertë, të angazhuar si dëshmitarë nga Prokuroria Publike, të martën para Trupit gjykues kanë theksuar se këto lëndime nënkuptojnë shtypje të trurit, e cila në masë të madhe e ka rrezikuar jetën e deputeti Sela. Dëshmitari i parë, Zdravko Çakar, ndryshe pjesë e ekspertizës mjekësore për lëndimet e Selës, mes tjerash ka thënë se lëndimet janë shkaktuar në anën e djathtë të kafkës së kokës së Selës, me çka rreth saj është krijuar një ënjtje. Gjatë paraqitjes së analizave nga ekspertiza e lëndimeve të të lënduarit, Çakar tha se nga xhirimet e para, plagën nuk ka mundur ta lidh me ndonjë lëndim konkret, për shkak se aty shihet vetëm një segment i vogël i gjithë ngjarjes. Avokatët e dhjetëra të akuzuarve me këtë rast e kontestuan licencën e personit ekspert, e cila i është dhënë këtë vit, ndërkohë që ekspertiza është realizuar vitin e kaluar. Këtë kundërshtim të palës mbrojtëse e ka refuzuar Trupi gjykues, me arsyetim se ekspertiza është kërkuar dhe

është dhënë nga Instituti i mjekësisë ligjore dhe jo nga personi fizik. Eksperti i dytë profesional i Institutit për mjekësi ligjore, Verica Popovska, në dëshminë e dhënë për rastin e Ziadin Selës, theksoi se lëndimet rreth syrit të djathtë të të dëmtuarit, gjegjësisht kafkës të asaj pjesë të kokës, edhe më tej paraqesin rrezik për jetën e tij.

"Ky lëndim është shkaktuar me veprim të drejtpërdrejtë të përdorimit të forcës. Zhvillimet kanë dëshmuar se këto lëndime të Selës në kokë kanë ndodhur përdërisa ai ka qenë i shtrirë në tokë apo kokën e ka pasur të mbështetur në mur. Në këtë rast, nëse koka nuk do të ishte e fiksuar, nuk do të ishte dëmtuar vetëm ana e djathtë e kafkës, por edhe indi i trurit të anës së pasme", sqaroi Popovska. Plagët e kësaj natyre, siç theksoi ajo, mund të shkaktohen edhe nga goditja me këmbë. Krahas këtyre lëndimeve, tomografia kompjuterike ka treguar se Selës i është thyer edhe nofulla me gjithë hundë dhe lëndime të tjera në fytyrë. Sipas dëshmisë së ekspertës Verica Popovska, në rast të ndërprerjes së terapisë, Ziadin Sela, mund të përballlet me sulme të epilepsisë.

Ndryshe, gjatë dhënies së dëshmisë, i dëmtuari Ziadin Sela para Gjykatës dhe vetë të akuzuarve, tha se pasojat e lëndi-

meve i ndjen edhe sot. Terapia mjekësore e përditshme dhe kontrollet e vazhdueshme, siç potencoi ai, janë rutinë të cilat rregullisht i ndjek, me qëllim të mos përkeqësimi të gjendjes shëndetësore të tij. Njëherësh, ai nënvizoi se nga goditjet e rënda dhe sulmi brutal, ka pësuar amnezion të plotë dhe nuk mban mend pothuajse asgjë, me përjashtim të çasteve kur është rrëzuar në tokë dhe kur kanë filluar ta godasin në kokë dhe trup. Lëndimet fizike dhe trupore paraqesin vetëm një pjesë të plagëve të cilat deputeti Ziadin Sela i ka marrë gjatë sulmit më 27 prill. Arsyeja se pse ai javë më parë kërkoi një dëmshpërblim në vlerë prej 30 milionë denarë (500 mijë euro) përfshihet edhe me lëndimet shpirtërore të të afërmeve të tij, gjegjësisht traumave të cilat ato i kanë marrë gjatë kohës kur Sela ka qenë i sulmuar dhe linçuar. Për këtë arsye, deputeti Sela, gjatë dëshmisë së para Gjykatës Penale të Shkupit tha se atij i është rrënuar dinjiteti, personaliteti dhe integriteti. Raportet e mediave dhe videot e prezantuara, ku shihej se si Selën e tërheqin zvarrë nëpër korridoret e Parlamentit, janë tregues i mjaftueshëm për këtë qëndrim të kreu të Aleancës për Shqiptarët.

Në tetë lokacione do të ndërtohen sisteme për ujitje

Shkup, 20 shkurt - Në gjashtë deri tetë lokacione me madhësi prej rreth 300 hektarë do të ndërtohen sisteme të vogla për ujitje përmes projektit të financuar nga Bashkimi Evropian. Me këto sisteme të cilat do të jenë me shpenzime të ulëta pritet të rritet konkurrenca në bujqësi, të ruhen të ardhurat në këtë sektor dhe të zbuten efektet negative nga ndryshimet klimatike. "Gjendja me sistemet për ujitje nuk është e kënaqshme. Në disa rajone sistemet për ujitje janë jofunksionale dhe të shkatërruara për shkak

se nevojitet rehabilitim urgjent, si dhe ndërtim i sistemeve të reja", theksoi ministri i Bujqësisë Ljupço Nikolovski, në prezantimin e sotëm të projektit. Nga Bashkimi Evropian theksojnë se sipas Bankës Botërore bujqësia është një nga sektorët më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve klimatike dhe se duhet të bëhet harmonizim i politikave bujqësore me këto ndryshime që të mbrohen nga rreziqet bujqësia dhe blegtoaria. "Pritet që për shkak të thatësirës, të gjitha rajonet bujqësore të goditen, që nënkupton humbje të

mëdha për bujqit. Një nga masat është të sigurohet qasje në ujitjen e rajoneve bujqësore të cilat do të goditen nga ndryshimet klimatike", theksoi Virve Vimpari, udhëheqëse në repartin për punë operative të delegacionit të BE-së në Shkup. Në kuadër të projektit është planifikuar të përpunohet dokumentacion në projektin për sistemet për ujitje për çka janë siguruar mjete në lartësi prej 1,7 milionë euro, ndërsa ndërtimi do të realizohet me mjetet tanimë të siguruar nga IPA programi 2015.

KRONIKË

Sigurimi dhunon nxënësin e shkollës

V.C. (49) nga Shkupi në Stacionin Policor Gazi Babë në orën 13 ka denoncuar se ditën e njëjtë rreth orës 13:00 para derës hyrëse të shkollës së mesme në bulevardin "Aleksandar Makedonski", i biri i tij 17-vjeçar është sulmuar fizikisht nga ana e P.L. (37), i punësuar në sigurimin e shkollës. P.L. e ka goditur minorenin dy herë me grushte në pjesën e stomakut dhe kokë. Me automjet privat 17-vjeçari është dërguar në Spitalin e Përgjithshëm të Qytetit "Shën Naumi i Ohrit", theksojnë nga MPB-ja. Punohet në ndriçimin e plotë të rastit.

Mashtron shitësin me bankënotë të falsifikuar

Të hënën mërkurë, 21-vjeçari nga Tetova me iniciale Sh.A ka denoncuar se deri më tani një person i panjohur rreth orës 22, në kioskën "Tobako", në të cilën ka qenë i punësuar, e lokalizuar në rrugën "Marshall Tito" në Tetovë, ka kërkuar të blejë cigare dhe ka paguar me një bankënotë prej 50 euro, ndërsa ai i ka kthyer 2000 denarë. Menjëherë shitësi ka vërtetuar se bankënota me të cilën ka paguar cigaret personi i panjohur ka qenë false dhe ka njoftuar pronarin e kioskës. Bankënota e falsifikuar është marrë për analizë dhe po ndërmerren masa dhe aktivitete për zbulimin e personit që këtë bankënotë e ka lëshuar në qarkullim, i cili sipas SH.A, ka pasur edhe bankënota të tjera nga 50 euro.

Sulmon nënën sepse nuk i dha para

57 vjeçarja me iniciale M.E të hënën mërkurë ka denoncuar dhunë familjare, të cilën e ka kryer djali i saj, 27-vjeçari me iniciale J.E. Sipas policisë, i denoncuar J.E nënës i ka kërkuar para, ajo i ka dhënë një shumë të caktuar, por pas një kohe të shkurtër ai ka kërkuar edhe 500 denarë të tjera. Pasi i ka thënë se nuk ka më, fizikisht e ka sulmuar duke e goditur në kokë dhe trup si dhe i është kërcënuar për jetën, më pas e ka lëshuar shtëpinë. Sipas rrëfimit të saj, djali një kohë të gjatë fizikisht dhe psikikisht e ka maltretuar dhe disa herë është denoncuar për dhunën që i ka shkaktuar nënës së tij.

Aksident në Tetovë me 5 të lënduar

Të hënën pasdite rreth orës 17.00, në fund të rrugës "Marshall Tito", në Tetovë, ka ndodhur një aksident komunikacioni në të cilin janë përfshirë dy automjete me targa të Tetovës, edhe atë një "Opel Corsa", të cilën e ka drejtuar 23 vjeçarja me iniciale S.A si dhe një "Rover", e drejtuar nga 38-vjeçari me iniciale E.R nga fshati Vicë. Në këtë aksident vozitësi i "Roverit" si dhe tre bashkudhëtarë në këtë veturë si edhe bashkudhëtarë i veturës Corsa për pasojë kanë marrë lëndime trupore dhe me anë të disa veturave tjera, janë dërguar në Spitalin e Tetovës nga ku pas marrjes së ndihmës mjekësore, janë lëshuar për mjekim shtëpiak. Sipas të dhënave fillestare nga ekspertiza e kryer në vendin e ngjarjes nga pjesëtarë të policisë nga Sektori për Punë të Brendshme, është mosmbajtja e duhur e distancës ndërmjet automjeteve, përdërisa dëmi i shkaktuar material vlerësohet që të jetë rreth 10 mijë denarë. (U.H)

Të dobët dhe të pambrojtur këta fëmijë kanë qenë gjah i lehtë për dhunuesi, kriminelët dhe endacakët

Shkup, 20 shkurt - Skandalet me personat e mitur në Shtëpinë për fëmijë me probleme sociale "25 Maji", në Shkup, nuk kanë të ndalur. Kësaj radhe siç, informon gazeta e përditshme "Nezavisen Vesnik", edhe dy vajza të mitura po ashtu janë zbuluar se janë shtatzënë. Njëra prej tyre procesin e shtatzënisë e ka ndërprerë, ndërsa tjetra ka refuzuar të abortojë dhe vazhdon të insistojë për lindjen e fëmijës. Deri më sot zyrtarisht nuk është konfirmuar se vallë edhe këto dy vajza të mitura janë keqpërdorur, ngjashëm siç ishte rasti me bashkëmoshataren e tyre, 13-vjeçare R.I. e cila ditë më parë abortoi. Drejtuesit e Shtëpisë për fëmijë "25 Maji" nuk kanë informuar se vallë ekzistojnë edhe vajza tjera të mitura, të cilat janë shtatzënë. Reagimet e shumta të mediave dhe opinionit ndikuan që drejtori i këtij institucioni, Stevço Sokolovski, të japë dorëheqje për arsye morale. Lidhur me këtë situatë, nga Prokuroria Themelore Publike edhe më tej heshtin dhe nuk përgjigjen për atë se, pse deri më sot nuk është ndërmarrë asnjë veprim për sanksionimin e dhunuesve, përderisa ndaj të njëjtave janë iniciuar kallëzime penale.

Sipas të përditshmes "Nezavisen vesnik", kaosit në "25 Maji" nuk i shihet fundi. Të dhënat shqetësuese nga ky institucion flasin për dështim të plotë të organeve kompetente, të cilët në vend se të kujdesen për fëmijët, të cilët nuk kanë prindër apo vijnë nga familje disfunktionale, të njëjtit janë lënë në mëshirë të fatit. Të dobët dhe të pambrojtur këta fëmijë kanë qenë gjah i lehtë për dhunuesi, kriminelët dhe endacakët. Lajmin për

VAZHDOJNË SKANDALET NË SHTËPINË "25 MAJI"

ASKUSH S'I MBRON FËMIJËT



shtatzëninë e dy vajza të mitura e kanë konfirmuar nga Spitali i Gjinekologjisë në Shkup, me çka kanë informuar se pranë kësaj klinike përcillet edhe shtatzënia e këtyre fëmijëve.

"Një fëmijë për të cilën mediat raportuan, si dhe për një tjetër, procesi i shtatzënisë është ndërprerë. Nga ana tjetër, vajza e tretë është e moshës 17vjeçare dhe refuzon të abortojë. Nga ana jonë procesi i ndërprerjes së shtatzënisë është bërë në mënyrë që këta fëmijë mos të kenë problem në të ardhmen, përderisa të njëjtat janë të

ngarkuar psikikisht", thonë nga Spitali i Gjinekologjisë.

Në shtëpinë mbikëqyrëse të fëmijëve të mitur "25 Maji" dhe "Ranka Millanoviq", janë të vendosur rreth 100 fëmijë. Punëtorët social të kontaktuar nga e përditshmjia "Nezavisen vesnik" japin informacione kontraktore për atë se çka në të vërtetë ka ndodhur pas dyerve të mbyllura në Çair dhe Maxhari. "Në të dyja këto shtëpi ekziston program i përshtatshëm, i cili funksionon me vite. Fëmijët vazhdimisht i përcjellin ligjëratat, gjatë çdo kohe i nënshtrohen

ndihmës psiko-sociale, janë të ushqyer, të veshur dhe mirëmbajtur. Edukatorët e duan punën e tyre, janë profesioniste dhe të përkushtuara. Mirëpo, përkëqësimi i kushteve ka ndodhur në kohën kur të dy këto institucione u bashkuan, djemtë dhe vajzat u bënë bashkë, dhe ka ndodhur që të pushojnë dhe flenë në dhoma të njëjta, të shfrytëzojnë tualet të njëjtë, dhe jo të ndara si më parë. Dhe kur në 'Ranka' i vendosën edhe endacakët, një pjesë e tyre i shkatërruan krevetet, dyert e hekurta i shisnin për hekur, gjegjësisht u merrnin ushqij-

min fëmijëve dhe i keqtrajtonin", theksojnë punëtorët social. Punëtorët të tjerë alarmojnë se situata në Shtëpinë "25 Maji", është situata edhe më keq se sa mund të pararendojë opinioni. "Vazhdimisht ka tentime për vetëvrasje, fëmijët i presin venat e tyre, nuk mund të përballojnë gjithë atë çka ju ndodhë. Po thuajse çdo të dytën natë ekipe të Ndhmës së Shpejtë reagojnë. Ekziston numër i madh i të zhdururve. Askush nuk mban llogari për hyrje-daljet, gjegjësisht kush me çka merret dhe me kë kontaktin. Kontrolli në hyrje fare nuk ekziston. Për këtë arsye, ka raste kur persona nga jashtë hyjnë dhe dalin lirshëm. Kadri i cili punon këtë shtëpi është jo i përshtatshëm. Një pjesë e të punësuarve kryejnë punë për të cilët nuk janë profesionist. Kjo ka rezultuar për shkak të shpërndarjes brutale të administratës. Rrogat e edukatorëve janë të mira për kushtet tona, mundet të thuhet edhe mbi mesataren. Por, rrallë kush pranon të punojë në këto institucione, edhe kështu kemi mungesë të kuadrit", kanë sqaruar bashkëbiseduesit e të përditshmes "Nezavisen vesnik".

MPPS I IK BALLAFAQIMIT, ZGJEDH KOMUNIKATAT

Në vend se të paraqiten me konferencë për shtyp, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka lëshuar një komunikatë për media, ku mes tjerash, e pranon faktin se rastet e fundit e kanë vërtetuar tezën se sistemi i mbrojtjes sociale është i devaluuar. Kjo posaçërisht mund të vërehet kur flitet për fëmijë me rrezik specifik. "Nevoja për një koordinim më të mirë mes institucioneve dhe vendosjen e një sistemi për kujdesin më të madh të fëmijëve me rrezik social, është i evident. Në drejtim të këtyre zhvillimeve, Ministria vazhdimisht punon në procesin e deinstitutionalizimit. Deri nga mesi i këtij viti do të fillojë transformimi i institucioneve për kujdesin e fëmijëve në rrjet të shtëpive më të vogla. Kjo reformë

do të mundësojë qasje individuale deri te çdo fëmijë, kujdes më të madh dhe ulje të rrezikut nga ngjarjet e kësaj natyre", thonë nga MPPS. Komisioni i formuar nga kjo ministri ka konstatuar se shërbimet profesionale dhe tutorët (kujdestarët e fëmijëve) e caktuar në disa raste i kanë alarmuar organet përgjegjëse për mundësitë e eksploatim seksual të vajzës 13-vjeçare. Nga kjo ministri nënvizojnë se janë duke u hetuar elementet tjera për mos veprimin e mundshëm të tutorit të fëmijës. "Jemi në pritje që MPB dhe Prokuroria të ndërmarrin masa në pajtim me kompetencat e tyre, me qëllim gjetjen dhe sanksionimin e personave që i kanë keqpërdorur viktimat e mitur", thonë nga MPPS.

KONTROLLIM ELEKTRONIK I FURNIZIMEVE PUBLIKE

Me flamuj të kuq kundër korrupsionit

Sipas Byrosë për Furnizime Publike, ligji i ri do të sjellë mbrojtje më të madhe nga korrupsioni, përgjegjësi për kompetentët që kanë kryer keqpërdorime si dhe kontroll të furnizimeve më të mëdha dhe me më shumë rrezik

dhe mund të jenë objekt i korrupsionit.

Me Propozim-ligjin e ri për furnizime publike parashikohen ndryshime të shumta për të tejkaluar dobësitë e konstatuara në sistemin për furnizime publike. Gjithashtu ndryshimet ligjore janë pjesë e rritjes së transparencës së harxhimit të të hollave publike dhe llogaridhënies më të madhe ndaj tatimpaguesve për të hollat që mbushin arkën e shtetit.

Ndryshimet e reja ligjore pritet të zvogëlojnë në minimum jologjikshmëritë e ndryshme të një ekonomie tregu që vite me radhë konstatohen në analizat e ndryshme, që vetëm e rrisin rrezikun nga manipulimet e mundshme në realizimin e tenderëve. Sipas raportit të fundit të Qendrës për komunikimi-

me qytetare që ka ndjekur furnizimet publike për periudhën janar-qershor 2017, çmimi më i ulët si kriter i vetëm për zgjidhje, na shpie ndaj tenderëve me çmime absurde prej 0.01 denarë dhe 0.01 për qind. Në të ardhmen, prioritet do të ketë oferta më e volitshme, apo raporti më i mirë midis çmimit dhe cilësisë, në vend të kriterit, "çmimi më i ulët" si kriter i vetëm për furnizimet publike, siç ka qenë deri më tani. Sipas Byrosë për Furnizime Publike, ligji i ri do të sjellë mbrojtje më të madh nga korrupsioni, përgjegjësi për kompetentët që kanë kryer keqpërdorime si dhe kontroll të furnizimeve më të mëdha dhe me më shumë rrezik. "Byroja për Furnizime Publike do të ndërmerr obligimin të kontrollojë shpalljet publike në mënyrë si-

stemore dhe jo çdo shpallje. Sistemi do të përcaktojë së bashku me treguesit për flamujt e kuq ose do të kontrollohet çdo i pesta apo e dhjeta shpallje. Gjithashtu do të rritet edhe pragu dhe në vend për 500 euro, tani për çdo kontratë mbi 1000 euro do të trajtohet si furnizim publik ose mbi 2000 euro në veprimtaritë e sektorëve të ndryshëm që përfshihen si kërkesë e komunitetit të biznesit", thotë drejtori i Byrosë për Furnizime Publike, Gjorgji Georgievski. Sipas tij, ndryshimet ligjore do të lehtësojnë furnizimet e vogla dhe do të ndihmojnë tejkalimin e problemeve të shumë shkollave dhe çerdheve, për shkak se ato kanë mungesë kuadrosh për furnizimet publike. Nga komuniteti i biznesit janë të kënaqur që janë pranuar edhe kërkesat

e tyre që të mos jenë të obligueshme ankandet elektronike si dhe faktin që jo vetëm çmimi, por edhe cilësia të jenë përcaktuese gjatë përzgjedhjes së shërbimeve dhe prodhimeve të ndryshme.

Me ndryshimet ligjore për furnizimet publike në të ardhmen, ankandi elektronik nuk do të jetë i obligueshëm, por vetëm do të qëndrojë si opsion që mund të pranohet, por edhe të hidhet poshtë. Biznesi është ankuar se në të kaluarën janë shënuar raste të kontraktimit të çmimeve më të larta midis palëve. Vite me radhë në Maqedoni gjithnjë sipas dispozitave ligjore janë harxhuar 40 milion uro pa shpalljen e tenderit ose në katër sy, andaj pritet që ndryshimet ligjore të vendosin më shumë rend në këtë drejtim.

Shkup, 20 shkurt - Sistemi elektronik do të përcaktojë se cilat furnizimet publike do të kontrollohen në të ardhmen. Flamujt të kuq të inkomporuar në sistem do të alarmojnë se cilat kontrata janë të dyshimta

LAJME SHKURT

18.7 për qind më shumë udhëtarë në aeroporte

Shkup, 20 shkurt - Nga dy aeroportet në Maqedoni, në Shkup dhe Ohër, në janar të këtij viti janë transportuar 151.381 udhëtarë, që paraqet rritje prej 18.7 për qind krahasuar me janarin e vitit të kaluar, kumtoi Ministria e Transportit dhe Lidhjeve. Në aeroportin e Shkupit muajin e kaluar janë regjistruar 145.592 udhëtarë, për 18,3 për qind më shumë krahasuar me janarin e vitit 2017, kur janë transportuar 123.118 udhëtarë. Në aeroportin "Shën Apostull Pali" në Ohër, numri i udhëtarëve të transportuar në janar është rritur për 30.8 për qind në krahasim me janarin e vitit të kaluar. "Qeveria e Republikës së Maqedonisë në mënyrë të vazhdueshme ndërmerr masa për zhvillimin e qarkullimit ajror në vend. Në këtë drejtim, politikat e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve lëvizin drejt krijimit të rrjetit të gjerë të destinacioneve të kapshme për qytetarët e Republikës së Maqedonisë", thekson Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.

Apanazh për pesë anëtarë të KSHZ-së

Shkup, 20 shkurt - Pesë nga tetë anëtarët e deri para pak kohësh të KSHZ-së do të marrin apanazh, është vendosur në seancën e djeshme të Komisionit parlamentar për zgjedhje dhe emërimet. Apanazh në kohëzgjatje prej një viti morën ish-kryetari i KSHZ-së, Aleksandar Çiçakovski, anëtarët e LSDM-së Violeta Duma dhe Igor Milev, Silvana Boneva nga VMRO-DPM-NE dhe Subhi Jakupi nga BDI. Tre anëtarët e tjerë - Rexhep Prekopuca, Atanas Urumov dhe Sasho Sërcev të cilët dhanë dorëheqje nuk kanë kërkuar apanazh, për shkak se kthehen në vendet paraprake të punës. Komisioni vendosi që edhe ish-deputetja e PLD-ja, Roza Topuzovska Karevska të marrë kompensim financiar nga Kuvendi për shkak të shkuarjes në pension. Komisioni në seancën e sotme ia ndërpreu apanazhin Pavle Trajanovit për shkak të emërimit në funksion tjetër, ndërsa apanazh morën edhe Dejan Boshkovski i cili u shkarkuar nga Komisioni për energjetikë, Tanja Tanevska ish-revizore shtetërore dhe Vllasta Dimkoviq, ish zëvendësministre e Bujqësisë.

Më shumë pasagjerë në transportin ndërkombëtar

Shkup, 20 shkurt - Për 5.9 për qind është ulur numri i përgjithshëm i pasagjerëve të transportuar në transportin rrugor në tremujorin e katërt të vitit të kaluar në krahasim me muajin e njëjtë nga vitit 2016, publikoi sot Enti Shtetëror i Statistikës. Sipas llojit të transportit, për 8.8 për qind është ulur numri i pasagjerëve të transportuar në transportin urban, ndërsa për 3.2 për qind në transportin periferik, derisa për 2.6 për qind është rritur transporti ndërrurban, ndërsa për 9.5 për qind transporti ndërkombëtar. Të dhënat statistikore tregojnë se në tremujorin e katërt të zbatuar me tremujorin e tretë numri i përgjithshëm i pasagjerëve është rritur për 22.4 për qind. Sipas llojit të transportit, numri i pasagjerëve të transportuar në transportin urban është rritur për 27.2 për qind, në transportin periferik për 25.9 për qind, në transportin ndërrurban është ulur për 6.1 për qind, derisa në transportin ndërkombëtar ulja është 29.2 për qind.

EKSPERTËT MË VËREJTJE PËR LIGJIN E RI

UNIVERSITETET,
FABRIKA DIPLOMASH

Përtej dimensionit arsimor dhe shkencor, universitetet duhet të kontribuojë edhe në zhvillimin socio-ekonomik të një vendi, respektivisht në gjenerimin e vendeve të reja të punës dhe në plotësimin e nevojave që ka tregu i punës. Nëse nuk arrijn ta bëjnë këtë, misioni i tyre ka dështuar, vërejnë profesorët universitar

Koha

Laura PAPANIKU

Shkup, 20 shkurt - Misioni i universiteteve nuk është vetëm të pajisë studentët me diploma dhe ti aftësojë ato për një profesion të caktuar. Ato nuk janë as vetëm për t'u marrë me shkencë dhe hulumtime. Përtej dimensionit arsimor dhe shkencor, universitetet duhet të kontribuojë edhe në zhvillimin socio-ekonomik të një vendi, respektivisht në gjenerimin e vendeve të reja të punës dhe në plotësimin e nevojave që ka tregu i punës. Nëse nuk arrijn ta bëjnë këtë, misioni i tyre ka dështuar, vërejnë profesorët universitar. Prof.dr. Avzi Mustafa, thotë se cilësia e gjithçkaje matet me rezultatin që jepet në fund.

"Kështu është edhe me arsimim e lartë. Universitetet duhet t'u paraprijnë proceseve, të jenë pararendëse të zhvillimeve shoqërore, të nxisin zhvillimin ekonomik dhe të zgjerojnë tregun e punës. Me këtë matet shkalla e vizionit të tyre", shprehet Mustafa profesori tani në pension. Ndikimi që kanë universitetet në shtetet e zhvilluara evropiane dhe amerikane, sipas ish-profesorit tjetër universitar, Tahir Zajazi, është i gjithanshëm. "Universiteti është truri i shoqërive të gjithë shteteve të zhvilluara në botë. Prandaj atje bëhet shumë kujdes për standardet që duhet të plotësojë një institucion i arsimit të lartë që të ketë të drejtën të funksionojë si i tillë. Normal që universitetet duhet të kenë edhe mbështetjen e shtetit, ministrive të arsimit apo institucioneve tjera gjegjëse për sigurimin e konkurrencën lojale ndaj tyre, si dhe për të bërë kontrollin e paanshëm për veprimtarinë që marrin përsipër universitetet", shprehet ai. Marrëdhënia shtet-universitet duhet të jetë reciproke dhe e njëjtë për të gjithë. Jo sikurse ndodh në Maqedoni, kur universitetet mbështeten apo neglizhohen duke u mbështetur në interesa të tjera - të

momentit, plotëson prof.dr. Zajazi.

Duke komentuar ndryshimet që pritet të ndodhin në Ligjin për arsim të lartë, profesor Mustafa vëren se duhet bërë shumë kujdes me nenet që kanë të bëjnë me vendosjen e standardeve që duhet të plotësojnë universitetet.

"Shumë më tepër duhet bërë kujdes në kriteret që vendosen për mekanizmat e kontrollit, pra të atyre instancave që duhet të mbikëqyrin punën e universiteteve. Ashtu si rriten përgjegjësitë dhe kompetencat, ashtu duhet të rriten edhe kriteret për funksionimin e atyre institucioneve. Pra, sa më lartë në hierarkinë e sistemit të arsimit të lartë të ngjiten personat gjegjës, aq më të përgatitur dhe me më tepër kompetencë duhet të jenë ato", shprehet Mustafa. Pra, sipas tij, shkalla e kriterëve nga profesorë universiteti, në anëtarë të Këshillit të Akreditimit dhe Këshillit të Evaluimit dhe më pas në anëtarë të Këshillit Nacional të Arsimit të lartë, duhet të rritet. Një anëtarë i këtyre Këshillave nuk guxon të jetë më pak i kualifikuar dhe me më pak përvojë dhe kompetencë profesionale se sa një profesor universiteti, shpjegon Mustafa. Për këtë arsye, plotëson më tej ai, duhet të bëhet kujdes sidomos me Këshillin Nacional të Arsimit të



TAHIR ZAJAZI

Universiteti është truri i shoqërive të gjithë shteteve të zhvilluara në botë. Prandaj atje bëhet shumë kujdes për standardet që duhet të plotësojë një institucion i arsimit të lartë që të ketë të drejtën të funksionojë si i tillë



AVZI MUSTAFA

Cilësia e gjithçkaje matet me rezultatin që jepet në fund. Kështu është edhe me arsimim e lartë. Universitetet duhet t'u paraprijnë proceseve, të jenë pararendëse të zhvillimeve shoqërore, të nxisin zhvillimin ekonomik dhe të zgjerojnë tregun e punës. Me këtë matet shkalla e vizionit të tyre


MANASTIRI
ME 84
MAGJISTRA
TË PAPUNË!

Manastiri është lider nga qytetet e Maqedonisë me numrin më të madh të kuadrove që kanë mbaruar gradën e shtatë të shkollimit. Në Agjencinë për punësim të Manastirit për punë presin 84 magjistra. Pas Manastirit vjen Prilepi, Tetova dhe Kumanova. Në 15 vitet e fundit për 10 herë është rritur numri i kuadrove që kanë magjistruar e që nuk kanë punë. Kështu, në vitin 2003 në listën që prisnin punë në Agjencinë e Punësimit në Manastir kanë qenë vetëm tetë magjistra të shkencave.

Lartë, ekzistimi i të cilit pritet të shënojë risi pasi të miratohet Ligji i ardhshëm.

"Në radhë të parë duhet të jetë gjithçka në rregull me plotësimin e standardeve nga ai Këshill, që të mund të presim ti kemi në rregull këshillat tjera dhe universitetet që qëndrojnë poshtë tij", shprehet Zajazi lidhur me Këshillin Nacional të Arsimit të Lartë, që e thënë figurativisht - do të duhet të paraqet kupolën e gjithë sistemit të arsimit të lartë në Maqedoni.

Këtë mendim ndan edhe Mustafa. Ai, e sheh këtë Këshill si instrument të ri që do të qëndrojë mbi të gjitha palët e interesit apo aktorët e deritanishëm të arsimit të lartë. Pra, një lloj korrektori edhe në relacionin mes MASH-it dhe universiteteve, për të eliminuar mangësitë ligjore në funksionimin e ofertës akademike me tregun e punës dhe kështu me radhë. Sipas tyre, vetëm atëherë mund të presim që universitetet të realizojnë në të tri komponentët e lartpërmendura të efikasitetit. Nuk është rastësi që pjesa dërmuese e 500 universiteteve të ranguar më mirë në Listën e Shangait janë nga shtete me GDP të lartë dhe që Anglia, e cila ka universitetet më të mira në Evropë, është shteti ku 95 për qind e të diplomuarve i thith tregu i punës. Përqindja e atyre që mbesin në universitet nuk është as 1 për qind e të diplomuarve.



Komuna e Kumanovës
Vetëqeverisja lokale

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/16 dhe 163/16), Kryetari i Komunës së Kumanovës në vijim sjellë

LAJMËRIM

Informohen të gjitha subjektet fizike dhe juridike në territorin e Komunës së Kumanovës se publikohet

Thirrje publike për parashtrim të iniciativave për përpilim të Planeve urbanistike

Thirrja publike publikohet në pajtim me nenin 21 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/16 dhe 163/16), në kuartalin e parë të vitit 2018.

- **Thirrja publike do të zgjasë prej 21.02.2018 deri më 23.03.2018 – 31 ditë** duke llogaritur me ditën e publikimit.
- **Thirrja publike do të shpallet** në lajmëtarin zyrtar të komunës, në ueb faqen e komunës www.kumanovo.gov.mk, në tabelën për shpallje të komunës, në sistemin informativ e-urbanizam, në gazetë ditore në gjuhën maqedonase dhe në gazetë ditore në gjuhën shqipe.
- **Gjatë kohëzgjatjes së Thirrjes publike** të gjithë subjektet e interesuara fizike dhe juridike mund të dorëzojnë iniciativë për përpilim dhe sjellje të planeve urbanistike nga neni 7 paragrafi (1) pika (2) alineja 2, 3 dhe 4 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/16 dhe 163/16).
- **Lënda e iniciativës** mund të jetë sjellja e planit të ri urbanistik ose ndryshim dhe plotësim i planit ekzistues urbanistik **me arsyetim për ndryshimin e kërkuar** dhe propozim të përfshirjes planore nga parashtruesi i iniciativës.
- **Subjektet e interesuara juridike dhe fizike** iniciativat ti dorëzojnë në pajtim me nenin 21 paragrafi (3) të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/16 dhe 163/16).
- **Mjetet për iniciativat e pranuar** për përpilim të dokumentacionit të nevojshëm duhet të sigurohen nga vet parashtruesit e iniciativave.

Nr. 21-1276/1
Data 19.02.2018

Kryetari i Komunës
së Kumanovës
Maksim Dimitrievski



Republika e Maqedonisë
Ministria e arsimit dhe shkencës

Në bazë të nenit 50 të Ligjit për veprimtari hulumtuese-shkencore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 46/2008, 103/2008, 80/2012, 24/2013, 147/2013, 41/2014, 145/2015, 154/2015, 30/2016 dhe 53/2016), nenit 3 të Rregullores për mënyrën dhe financimin e organizimit të takimeve shkencore dhe pjesëmarrje të hulumtuesve shkencor të vendit në takime shkencore ndërkombëtare dhe qëndrime të studentëve jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 51/2013) Ministria e arsimit dhe shkencës publikon:

KONKURS

Për shpërndarjen e mjeteve për financim të organizimit të takimeve shkencore për vitin 2018

1. Ministria e arsimit dhe shkencës me këtë konkurs shpërndanë mjete për organizim të takimeve shkencore në vitin 2018.
2. Organizimi i takimeve shkencore financohet pas dorëzimit të dokumentacionit në vijim:
 - Fletëparaqitje të plotësuar (**Fletëparaqitja mund të merret në Sektorin për shkencë dhe zhvillim tekniko-teknologjik pranë Ministrisë së arsimit dhe shkencës**);
 - Vendim nga organizatori për mbajtjen e takimit shkencor;
 - Vendim për botim të përmbledhjes së punimeve nga takimi shkencor
 - Programi për punë i takimit shkencor.
3. Organizatori i takimit shkencor është i obliguar që të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar në pajtim me pikën 2 të këtij konkursi.
4. Të drejtë për ndarjen e mjeteve financiare për organizim të takimeve shkencore kanë universitetet shtetërore dhe universitetet private – në njësitë e tyre të orientuara drejt shkencës (institutet shkencore) dhe në njësitë e orientuara drejt arsimit të bazuara në shkencë (fakultetet), Akademia e shkencës dhe arteve të Maqedonisë, Institucionet e pavarura shtetërore për arsim sipëror, Institucionet e pavarura private për arsim sipëror, institucionet publike shkencore, institucionet e përziera shkencore, institucionet private shkencore dhe hulumtuesit e pavarur, përmes konkursit publik.
5. Mjetet të cilat ndahen për organizim të takimeve shkencore llogariten varësisht nga numri i pjesëmarrësve në takimin shkencor dhe mjetet në dispozicion të Ministrisë së arsimit dhe shkencës për vitin aktual.
6. Universitetet shtetërore dhe universitetet private – në njësitë e tyre të orientuara drejt shkencës (institutet shkencore) dhe në njësitë të orientuara drejt arsimit të bazuara në shkencë (fakultetet), Akademia e shkencave dhe arteve të Maqedonisë, Institucionet e pavarura shtetërore për arsim sipëror, Institucionet e pavarura private për arsim sipëror, institucionet publike shkencore, institucionet e përziera shkencore, institucionet private shkencore dhe hulumtuesit e pavarur, fletëparaqitjet dhe dokumentet e theksuara në pikën 2 i dorëzojnë në adresën në vijim ose në arkivin e:

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Sektor për shkencë dhe inovacione
Bul. "Kiril i Metodi" nr. 54
1000 Shkup

7. Konkursi fillon prej 19.02.2018 deri më 23.11.2018.

Informacionet shtesë për konkursin mund të merren në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë, personi për kontakt:
Zhivko Kollçakoski zyra me numër 1406 ose me numër telefoni 076-485-046 dhe Katerina Stefkovska zyra e me numër 1406 ose në numër telefoni 076-485-047

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS



Republika e Maqedonisë
Ministria e arsimit dhe shkencës

Në bazë të nenit 50 të Ligjit për veprimtari hulumtuese-shkencore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 46/2008, 103/2008, 80/2012, 24/2013, 147/2013, 41/2014, 145/15, 154/15, 30/2016 dhe 53/2016), nenit 7 të Rregullores për mënyrën dhe financimin e organizimit të takimeve shkencore dhe pjesëmarrje të hulumtuesve shkencor të vendit në takime shkencore ndërkombëtare dhe qëndrime të studentëve jashtë vendit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 51/2013) Ministria e arsimit dhe shkencës publikon:

KONKURS

Për shpërndarjen e mjeteve për pjesëmarrje të hulumtuesve shkencor të vendit në takime shkencore ndërkombëtare për vitin 2018

1. Ministria e arsimit dhe shkencës me këtë konkurs shpërndanë mjete për pjesëmarrje të hulumtuesve shkencor të vendit në takime shkencore ndërkombëtare për vitin 2018.
2. Pjesëmarrja e hulumtuesve shkencor të vendit në takime shkencore ndërkombëtare financohet pas dorëzimit të dokumentacionit në vijim:
 - Fletëparaqitje të plotësuar (**Fletëparaqitja mund të merret në Sektorin për shkencë dhe inovacione pranë Ministrisë së arsimit dhe shkencës**);
 - Dëshmi se punimi është i pranuar për me gojë ose me shkrim (afishe) prezantim nga ana e organizatorit të takimit shkencor ndërkombëtar;
 - Pajtim nga institucioni ku është i punësuar kandidati për pjesëmarrje në takimin shkencor ndërkombëtar dhe i njëjti me nënshkrim dhe vulë nga udhëheqësi i institucionit dhe arkivuar në arkiv nga parashtruesi i institucionit;
 - Vërtetim për shumën e harxhimeve të rrugës;
 - Vërtetim për shumën e kotizimit dhe
 - Abstrakt të takimit shkencor.
3. Hulumtuesi shkencor është i obliguar që të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar në pajtim me pikën 2 të këtij konkursi.
4. Të drejtë për ndarjen e mjeteve financiare për pjesëmarrje të hulumtuesve shkencor të vendit në takime shkencore ndërkombëtare kanë universitetet shtetërore dhe universitetet private – në njësitë e tyre të orientuara drejt shkencës (institutet shkencore) dhe në njësitë e orientuara drejt arsimit të bazuara në shkencë (fakultetet), Akademia e shkencës dhe arteve të Maqedonisë, Institucionet e pavarura shtetërore për arsim sipëror, Institucionet e pavarura private për arsim sipëror, institucionet publike shkencore, institucionet e përziera shkencore, institucionet private shkencore dhe hulumtuesit e pavarur, përmes konkursit publik.
5. Mjetet të cilat ndahen për pjesëmarrje të hulumtuesve shkencor të vendit në takime shkencore ndërkombëtare ndahen në pajtim me mjetet në dispozicion të Ministrisë së arsimit dhe shkencës për vitin aktual.
6. Universitetet shtetërore dhe universitetet private – në njësitë e tyre të orientuara drejt shkencës (institutet shkencore) dhe në njësitë të orientuara drejt arsimit të bazuara në shkencë (fakultetet), Akademia e shkencave dhe arteve të Maqedonisë, Institucionet e pavarura shtetërore për arsim sipëror, Institucionet e pavarura private për arsim sipëror, institucionet publike shkencore, institucionet e përziera shkencore dhe hulumtuesit e pavarur, fletëparaqitjet dhe dokumentet e theksuara në pikën 2 i dorëzojnë në adresën në vijim ose në arkivin e:

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Sektor për shkencë dhe inovacione
Bul. "Kiril i Metodi" nr. 54
1000 Shkup

7. Konkursi fillon prej 19.02.2018 deri më 23.11.2018.

Informacionet shtesë për konkursin mund të merren në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë, personi për kontakt:
Zhivko Kollçakoski zyra me numër 1406 ose me numër telefoni 076-485-046 dhe Katerina Stefkovska zyra e me numër 1406 ose në numër telefoni 076-485-047

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Arrestohet tetovari, kapet me pushkë automatike

Tetovë, 20 shkurt - Të martën rreth orës 11.45 minuta në rrugën "172", në Reçicë të Vogël, pas disa informacioneve të siguruar para-prakisht, pjesëtarë të policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë kanë ndaluar veturën e tipit "Wolsfagen Lupo", me targa të Gostivarit, të cilën e ka drejtuar 33vjeçari me iniciale R.M nga fshati Sedllarcë e Epërme. Pas kontrollit të veturës, në të cilën i vetëm ka qenë personi R.M, është gjetur një pushkë automatike dhe një kornizë me gjashtë plumba, të cilat janë gjendur në një qese në karrigen e pasme të veturës, pas çka ai është arrestuar dhe mbajtur së stacionin policor të Tetovës, ndërsa është konfiskuar edhe vetura të cilën ai e ka drejtuar. Pak më vonë, në banesën ku me qera ka qëndruar në Tetovë, janë gjetur 26 plumba të tjerë të kalibratit 7.62 milimetër, municion pistolette. Pas zbardhjes së plotë të rastit dhe të gjitha detajeve të tjera që ndërlidhen me rastin në fjalë, në koordinim dhe konsultim me prokurorin publik, i arrestuari me iniciale R.M do të përballlet me padi adekuate, njofton Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë.

Një i maskuar grabit kazonë në Qendër

Shkup, 20 shkurt - Një grabitës i panjohur i maskuar dhe i armatosur para mesnate, ka kryer grabitje në një kazino në rrugën "11 Oktomvri" në Shkup, me ç'rast ka marrë 150.000 denarë. Siç bën të ditur MPB, grabitja është denoncuar më 18 shkurt në orën 23:50 në Stacionin Policor Qendër, ndërsa është kryer ditën e njëjtë rreth orës 23:00 në kazonë në bulevardin "11 Oktomvri". Po ndërmerren masa për gjetjen e kryerësit dhe për ndriçimin e plotë të rastit.

MBI 60 PËR QINDE SHOFRERËVE PËRDORIN TELEFONAT DERISA DREJTOJNË AUTOMJETET



ME NJË DORË TIMONIN, ME TJETRËN CELULARIN

Në Maqedoni përdorimi i telefonit celular derisa shoferi e drejton automjetin motorik është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për siguri në komunikacionin e rrugëve dhe sanksionohet me 40 euro në kundërvlerë denari apo 25 pikë negative në librezën e shoferit

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 20 shkurt - Përdorimi i telefonit celular derisa shoferi drejton automjetin motorik po bëhet arsye numër një për tërheqjen e vëmendjes të shoferët. Në Maqedoni, 63 për qind nga shoferët kanë përdorur telefon celular derisa kanë drejtuar automjetin. Shoferët e rinj deri 30 vjet, dy herë më shumë përdorin telefon celular derisa drejtojnë automjetin nga shoferët në moshë mbi 30 vjet. Këshilli Republikan për Siguri gjatë Komunikacionit në Rrugë (KRSKRR) thekson se përdorimi i telefonit celular derisa shoferët drejtojnë automjetin motorik është po aq e rrezikshme si në vendbanime, ashtu edhe jashtë nga vendet e banuara. Statistika tregon se numër gjithnjë e më i madh i aksidenteve rrugore ndodhin në vendbanime, ndërsa numri më i madh i tyre janë shkaktuar si pasojë e përdorimit të telefonit celular. Në aksidente të tilla rrugore më shpesh pësojnë këmbësorët dhe çiklistët. KRSKRR apelon deri te shoferët të jenë të përkushtuar dhe të kujdesshëm në komunikacion, të përqudrohen në rrugë dhe gjendjen në komunikacion dhe të mos përdorin telefona celularë derisa drej-

tojnë automjet motorik. Hulmtimet e bëra prej organizatave ndërkombëtare me renome tregojnë se tërheqja e vëmendjes së shoferit është arsye për 20 deri 25 për qind të të gjitha aksidenteve rrugore. Në nivel botëror 45 për qind nga shoferët e përdorin telefonin celular derisa e drejtojnë automjetin. Në SHBA vlerësohet se në çdo moment gjatë ditës gjashtë për qind e shoferëve përdorin telefona celularë derisa drejtojnë automjetin. Grupi më i rrezikshëm i pjesëmarrësve në komunikacion janë shoferë të rinj, deri 25 vjet dhe shoferët fillestarë. Prej 18 deri 30 për qind e të gjithë viktimave në komunikacion janë shoferë të rinj,

edhe pse sipas statistikës kjo përqindje përfshin mes nëntë dhe 13 për qind nga popullsia. Efektet negative nga përdorimi i telefonit celular janë pothuajse të njëjta edhe te të rinjtë edhe te shoferët në moshë. Te shoferët e rinj, problem është ta përshtatin drejtimin e automjetit me aktivitetin e ri - bisedë në telefon sepse nuk kanë përvojë në drejtimin e automjetit, ndërsa te shoferët e rritur, problem e kanë ta përshtatin drejtimin e automjetit me bisedën në telefon celular sepse më dobët dëgjojnë apo më dobët shohin. Sipas hulumtimeve të tjera, shkrimi i mesazheve derisa drejtohet automjeti motorik e ul reagimin e shoferit për ndali-

min e automjetit për 18 për qind, ndërsa e rrit rrezikun për shkak të aksidenteve rrugore për gjashtë herë. Shkrimi i mesazheve derisa drejtohet automjeti është i njëjtë me drejtimin e automjetit me sy të mbyllur tërë gjashtë sekonda për të cilin automjeti me shpejtësi prej 60 kilometrash në orë kalon 100 metra.

Në Maqedoni përdorimi i telefonit celular derisa shoferi e drejton automjetin motorik është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për siguri në komunikacionin e rrugëve dhe sanksionohet me 40 euro në kundërvlerë denari apo 25 pikë negative në librezën e shoferit.

MIRATOHEN NDRYSHIMET E LIGJIT PËR SIGURIM PENSIONAL

Kuvendi në vazhdimin e sotëm të seancës të 24-t, miratoi Ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, me procedurë të shkurtuar. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Milla Carovska, sqaroi se me dispozitat e Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor si kategori e siguruesve janë përfshirë edhe bujqit individualë. Nga viti 2013, siç tha, është vendosur përkufizim i ri "bujqësi familjare", por nga 1 dhjetori i vitit 2017 ende nuk është krijuar mundësi që të kryhet kategorizim i ri i bujqve. Për këtë, theksoi, kemi paraparë mbetjen e mëtejshme të përkufizimit të

mëparshëm "bujqit individualë - tatimpaguesit e të ardhurave nga kryerja e aktivitetit bujqësor, për të cilët aktiviteti bujqësor është aktiviteti i vetëm". Edhe më tej, ndryshohen dispozitat nga neni 61 dhe jepet mundësia për shfrytëzim të pensionit familjar për fëmijë me invaliditet, për çka deri më tani nuk ka pasur mundësi nëse fëmija ka fituar çfarëdo lloji të ardhurash ose ka qenë i punësuar. Ndryshon dhe neni 11 i cili siguron bazën për miratimin e metodologjisë për stazh të privilegjuar të cilën po e përpilojmë momentalisht, japim bazë ligjore për tu futur në praktikë", tha Carovska.

Gostivari vjet kishte katër nuse të mitura

Shkup, 20 shkurt - Zvogëlohet numri i kurorëzimeve tek të miturit në rajonin e Gostivarit. Për dallim nga kohërat e kaluara, kur formimi i bashkësisë familjare me të mitur ishte fenomen i shpeshtë, tani gjendja po ndryshon. Të dhënat e Qendrës për punë sociale (QSP) në Gostivar tregojnë se në vitin 2016 janë lidhur 15 çifte bashkëshortore të mitur, ndërsa vitin e kaluar

(2017) numri ka rënë në katër. Nga QPS thonë se para 7-8 viteve kishte nga 30 raste të tilla në vit, pjesa më e madhe e të cilëve kanë qenë mysliman maqedonas apo popullatë romë. "Tani nga viti në vit numri vazhdimisht ulet. Si duket dëgjohe këshillat e prindërve dhe vetëdija tek të rinjtë po zhvillohet. Gjithsesi, ata janë persona që janë në moshë shumë të re, janë jo se-

rioz, nuk janë të përgatitur as fizikisht e as psikikisht ti pranojnë obligimet dhe sfidat që sjell martesat. Mu për këtë shkak rreziku për divorc është më i madh tek çiftet e reja", thotë Nadica Veličkowska, drejtoreshë në Qendrën për punë sociale në Gostivar. Përvoja më së shpeshti thotë se në përqindjen më të madhe të rasteve, nusja është ajo e cila nuk i ka as 18 vjet.



Provokimi i Edi Ramës zbulon trishtueshëm mentalitetin shqiptar



Nga Mero BAZE

Ka njëqind arsye për të kundërshtuar propozimin e Edi Ramës për një president honorifik të përbashkët mes Shqipërisë dhe Kosovës, dhe akoma më shumë arsye për padobishmërinë e tij. Është një nga ato gjërat që Edi Rama i bën me qejf për t'i mbajtur miqtë e armiqtë rreth vetes, qoftë dhe duke e sharë.

Dhe duke qenë i tillë, nuk javlen të komentojmë Edi Ramën.

Reagimet e shqiptarëve ndaj Edi Ramës, duhet të na vlejnjë për të kuptuar se sa rëndë dhe sa joseriozë jemi, dhe kur kemi të drejtë të jemi të ashpër me një politikan si ai.

Nëse Edi Rama do merret 30 sekonda seriozisht për atë që tha, duhet marrë si një provokim ndaj Perëndimit, dhe jo ndaj shqiptarëve. Nëse Perëndimi do ta marrë seriozisht atë deklaratë, ka plot probleme që duhen parë në themel me linjat e politikës së jashtme shqiptare në rajon e më gjerë. Por, Perëndimi është i përmbajtur jo se i pëlqen deklarata, biles nuk e honeps dot fare atë retorikë, por di të bëjë skonton e populizmit në Ballkan.

Kurse reagimet shqiptare janë një mjerim.

Pikësëpari, përjashtoj disa intelektualë mendjehapur, që kanë kapur të vetmin thelb problematik të këtij reagimi, që po të ishte serioz, ishte karshillëk ndaj Perëndimit ndaj statusit të sotëm të shqiptarëve në Ballkan, dhe një lloj dyshimi mbi të ardhmen e rrjedhave të Kosovës drejt Perëndimit, gjithë reagimet e tjera, nuk janë në funksion të dëmit që mund të bëjë kjo deklaratë, por të halleve të gjithësecilit, sikur kjo deklaratë u bë realitet.

Po t'i shikosh reagimet shqiptare e t'i shprehësh ato, sidomos ato të Kosovës, duket sikur ajo që tha Edi Rama, u bë, dhe ata po mendojnë si po ua merr ky postin e presidentit kombëtar.

Dikush ka hall se Rama po fut në varësi Kosovën, a thua që ai e caktoi që presidenti do jetë nga Gjirokastra, një palë tjetër ka hall se mos presidenti do zgjidhet nga ata që mbjellin kanabis, e të tjerë që përfitojnë president vetë Edi Ramën.

Mjerimi është se në vend që shqiptarët të zbulojnë në këtë rast, mendjen e hapur pro-perën-

dimore të tyre, dhe më së paku të tallen me këtë deklaratë, ata sillen si një katund i vogël, që bën sherr se kush do zgjidhet kryeplak. Biles mezi po pres dhe reagimet nga Presheva, Mali i Zi e Maqedonia, të thonë dhe ata pse mos ta kemi dhe ne si përfaqësues atë presidentin e Ramës.

Në një farë mënyre, provokimi i Edi Ramës zbulon trishtueshëm mentalitetin shqiptar, mjerimin intelektual të debatit publik, dhe mungesën e një mendimi të qëndrueshëm shqiptar rreth identitetit tonë dhe të ardhmes sonë në Europë.

Mjafton një broçkull populiste në një festë të Kosovës, ku dhe ashtu gati sa nuk u përmbys tavolina para festës nga një kryeministër ekscentrik, që siç kthen gotat me fund, apo hidhet në pishina me rroba pas pijes, po ashtu tenton të bëjë politikë, që ata të cilët ndjekin debatin, të shikojnë se më joserioze se ajo që tha Edi Rama, është ajo që thonë shqiptarët e tjerë pas tij.

Grupi i dytë i deficiëntëve, janë të përcaktuarit si nacionalistë sh-

qiptarë, andej e këtij kufirit, të cilët janë të magjepsur nga ideja se kjo mund të ndodhë, por u vjen inat që këtë ide e ka thënë dikush që ata e dinë që nuk e ka seriozisht.

Por dhe ata shkëlqejnë me heshtjen e tyre si njerëz të kompleksuar, që dëshmon se nacionalizmin e kanë ideologji pushteti, dhe jo identitet. Vigjilentë ndaj idesë se mos historia i dokumenton si kundërshtarë të një "ideje kombëtare", ata nuk dinë ç'të bëjnë me këtë "hata" që u ka ndodhur, dhe ata nuk janë pjesë e kësaj historie.

Dhe në fund, natyrisht më të shëmtuar janë politikanët e Tiranës, të cilët Edi Rama nuk ka nevojë t'i tallë si patriotë, se i ka tallur si kundërshtarë, kur i ka futur në çadër për revolucion dhe i ka nxjerrë për dy tendera në CEZ dhe një faturë pallati 13 milionë dollarë.

Këta mendojnë se një president më shumë, është një hajdut më shumë, duke fyer kështu dhe Thaçin e Metën, dhe akoma më keq, mendojnë se kjo gjë dhe

Mjafton një broçkull populiste në një festë të Kosovës, ku dhe ashtu gati sa nuk u përmbys tavolina para festës nga një kryeministër ekscentrik, që siç kthen gotat me fund, apo hidhet në pishina me rroba pas pijes, po ashtu tenton të bëjë politikë, që ata të cilët ndjekin debatin, të shikojnë se më joserioze se ajo që tha Edi Rama, është ajo që thonë shqiptarët e tjerë pas tij



mund të bëhet, sikur presidentët e sotëm të mos ishin hajdutë.

Ky është realisht mjerimi anti-perëndimor i shqiptarëve, dhe nëse ka bërë një dëm real Edi Rama me këtë deklaratë, nuk është se ka marrë ndonjë rrezik personal mbi supe, pasi ai di ta kthejë në humor pas ca kohësh këtë gjë, por ka zbuluar një mentalitet anti-perëndimor, primitiv dhe të pastabilizuar, rreth çështjes shqiptare në rajon.

Njësoj siç ka zbuluar thelbin primitiv të shoqërisë serbe, duke i provokuar në Beograd, apo duke tërbuar nacionalizmin e vjetër grek me refuzimin katërvjeçar, tani na bëri dëm, duke na zbuluar çfarë mendojmë vërtet për veten tonë dhe Perëndimin.

S'di të them nëse kjo që na ka bërë është moderne apo primitive për një politikan, por është një gjë e pashpirt ndaj banalitetit tonë, pasi tregoi çfarë tmerrri është shakaja e bashkimit kombëtar. Dhe i vetmi dëm real që na ka bërë, nëse do flisja si propogandist i "çështjes kombëtare", siç "po na thërret atdheu", sot!

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovrasja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 20 shkurt | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Shkëmbimi i territoreve do të hapte "portat e Ferrit"

Nga "The Economist"


Dhjetë vjet më parë, Kosova njoftoi pavarësinë nga Serbia. Shqiptarët e saj, të cilët përbëjnë shumicën e popullsisë, festuan këto ditë. Por, serbët e saj, pjesa më e madhe e të cilëve jetojnë në enklava, nuk festuan.

Serbia nuk e njeh Kosovën, e cila dikur ka qenë provinca e saj jugore, dhe serbët e Kosovës ende e konsiderojnë veten qytetarë të Serbisë. Situata është tipike për Ballkanin, ku kufijtë janë, për të thënë të vërtetën, një ngatërresë e madhe. Kështu që ka serbë që jetojnë në Kosovë dhe në Bosnje-Hercegovinë, ku ata kanë edhe republikën e tyre (Republika Srpska), ka shqiptarë dhe boshnjakë muslimanë që jetojnë në Serbi, dhe grekë që jetojnë në Shqipëri. Së fundmi, autoritetet serbe propozuan diskutimin për një shkëmbim territoresh me homologët e tyre shqiptarë të Kosovës. A është kjo një ide e arsyeshme?

Në vitin 1923, Greqia dhe Turqia ranë dakord të shkëmbejnë rreth 2 milionë njerëz. Pjesa më e madhe e qytetarëve greqishtfolës, të krishterë ortodoksë të Turqisë u dërguan në Greqi dhe muslimanë nga Greqia u dërguan në Turqi. Ishte një risistemim brutal, por, duhet vënë në dukje se zbatuesit e tij, Greqia dhe Turqia nuk kanë hyrë në luftë prej asaj kohe. Ven-

di i vetëm ku grekët dhe turqit kanë luftuar njëri-tjetrin është Qipro, ku popullsitë e tyre mbeten të përzjera. Kjo ka frymëzuar nacionalistët në Ballkanin perëndimor. Midis vitit 1918 dhe fundit të viteve 1950, shumë muslimanë u inkurajuan të largoheshin nga Jugosllavia drejt Turqisë. Por në kohën e shpërbërjes së Jugosllavisë në vitet 1990, rajoni përbëhej ende nga një përzjerje popujsh. Liderët në ato luftëra jugosllave panë spastrimin etnik si mënyrën më të mirë për të krijuar shtete të reja kombëtare të ç'populluara nga minorancat shqetësuese. Deri në vitin 1995, rajone të populluara historikisht nga serbët në Kroaci u boshatisën dhe qindra mijë serbë, kroatë e boshnjakë po ashtu u dëbuan nga shtëpitë e tyre në Bosnje. Por vendet që dolën prej luftës, nuk përfshinë pastërtisht vetëm serbët, shqiptarët, kroatët e kështu me radhë. Një numër serbësh mund të jenë larguar nga Kosova pas luftës, por rreth 120 mijë prej tyre mbeten aty.

Autoritetet serbe dëshirojnë të diskutojnë dhënien e pjesës veriore të Kosovës Serbisë, ndërsa në këmbim rajonet e populluara nga shqiptarët në Serbi t'i kalojnë Kosovës. Fansat e asaj që quhet "pastrim i hartës" thonë se shtetet multi-etnike kanë dështuar në Ballkan. Por ata injorojnë faktin që, pasi qeveritë të nisen në këtë rrugë, procesi nuk do të ketë fund



Nëse Kosova dhe Serbia shkëmbejnë pjesë toke, procesi nuk do të përfundonte me kaq. Liderët serbë të Bosnjes do të mbanin referendum për të ardhmen e republika Srpska; kroato-boshnjakët do të pasonin këtë rrugë; dhe boshnjakët më pas do të luftonin për të shmangur shpërbërjen e vendit të tyre të përbashkët. Ndërkohë, shqiptarët në Maqedoninë perëndimore dhe në Mal të Zi do të kërkonin të bashkoheshin në Shqipërinë e Madhe.



të përcaktuar dhe ata nuk i kushtojnë aspak rëndësi të drejtave të njeriut të atyre që përfshihen në këtë proces. Nëse Kosova dhe Serbia nisin bisedime serioze për rihartimin e kufijve të tyre, ndikimi në komunitetet ballkanike, pa folur për ata që do të përfshihen në proces në Kosovë dhe Serbi, mund të jetë i jashtëzakonshëm.

Liderët serbë të Bosnjes do të mbanin referendum për të ardhmen e republika Srpska; kroato-boshnjakët do të pasonin këtë rrugë; dhe boshnjakët më pas do të luftonin për të shmangur shpërbërjen e vendit të tyre të përbashkët. Përgjatë kufirit, Serbia do të shtypte nacionalistët boshnjakë në Sanxhak të cilët ëndërojnë ta përfshijnë këtë rajon në një Bosnje më të madhe. Ndërkohë, shqiptarët në Maqedoninë perëndimore dhe në Mal të Zi do të kërkonin të bashkohe-

shin në Shqipërinë e Madhe. Mbështetësit e idesë do të pëlqenin po ashtu, të inkorporonin pjesë të Greqisë veriore, ndërsa nacionalistët grekë do të kërkojnë pjesë të Shqipërisë Jugore.

Ironia pas shkëmbimit të diskutueshëm është se pjesa më e madhe e serbëve të Kosovës, aktualisht jetojnë në enklava në jug të vendit. Kështu që marrëveshja nuk do t'i përfshinte ata për të jetuar në Serbi, dhe me gjasa do të detyroheshin të linin shtëpitë e tyre. Por zyrtarët serbë mund të jenë më pak të shqetësuar për bashkëndasit e tyre sesa për të ndërmarrë hapa drejt njohjes së pavarësisë së Kosovës - dhe kështu të arrinin më lehtë anëtarësimin e shpresuar në Bashkimin Europian.

Për ta mund të mos jetë shqetësim që një shkëmbim territoresh në Ballkanin Perëndimor mund të ketë jehonë të pamatshme. Nacionalistët hungareze, në fund të fundit, mbeten të paretuar me humbjen e Transilvanisë në Rumani dhe nacionalistët rumunë do të donin të rindërtonin kufijtë e tyre për të marrë Moldavinë. Ekziston arsye përse "ballkanizimi" ka një reputacion të keq.

Ashtu si edhe më gjerë në Bashkimin Europian, lehtësimi i kufijve kombëtarë do të dukej një punë më e mençur sesa rihartimi i tyre që duke iu referuar fjalëve të një zyrtari të BE-së, "do të hapte portat e Ferrit".

As ai vetë e as ndonjë tjetër nga makina e tij e propagandës as nuk do, as nuk e çon në mend që dy shtetet shqiptare të kenë një President të përbashkët. Kur nuk bashkojmë dot dy dogana, si mund ta bashkojmë kreun e shtetit? Por, qëllimi është i thjeshtë; të largojmë vëmendjen nga tragjedia që po luhet në jug të vendit, ku kreu "patriot" i qeverisë po bëhet gati të firmosë realizimin jetik të Vorio Epirit.



Po ju firmos Vorio Epirin, nuk ka hallin e Kosovës

Nga Enkel DEMI



Ndërsa greku është duke realizuar qetësisht projektin shovinist të Megalo Idesë, opinionistët, zëri opozitar i politikës, madje edhe Bashkimi Europian, merren me deklaratën marroke të kryeministrit Edi Rama për një President të përbashkët Shqipëri-Kosovë. Edhe vetë Edi Rama e di që kjo deklaratë e hedhur si shashkë është një "pesë me hiç". Ai, prandaj e ka bërë një gjë të këfillë, me qëllimin e vetëm që të tërheqë vëmendjen patriotike diku gjetkë. Madje, makina e tij e propagandës e orkestron në vetë të parë sulmin ndaj kësaj teze të re, të cilën do e ketë shpikur, teksa liron te mendimet e zëna kaps.

Duhet pranuar që Edi Rama është mjeshtri më i madh i propagandës qysh pas rënies së regjimit

të Enver Hoxhës. Është i vetmi që i njeh kaq mirë caqet emocionale dhe politike të kundërshtarëve të tij mediaticë apo politikë, sa kësaj here eci pas shprehjes së mirënjohur popullore: "hedh budalla një gur në lumë, e sulen të zgjutët ta qisin".

As ai vetë e as ndonjë tjetër nga makina e tij e propagandës as nuk do, as nuk e çon në mend që dy shtetet shqiptare të kenë një President të përbashkët. Kur nuk bashkojmë dot dy dogana, si mund ta bashkojmë kreun e shtetit?

Por, qëllimi është i thjeshtë; të largojmë vëmendjen nga tragjedia që po luhet në jug të vendit, ku kreu "patriot" i qeverisë po bëhet gati të firmosë realizimin jetik të Vorio Epirit. E para, premtion zona të reja minoritare që do të mbrohen me sta-

tus (ligj). Himara do të jetë minoritare. Atë që nuk e pranoi kurrë Ismail Qemali, Ahmet Zogu, Fan Noli, madje edhe Enver Hoxha, do e pranojë Edi Rama.

E dyta, termi "Çamëri" do të hiqet nga tekset e gjeografisë dhe historisë. Me heqjen e termit nuk ka pse të ketë më një Çështje Çame e natyrisht nuk ka pse të kërkojmë që në këtë krahinë është bërë genocid. Bëhet nul Rezoluta e Kuvendit për Çështjen Çame që e detyron Parlamentin e Shqipërisë për zgjidhjen e kësaj Çështje Kombëtare.

E treta, në marrëveshjen e detit sipas zërit zyrtar "To Vima" mësohet se Greqia përfiton 306 km2 si në marrëveshjen që rrëzoi Edi Rama në Gjykatën Kushtetuese.

E katërta, gjuha greke kthehet zyrtare në katër zona ku ne njohim

minoritetin, gjë që do të thotë që në qytete si Gjirokastra do i kesh dokumentet e shtetit në dy gjuhë, rrugë, pse jo dhe monumentet, duke e nisur me shtatoren e Çerçiz Topullit.

Mund të ketë edhe pesë apo gjashtë, por janë detaje të tjera që nuk i dimë, sepse këta tanët heshitin, kurse Nikos Kotzias andej është bërë fjalaman. Këta po negociojnë dhe nuk e tregojnë gjallë në botë as negociatorët. Këta po kryejnë punë, por këndej merren me Presidentin e përbashkët, ndërsa Batoni ka hallin që ia kemi shkëputur nga konteksti.

Këto reagimet politike dhe të komentatorëve për presidentin e përbashkët është si puna e Titanikut që teksa mbytej, muzikantët i binin violinës që të mbanin njerëzit me gajret. (JavaNews)

NASER RAUFI - AVOKAT

GJYQËSIA E RREME ME DËSHMITARË TË MBROJTUR



Gjykata ka qenë në një erozion të madh, në të vërtetë e dirigjuar prej ish-qeverisë. Nuk them që tani plotësisht është e pavarur, por është drejtuar në një rrugë që ta marrë atë pavarësi. Duhet të punohet, por askush s'mund të pret që aq shpejtë të ecin punët, pra reformat. Por, prej përvojës e shoh se tashmë është paraqitur një ambient tjetër. Pala mbrojtëse tani nuk pengohet që të propozojë prova...

Koha

Delvina KËRLUKU

Naser Raufi, avokat, lindi më 15 maj të vitit 1957. Shkollimin tetëvjeçar e kreu në shkollën "Liria", Shkup. U detyrua që gjimnazin ta kryejë në gjuhën maqedonase, poashtu edhe fakultetin, ku edhe dha provimin e Jurisprudencës. Prej vitit 1985 merret me avokaturë. Pas përfundimit të shkollës, do të bëjë praktikë në zyrën e babait të tij, gjykatësi Sejdi Rauf Bajrami, kur kishte hapur zyrën e avokaturës më 27 maj të vitit 1966, dy vite pasi lirohet nga burgu. Nga vitit 1987, avokati Raufi ka filluar të punojë me licencë të veten. Raufi njihet si avokati që ka mbrojtur rastet më eklatante, rastin "Brodeci", "Monstra", "Lagja e Trimave", "Punëtorët e Mavrovës", "Sopoti", rasti "Spiun", vrasje të shumta... Në fillim të karrierës, Raufi ishte penguar të marrë licencën për avokat, pastaj edhe certifikatën shtetërore, meqë historia e të parëve të tij i kishin penguar shumë shtetit. Nga nëna korçare, Marjeta Kërshova, ka huzuar këngën, ku ajo vetë ka qenë mësuese e muzikës.

KOHA: Z. Raufi, detyra e avoktit, në përgjithësi është e vështirë dhe delikate, pasi shpeshherë ndodh që prej avoktit varet edhe jeta e të akuzuarit. Por, detyra e tij bëhet edhe më e vështirë në praktikën gjyqësore të vendit tonë, ku gjykata dhe gjykatësit nuk janë të paanshëm, por të ndikuar. Si ia dilni ta bëni mbrojtjen të drejtë për të akuzuarin që mbronin?

RAUFI: Avokatura, profesioni im, është vërtet shumë i vështirë dhe i ndërlikuar. Ka përgjegjësi të madhe. Për shembull, padia penale është një

nga më specifiket, veçmas në rastet e krimit të organizuar, ku edhe dënimet janë shumë të mëdha... flasim kur ka prova. Pra, vetë procedura është më e ndërlikuar. Kemi rastet e veçanta të hulumtimit, informatat e kualifikuara. Por, meqë i punojmë këto lëmi, e kemi edhe certifikatën e lejes për punë. Kur fitet për gjykatësit tek ne, është e vërtet që në shumë raste mbajnë anë, por kohën e fundit, më saktësisht gjashtë muajt e fundit - është një ambient krejtësisht tjetër nga seç ishte. Sigurisht me këtë barrkadën që u bë, edhe gjykatësit që ishin të çoroditur, në fakt të ndikuar nga regjimi i kaluar dhe direktivat ishin të atilla që të mos respektohen rregullat e drejtësisë. Këtë e bënin edhe vet kryetarët e gjykatës.

KOHA: Po nga praktika Juaj e gjatë do ishte mirë që të na tregoni ndonjë rast më të veçantë për ta ilustruar këtë që thamë më lart?

RAUFI: Personalisht tek unë ka

ndikuar keq padrejtësia. Në atë mënyrë ku kam patur probleme, kam patur edhe kokëçarje. Rast konkret e patëm rastin "Monstra", ku kemi kërkuar të shkarkohet Trupi gjyqësor, por nuk u arrit sepse ka qenë e përcaktuar me direktivë të shërbimit sekret, në këtë rast. Kemi patur probleme edhe në seancën ankimore, ku provat tona zakonisht nuk janë pranuar. Pra, në rastet më të ndërlikuara si "Sopoti", "Monstra" e deri te "Lagja e Trimave", madje këtu asnjë provë nuk është pranuar pas 200 propozimeve ankimore nga pala mbrojtëse. Nuk u pranua nga ana e gjykatësit, që do të thotë se prokuroria nga ana e gjyqit ka qenë si e njëanshme. Ndërsa, gjykimi në procedurë penale ka të njëjtat funksione të mbrojtjes dhe të akuzës, ndërsa gjykata ka luajtur rolin në një anë me prokurorin. Faktikisht, provat që i propozoi prokuroria, qind për qind u pranuan në gjykatë, ndërsa propozimet tona nuk u pranuan. Në këtë



Jam i sigurt se te rasti "Sopoti" dhe "Monstra", epilogu do të jetë pozitiv për të akuzuarit. Botërisht dihet tashmë se janë raste të montuara, gjë që është zbardh, por pritet vendimi final që të njëjtit të lirohen. Presim të tërhiqen aktakuzat. Por, te rasti i Kumanovës, nuk besoj të ketë tërheqje të aktakuzës, do të ndryshohet aktakuza, pra këtu nuk bëhet fjalë për terrorizëm dhe se nuk ekziston definicion për terrorizëm

rast, ne reagojmë me proces-verbal dhe tek Gjykata e Apelit, se këtu zakonisht shkojnë në tre shkallë ankesat te gjyqi suprem. Deri më tani arritëm që për rastin "Monstra", të na pranohet ankesa, se provat e tjera që ne i kemi propozuar, nuk na i ka pranuar gjykata. Te ky rast filloi ajo barazia mes palës mbrojtëse dhe aktakuzën dhe motivi. Tani kemi të njëjtin ankesë për Lagjen e Trimave...

KOHA: A dallon pozita e avokatisë shqiptare nga ajo maqedonase para gjykatës?

RAUFI: Jo, nuk dallon. Sipas përvojës time, nuk kam patur asnjë problem të tillë apo diskriminim. Procedura për palën mbrojtëse ka qenë korrekte. Mund të them që edhe për avokatët maqedonas ka ndodh e njëjta. Problemi i vetëm ka qenë gjykata e tillë siç e dimë të gjithë.

KOHA: Keni mbrojtur të akuzuar shqiptarë edhe për vepra më të vështira, siç është ajo e terrorizmit (rasti i Kumanovës), si ndjeheni kur e shihni se procesi akoma pa filluar, ka marrë kahje të gabuar?

RAUFI: Reagoj. Fillimisht paralajmëroj organizatat që merren me këtë veprimtari, si OSBE-në, me të cilën kam më shumë se 20 vite që komunikoj, Komitetin e Helsinkit, Amnesty Internacionale, me ambasadat, posaçërisht atë të SHBA-ve, si dhe ambasada e Holandës, pasi këto dyja interesohen më shumë, natyrisht edhe me ambasadat tjera. Nga ana e OSBE-së ka ndonjë reagim, përmes observimit që edhe e bën, por nuk janë informata publike, sepse ajo që ndodh në gjykatë vështirë është të dihet e të dilet në opinion. Kur nuk ka prokuroria dëshmi,





e shfrytëzon dëshmitarin e koduar, dhe vetëm me dëshminë e tij e gjen gjykimin që ata kanë faj, ndërkohë që kjo përvojë është e ndaluar sipas konventave të drejtave të njeriut. Deri tani, në praktikë, te ne ashtu janë gjykimet, Mbi 80 për qind e rasteve janë bazuar në këto "dëshmi të mbrojtura". Ashtu edhe në Lagjen e Trimave, dëshmitë e policëve i kemi të koduara, pa arsye. Lind pyetja se pse ato duhet të jenë të koduara, kur dihet se cilët policë kanë marrë pjesë dhe numri i tyre! Ashtu edhe në rastin "Monstra", i gjithë aktgjykimi është sjellë nga një dëshmi e një dëshmitari të koduar që nuk ka lidhje me të vërtetën dhe që jam i sigurt se do ta zbardhim këtë punë. Edhe te rasti "Sopot" në pyetje ka qenë dëshmitari i koduar. Ka vite që Prokuroria nxjerr aktakuzë në bazë të dëshmitarëve të mbrojtur, në fakt nga manipulimet.

KOHA: Në opinion janë të njohura rastet Sopot, Monstra, Kumanova, të cilat është thënë se janë raste të montuara (dy prej tyre edhe u rikthyen për procedim nga instancat më të larta gjyqësore. Si mendojnë se do të jetë epilogu i tyre?

RAUFI: Jam i sigurt se te rasti "Sopot" dhe "Monstra", epilogu do të jetë pozitiv për të akuzuarit. Botërisht dihet tashmë se janë raste të montuara, gjë që është zbardh, por pritet vendimi final që të njëjtit të lirohen. Presim të tërhiqen aktakuzat. Por, te rasti i Kumanovës, nuk besoj të ketë tërheqje të aktakuzës, do të ndryshohet aktakuza, pra këtu nuk bëhet fjalë për terrorizëm dhe se nuk ekziston definicion për terrorizëm. Sepse ata djem u sulmuan nga shteti, ndërsa të dënuarit nuk ndërmorën asnjë sulm as ndonjë institucion, as ndaj popullatës civile dhe më e rëndësishme, vet dëshmitë janë se grupi i sulmuar nga policia. Pra, për mua nuk është akt terrorist, por ato mund të dënohen për armëmbajtje pa leje. Këtu është në pyetje formacioni i UÇK-së, njerëz me uniforme që kanë luftuar kundër një uniforme tjetër. Nuk bëhet fjalë për dhunë, kanosje a vrasje të civilëve... Ne në atë seancën ankimore nuk mund ta shpjegojmë këtë, pasi këtu kemi një hendikep të madh që lënda i jepet gjykatës me lidhshmëri politike, si pasojë e regjimit, ku edhe njihet gjykatësja pa përvojë. Nuk më ka ndodhur deri më tani që më shumë

se dyqind prova të propozuara nga trembëdhjetë avokatë, asnjëra të mos pranohet, vetëm një dëshmi e shërbimit sekret dhe ajo madje nuk u realizua me një arsye sipërfaqësore.

KOHA: Pra, nuk jeni optimist se gjërat do të ecin drejtë për rastin e Kumanovës?

RAUFI: Optimist jam në rikualifikim të lëndës, sepse mendoj që do të tërhiqet si dy rastet e tjera. Pra, mund të tërhiqet aktakuza. Ne e dimë që ka pasoja, por për vepër terrorizëm jo. Ata thonë që kanë faj sepse kanë qenë të armatosur, por as nuk kanë patur qëllim të sulmojnë as edhe nuk kanë sulmuar, ata mohojnë se janë terroristë. Këtu, pra mund të dënohen për vepër armëmbajtje pa leje. Vetë dëshmitë e prokurorisë dëshmojnë se ata kanë qenë të sulmuar. Kanë qenë dy persona duke fjetur, në atë kohë, ku i kanë sulmuar në ora 5 të mëngjesit, ku të mos ishin mbrojtur, edhe këta s'do ti kishin rezistuar vdekjes. Pra, kanë mbrojtur jetët e tyre.

KOHA: Sa e dëmtojnë drejtësinë rastet e montuara dhe të imponuara nga politika ditore?

RAUFI: E dëmtojnë shumë. Në fakt, shkelen të drejtat e njeriut. Te rastet e montuara, si ta them, nuk ka asnjë fuqi, posaçërisht tek provat, ku nuk mund t'i pranosh provat e të akuzuarve. Në asnjë rast të montuar nuk janë pranuar provat. Me pranimin e fakteve do të ishin zbardhë vetë montimet. Mendoj që dëshmitari i koduar ka qenë ai instrument i prokurorisë që të montohen këto raste. Nuk kam patur asnjë rast ku nuk ka patur dëshmitar të koduar. Montimet më të shumta bëhen nga ana e prokurorisë, e cila në fakt e përgatit edhe aktgjykimin. Tek ne, Prokuroria ka presioni nga policia dhe shërbimi sekret, në vend që të jetë e kundërta - Ministria e Punëve të Brendshme të jetë në shërbim të prokurorisë. Kështu ishte edhe ligji i vjetër, ndërsa shpresojnë se tani me ndryshimet e reja ligjore, MPB do të jetë në shërbim të plotë të prokurorisë.

KOHA: Deri ku janë reformat në drejtësi, dhe kujt i konvenon që ata të ecin kaq ngadalë?

RAUFI: Personalisht nuk mendoj që ecin edhe aq ngadalë. Por, duhet të shihet një kronologji se çfarë ka ndodhur këto 10 vitet e fundit. Gjykatat ka qenë në një erozion të madh,

në të vërtetë e dirigjuar prej ish-qeverisë. Nuk them që tani plotësisht është e pavarur, por është drejtuar në një rrugë që ta marrë atë pavarësi. Duhet të punohet, por askush s'mund të pret që aq shpejtë të ecin punët, pra reformat. Por, prej përvojës e shoh se tashmë është paraqitur një ambient tjetër. Pala mbrojtëse tani nuk pengohet që të propozojë prova. Nuk do të kemi më raste të dëshmitarëve të koduar. Kemi gjykatës që janë objektiv dhe jam i sigurt, sepse i njoh, se më përpara kanë qenë në ndikim të ekzekutivit apo të ndonjë faktori tjetër. Mirëpo, do të duhet kohë dhe punë që të jetë një gjykatë e pavarur. Është kohë e shkurtër që ka ecur të përmirësohet, por është në rrugë të drejtë për t'u bërë e pavarur. Gjithsesi, do të tregojë koha.

KOHA: Ku është efikasiteti i gjyqësorit në Maqedoni krahasuar me shtetet fqinje?

RAUFI: Mendoj se jemi shumë më mbrapa se të gjitha vendet në rajon. Kosova, për shembull, ka specifikat e veta. Tek ne nuk është e mjaftueshme që kemi vetëm Prokurori Speciale. Mirëpo, koha e tregoi se këtu ishte e bllokuar tërësisht Prokuroria Speciale, pikërisht për arsye se nuk patëm gjykatës në këtë prokurori. Dhe, kështu u vonuan proceset për të vendosur drejtësinë në vend. Tani, nuk mund të themi se ka instruksione të shumta për PSP-në. Kjo do të thotë që dëshmitë të pranohen. Kështu ndryshime te kryetarët e

gjykatës. Posaçërisht te Gjykata Themelore e shkallës së parë, ku janë të gjitha lëndët e kimit të organizuar. Me shtetet fqinje të bëjmë një krahasim jemi më pas, sepse kanë formuar më herët llojin e Gjykatës së pavarur apo të quajmë ndryshe - Gjykata Speciale. Ne kemi vepruar shumë më vonë.

KOHA: Po të mos ishit bërë avokat, për çfarë profesioni kishit ëndërruar si fëmijë?

RAUFI: Atë që kam dashur ta punoj si profesion ka qenë hulumtimi i antikës. Të kem një atelie me gjësende antike. Kur do të pensionohem, besoj se do ta hap një atelie, meqë edhe sot e kam atë dëshirë. Kudo që shkoj nëpër vende të ndryshme, nuk kthehem pa një skulpturë ose diçka të ngjashme. Por, dëshira ime është një atelie - në një shtëpi në Ohër.

KOHA: Është krijuar përshtypja se avokatët fitojnë shumë. Është e vërtetë, apo legjendë?

RAUFI: Fitojnë. Avokatët fitojnë shumë. Unë nuk jam prej atyre që fitojnë shumë. Fitojnë ata që kanë organizata, ku përfitojnë me tarifë afrofe, ku janë edhe të lidhur me qeverinë me pushtetin ekzekutiv. Kjo ka ndodhur shumë vitet e fundit nga ana e Qeverisë së vjetër. Nga ana ime është caktuar shuma, por ka shumë raste ku kam punuar pa para për ti mbrojtur. Për rastin "Monstra" kam marrë një shumë që është e ulët. Pra, aq sa ti paguaj tatimet e shtetit. Ka raste ku edhe u kam dhënë leje anë-

tarit ose familjes ta caktojnë vetë shumën, ku edhe ka lëvizur sipas mundësive. Të mos flas për rastin e Sopotit, që asnjë denarë nuk kam marrë. Ata njerëz nuk kanë para as për t'u ushqyer. Te "Lagja e Trimave" kam dhënë një avans, për tatimet, por deri më tani nuk mund të paguhen tatimet. Sepse, në çdo gjykim kemi tatim të paguajmë. Unë u kam dhënë një shumë që në të vërtetë mbulon tatimet, por prioritet ju jap atyre që të vendosin.

KOHA: Duke marrë parasysh natyrën e profesionit Tuaj, Ju duhet të qëndroni gjatë kohë jashtë shtëpisë, a keni mirëkuptim nga familja Juaj?

RAUFI: Po, kemi mirëkuptim. Po tanimë e organizoj jetën time. Aktiviteti i punës mbaron në ora 17:00. Ne plotësojmë punën, meqë jemi aktiv, ku kam kolegë pune në zyrën time dhe punojmë 8 orë. Ndosht që të punoj edhe ditën e shtunë dhe të diel, por i kushtoj rëndësi edhe jetës private. Përpara 7 apo 8 viteve shpenzoja shumë kohë në punë, paradite e pasdite. Unë që kam patur rastet e ndërlikuara kanë kërkuar shumë punë e përkushtim. Punoj e do të vazhdoj punën, meqë në avokaturë mbushi plot 51 vite. Por do të shohim se si do të vazhdojnë punët. Avokaturën e kam trashëguar nga babai. Ndërsa gjatë karrierës time jam ballafaquar edhe me probleme, të cilat ndonjëherë të ndalin hapin e të futin në dilemë nëse ia vlen të vazhdoj.



QEVERIA E KOSOVËS TËRHEQ DEMARKACIONIN NGA KUVENDI

Koalicioni qeverisës pa votat e Listës Serbe dhe të "Vetëvendosjes" besohet se nuk i ka më shumë se 77 vota për Demarkacionin, ndonëse për një marrëveshje të tillë ndërkombëtare duhen së paku 80 vota të deputetëve

Qeveria ka miratuar kërkesën drejtuar Kuvendit për tërheqjen e Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

Kjo me qëllim që Projektligji t'i bashkëngjitet edhe deklarata e arritur mes presidentëve të të dyja shteteve. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi me 16 shkurt ka bërë të ditur se ai dhe homologu i tij nga Mali i Zi, Filip Vujanović kanë

nxjerrë një deklaratë të përbashkët për shënjimimin e kufirit mes të dyja vendeve.

Në deklaratën e përbashkët të dy presidentëve thuhet se: "Republika e Kosovës do të procedojë në Kuvendin e Kosovës dhe do të ofrojë të gjitha përpjekjet për të ratifikuar marrëveshjen sipas Nenit 12 të marrëveshjes. Pas tërheqjes së projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes së Demarkacionit me Malin e Zi, Kryeministri i vendit

Ramush Haradinaj ka folur edhe për datat e mundshme të seancës së radhës së Kuvendit ku pritet të dërgohet Anex-marrëveshja për Demarkacionin.

"Jemi të gatshëm që nga nesër të thirret seanca e Kuvendit dhe më së largu të enjten do të zhvillohet kjo seancë", është shprehur Haradinaj.

Demarkacioni me Malin e Zi nuk ka gjasë të kalojë pa votat e deputetëve të Listës Serbe. Këta të

fundit votën e tyre pro po e kushtëzojnë me themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Ndërsa lëvizja "Vetëvendosje" e ka bërë të qartë se nuk do ta votojë Demarkacionin me Malin e Zi. Kështu koalicioni qeverisës pa votat e Listës Serbe dhe të "Vetëvendosjes" besohet se nuk i ka më shumë se 77 vota për Demarkacionin, ndonëse për një marrëveshje të tillë ndërkombëtare duhen së paku 80 vota të deputetëve.

Njohja e Kosovës, biletë e Serbisë për në BE

Njohja e Kosovës është biletë për Serbinë për të hyrë në Bashkimin Evropian, thotë analisti austriak, Gerald Knaus, themelues dhe president i Iniciativës Evropiane për Stabilitet. "Nëse Serbia nuk e njeh Kosovën, ajo definitivisht nuk do t'i bashkohet kurrë BE-së. Këtë e dinë të gjithë. Dhe, sa më gjatë që kjo e vërtetë e dukshme nuk pranohet nga ana e politikanëve në Beograd, aq më shumë kohë do të humbet", thotë Knaus në një intervistë për Shërbimin e Ballkanit të Radios Evropa e Lirë. Duke komentuar deklaratën e



kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, se Kosova dhe Shqipëria një ditë do të duhet të kenë një president, Knaus thotë se ajo më shumë është një përpjekje për të mashtruar Bashkimin Evropian. "Men-

doj se është një bluf, nuk mendoj se ka mbështetje reale për ndryshim të kufijve, as në Tiranë, as në Prishtinë. Marrëdhëniet e mira midis fqinjëve nuk janë kërcënim për askënd, por më shumë se kaq do të

ishite krejtësisht e padëshirueshme dhe tërësisht joreale. Mirëpo, është e qartë se, nëse Shqipëria dhe Kosova nuk trajtohen seriozisht nga pjesa tjetër e Evropës, nëse lihen jashtë, ato do t'ia kujtojnë Evropës se mund të nxjerrin në agjendë edhe çështje që i bëjnë sërisht interesante", thotë Knaus. Të hënën, Bashkimi Evropian ka paralajmëruar Shqipërinë kundër "ndërhyjes" në vendet fqinje, pasi Rama ka thënë se vendi i tij dhe Kosova mund të kenë një ditë një president të vetëm si "simbol të unitetit kombëtar"



Presidenti Meta kërkon të dijë se kush janë negociatorët me Greqinë

Presidenti Ilir Meta bën publik qëndrimin e tij dhe letrën dërguar ministrit të Jashtëm, Dëmir Bushati lidhur me "Kërkesën për autorizim negociatash me palën greke", lidhur me negociatat me Greqinë dhe çështjen e Detit, njoftojnë mediat në Tiranë. Në funksion të transparencës me opinionin publik, Presidenti vlerëson të bëjë publik qëndrimin e tij lidhur me "Kërkesën për autorizim negociatash me palën greke" dërguar Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme, ditën e premte, datë 16 shkurt 2018, dhe po në funksion të transparencës Presidenti Ilir Meta do të mbajë një konferencë shtypi në institucionin e Presidencës sot në orën 13:00.

Meta thotë se kërkesa nuk përkufizon qartë objektin e negociatave për të cilin kërkohet autorizim për plotëfuqi. Presidenti shton se përcillet kërkesë për autorizim negociatash me palën Greke, por nënvizon se ky përkufizim nuk parashikon, se cili është objekti konkret për të cilin kërkohet autorizim për plotëfuqi dhe nuk reflekton detyrimet që rrjedhin nga Vendimi i Gjykatës Kushtetuese i vitit 2010. Po ashtu kreu i shtetit kërkon të dijë se kush është grupi negociator.



KOSOVA MUND TA PENGOJË ANËTARËSIMIN E SERBISË NË BE

Carl Bildt, ish-ministër i Jashtëm i Suedisë dhe njohës i politikës edhe për Ballkanin ka thënë se dialogu i BE-së midis Beogradit dhe Prishtinës duket se ka qenë në një nivel jo të kënaqshëm gjatë viteve të fundit. Në këtë drejtim, siç ka shkruar Bildt në një shkrim autorial, zhvendosja drejt një marrëveshje gjithëpërfshirëse të normalizimit

ka të ngjarë të kërkojë një nivel shumë më të lartë angazhimi nga BE-ja, sesa që kemi parë kohët e fundit.

Siç ka vlerësuar ai, ndër të gjitha çështjet në tryezë, kjo ka të ngjarë të jetë më e vështira.

"Duhet të shtohet se Rusia nuk ka gjasë të përmbahet nga shprehja e mbështetjes së saj për qëndrimin e serbëve në këtë çështje, duke e bërë kështu betejën për opinionin publik në vend edhe më të vështirë". Dhe nga dy shtetet e "përparuara", Bildt thekson se Serbia është qartazi më e avancuar. "Duke hapur 12 nga 35 kapitujt në procesin e pranimi dhe të mbyllur vetëm dy prej tyre, ajo ka ende rrugë për të bërë. Por edhe më kërkues se ky proces është fakti se tani është vendo-

sur një e drejtë e vetos nga Kroacia dhe Kosova për pranimin në BE të Serbisë. Duke zvarritur çdo proces në kufirin e Danubit, Kroacia mund të ngadalësojë procesin dhe duke zvarritur bisedimet për një marrëveshje normalizimi, Kosova mund të bëjë të njëjtën gjë", ka shkruar Bildt, në një shkrim të tij autorial rreth strategjisë së BE-së për Zgjerim.

KU PËRFUNDOI THESARI

I GADAFIT?



Pyetja mbetet pa përgjigje, sepse rruga e parasë është e errësuar prej marrëveshjeve sekrete dhe përgjigjeve në heshtje të menaxhuesve dhe avokatëve. Dihet vetëm që marrin drejtimin e Luksemburgut, dhe pastaj asgjë më shumë

Ku ka përfunduar thesari i Muhamer Gadafit? Askush nuk e di me saktësi, po kështu askush nuk e di se sa është shuma, edhe pse qarkullon shifra e një pasurie gjigande, diku tek 200 miliard dollarë (sa për krahasim, pasuria personale e Jeff Bezos të Amazon është pak më shumë se 100 miliardë). Nga këto para, që nga viti 2011, viti i vdekjes së liderit libian, nuk ka asnjë gjurmë konkrete, por vetëm shfaqje fantazmë. Ka nga ata që thonë se janë fshehur në kasaforta të shpërndara nëpër Afrikë, disa thonë se ka rënë pjesërisht në duart e ISIS (një grup tjetër mbi pasuritë e të cilit ekzistojnë legjenda, por që kanë humbur gjurmët), disa thonë se ai është së paku pjesërisht në Dubai, pasi ka kaluar nëpër Londër dhe Itali.

Vitin e kaluar u publikua një investigim i madh nga Süddeutsche Zeitung, duke përmendur Panama Papers, që përmbante dëshmi se shumica e këtyre parave, së paku ato që gjendeshin në fondin sovran të themeluar nga vetë Gadafi në vitin 2006, LIA (Libia Africa Investment) ishin investuar në fonde të naftës përreth Afrikës, në mënyrë që të lejonin qarkullimin e tyre. Pasuria mendohet të jetë rreth 60 miliardë. Pikërisht fondi sovran libian (që, duhet të theksohet, është i pranishëm në rreth 500 kompani, duke përfshirë kompanitë italiane, ku gjatë viteve ka investuar rreth 3 miliardë në borde të kompanive të shumta si Eni, Enel, Unicredit, Finmeccanica, Fiat-Chrysler, Juventus etj) ka qenë, në orët e fundit, në qendër të një studimi të konside-

rueshëm të publikuar në faqen e internetit Politico.eu. Teksti përmban dëshmi se megjithëse asetet likuide të fondit janë ngrirë në pritje të stabilizimit të situatës politike në Libi (brenda vitin 2018, janë planifikuar zgjedhjet të cilat sipas OKB duhet të paqësojnë vendin, aktualisht i ndarë në dy rajone të kundërvëna, dhe të udhëhequra nga qeveritë e ndryshme, një me kryeqytetin Tripolin dhe tjetri me kryeqytetin Tobrukun), në të vërtetë ata vazhdojnë të qarkullojnë.

Një hipotezë, kjo që paratë libiane janë ende në qarkullim edhe pse rezultojnë të ngrira, e përforcuar edhe nga investigimi i fundit i Politico, që ka mbledhur prova të faktit që fondi sovran LIA shpërndan i pashqetësuar ende dividente aksionesh, të ardhura nga obliga-

cionet dhe pagesa interesash. "Gjashtë vjet pas vdekjes së Gadafit, fondet e ngrira të regjimit në Bruksel po gjenerojnë dhjetëra-miliona Euro në interesa, pavarësisht sanksioneve ndërkombëtare". Në këtë pikë, ka një tjetër pyetje që duhet të ketë përgjigje. Kush i arkëton këto para? Kush përfiton nga para që, në teori dhe në praktikë, i përkasin popullit libian dhe që, në pritje që vendi të ketë një qeveri, duhet të jenë të ngrirë?

Pyetja mbetet pa përgjigje, sepse rruga e parasë është e errësuar prej marrëveshjeve sekrete dhe përgjigjeve në heshtje të menaxhuesve dhe avokatëve. Dihet vetëm që marrin drejtimin e Luksemburgut, dhe pastaj asgjë më shumë. Vetëm pyetje të tjera pa përgjigje.

Në Turqi arrestohen edhe të 170 ushtarakë të tjerë

Autoritetet turke lëshuan urdhër-arreste për 170 njerëz, nën dyshimet se kanë lidhje me klerikun fetar, Fethullah Gulen, të cilin Ankara e akuzon për orkestrimin e përpjekjes për grushtshtet në vitin 2016. Agjencia e lajmeve Anadolu raporton se në shënjestër për arrestim janë ushtarakë të pensionuar apo në shërbim dhe se 22 prej tyre janë burgosur mëngjesin e sotëm, transmeton rel.

Në 19 muajt pas përpjekjes për puç, Turqia ka burgosur mbi 50,000 njerëz, ndërsa ka pezulluar ose pushuar nga puna rreth 150,000 të tjerë. Qeveria turke i hedh poshtë shqetësimet e grupeve të të drejtave të njeriut, duke thënë se vetëm një spastrim i tillë mund të neutralizojë kërcënimin që paraqet rrjeti i Gulenit.

Forcat qeveritare siriane bombardojnë vendbanimin me civilë



Bombardimet nga forcat qeveritare të Sirisë kanë vrarë dhjetëra civilë në provincën e Goutas Lindore, e cila kontrollohet nga rebelët. Së paku

98 civilë, përfshirë 20 fëmijë, janë vrarë të hënën në sulmet ajrore dhe me raketa, njoftoi sot Vëzhguesi Sirian i të Drejtave të Njeriut. Grupi moni-

torues, me seli në Londër, tha se 470 njerëz janë plagosur, disa prej tyre në gjendje kritike. Koordinatori për çështje humanitare i Kombeve të Bashkuara, Panos Moumtzis, tha se situata po del jashtë kontrollit dhe bëri thirrje për ndalimin e bombardimeve. Rreth 400,000 njerëz jetojnë në Goutan Lindore, e cila është nën rrethim qysh në vitin 2013. Besohet se ushtria po përgatit ofensivë tokësore në këtë rajon.

Arabia Saudite hap kinematë pas 35 vitesh

Heqja e ndalesës 35 vjeçare për kinematë në Arabinë Saudite ka shkaktuar valë të mëdha të reagimeve të ndryshme. Mbështetësit e rihapjes së kinemave thonë se kjo do të ndikojë pozitivisht në "investime dhe punësim" dhe se do të krijojë një atmosferë kulturore, ndërsa kundërshtuesit e nismës thonë se meqë vendi nuk ka një kinematografi vendore, atëherë kinematë nuk do të kenë kuptim tjetër pos imponimit të kulturës perëndimore. Ish-kreu i Shoqatës Kulturore dhe Artistike të Arabisë Saudite dhe këshilltari për media, Sultan el-Bazigi, rihapjen e kinemave pas 35 vitesh e cilësoi si "hap pozitiv". "Kjo gjendje padyshim që do të krijojë një atmosferë të ndryshme kulturore. Në të njëjtën kohë do të jetë edhe sektor i rëndësishëm për investim dhe punësim", u shpreh Bazigi. Ai poashtu tha se popullata e Arabisë Saudite nuk është e huaj në botën e kinemasë dhe shtoi: "Edhe përkundër faktit që sallat e kinemave ishin të mbyllura, shumica e popullatës kanë ndjekur nga afër kinematografinë arabe apo dhe të huaj nëpërmjet televizorit, tabletit apo dhe me shkuarjen në kinema gjatë vizitave të vendeve të tjera. E reja tani është që do mund të shikojnë filmat sapo të fillojnë të shfaqen". Në shpërndarjet në rrjetin social Twitter kishte prej atyre që mbështesnin rihapjen e kinemave me etiketën #HapjaEKinemaveNëRijad, por edhe përdorues që kundërshtojnë një gjë të këtillë.



Izraeli teston sistemin e ri të mbrojtjes raketore

Në një njoftim nga Ministria e Mbrojtjes e Izraelit thuhet se vendi ka realizuar testimin e një sistemi të ri të mbrojtjes nga raketat balistike me rreze të shkurtër, të mesme dhe të gjatë veprimi. Njoftohet se testimi ka qenë i suksesshëm. Siç thuhet, sistemi i ri i Izraelit është zhvilluar nga Industria Aviacionit Hapësinor të Izraelit dhe kompania amerikane ajrore dhe e mbrojtjes Boeing. Izraeli prej 50 vitesh mban nën pushtim Kudsën Lindor dhe Kodrat Golan, kurse për më shumë se dhjetë vite ka vendosur embargo në Rripin e Gazës.

Ata do ta ndjenin ndoshta për herë të fundit puhizën e lehtë të brigjeve të Adriatikut, pasi vetëm një vit më vonë do të shpërthente "Lufta e Madhe", e cila do të rezultonte me shumë pasoja për fatin e Rusisë dhe vetë njerëzimit

Nga Armand PLAKA

Prezencën e tyre në Shqipëri shumëkush e lidh apriori me vitet '50 të shekullit të shkuar, e disa me fundin e Luftës së Dytë Botërore, ndërsa në shtabin e partizanëve shqiptarë, duhej të ishte instaluar edhe një oficer ndërlidhës sovjetik si i dërguar special i Moskës në kuadër të Aleancës Antifashiste. Në një perceptim më të gjerë, prezenca e tyre më e hershme lidhet me rolin e bjellogardistëve (kundërshtarët e bolshevikëve në Rusinë postcariste) në shërbim të ish-Mbretit Zog në vitin 1924. Ndërkaq, historiografia zyrtare e njeh prezencën e tyre qysh në maj 1913, ndërsa ata erdhën si pjesë e forcave ndërkombëtare të dislokuara në Shkodër. Si anëtarë të Komisionit Ndërkombëtar të Kufijve (KNK), oficerët caristë, do të shkelnin kësaj për herë të parë në tokën shqiptare.

Siluetat e tyre shihen qartë në njërin nga fotot që shoqëron këtë tekst, në ditët e para të instalimit të detashmenteve të huaja në Shkodër, ku ndryshe nga austro-hungarezët, anglezët, italianët dhe gjermanët, ata nuk do të kishin të drejtë të "performonin" me parada ushtarake përballë vendasve kuriozë e në dukje edhe entuziastë, të lodhur tashmë aq shumë nga vuajtjet që u sollën malazetët me topat e armët e tyre në përpjekje për të përmbushur ëndrrën e tyre shekullore. Ata do të mjaftoheshin kësaj vetëm me prezencën fizike të një grushti oficerësh madhorë, stafi civil e diplomatësh. Pa e ditur, ata do ta ndjenin ndoshta për herë të fundit puhizën e lehtë të brigjeve të Adriatikut, pasi vetëm një vit më vonë do të shpërthente "Lufta e Madhe", e cila do të rezultonte me shumë pasoja për fatin e Rusisë

KUR OFICERËT E CARIT SHKELËN PËR HERË TË PARË SHQIPËRINË



dhe vetë njerëzimit.

Ndërsa lufta po shënonte një katastrofë për ushtrinë cariste, Revolucioni Bolshevik i tetorit 1917, do të bënte që shumë syresh të braktisnin vendin, ose të gjenin vdekjen në luftë të hapur me komunistët. Një tentativë e qeverisë së Nolit në vjeshtën e 1924, do të ngjallte sërish shpresën e Moskës zyrtare për të vënë këmbë në Shqipëri, por ajo do të përfundonte me ardhjen e kundërshtarëve të tyre politikë si triumfatorë në fundvitin 1924 e fillimvitin 1925, duke i dhënë një dorë të konsiderueshme përpjekjeve të rivalit më intim të Nolit, për t'u rikthyer në pushtet në bashkëpunim të ngushtë me jugosllavët. Do të duheshin edhe disa dekada që rusët të shkelnin sërish në Shqipëri, tashmë me një rol, pushtet e prezencë shumë më do-

methënëse, e cila do të kulmonte me vizitën e ish-shefit të atëhershëm të Kremlinit, Nikita Sergejeviç Hrushov në Tiranë, në vitin 1959. Ky do të ishte paradoksisht edhe kulmi i marrëdhënieve shqiptaroruse (dmth sovjetike), pasi ajo që pasoi, ishte një degradim shumë i shpejtë e radikal i marrëdhënieve të tyre ndërshtetërore (përveçse partiake). Pas viteve nëntëdhjetë, marrëdhëniet mes dy vendeve njohën një ringritje, megjithëse dinamika e tyre ka pësuar shpesh ulje-ngritje. Nën dritën e zhvillimeve të dy dekadave të fundit, e sidomos të viteve të fundit, hija e Moskës në Shqipëri është bërë sërish temë diskutimi, e artikulli rreth politikave të saj kundërshtetërore, njeh shpesh edhe tone të ashpra.

(gazeta shqip)



ALBERT FISH, HISTORIA E TMERRSHME E NJË MONSTRE

Përdhunues fëmijësh dhe kanibal, ai kishte shumë emra: Njeriu gri, Njeriu ujk i Wysteria-s, Vampiri i Bruklinit, Maniaku i Hënës...

Hamilton Howard Albert Fish ishte 33 vjeç kur kamera fotografike kapi imazhin e tij të parë. Një zotëri me mustaqe të prera mirë, rroba të mira dhe me kapelën e modës. Imazhi i parë dhe burgosja e parë. Akuza ishte përvetësim fondesh. Kishte shumë emra si Njeriu gri, Njeriu ujk i Wysteria-s, Vampiri i Bruklinit, Maniaku i hënës... Lindi në 19 maj të 1870 në Uashington D.C. Zgjedhi të quhej Albert pas vdekjes së njërit prej tre vëllezërve, por edhe për të hequr nofkën që i kishin dhënë në jetimore, ku kishte kaluar disa vite dhe e quanin "Ham and Eggs".

Lindi me stigmën se shumë nga Fish-ët vuanin nga sëmundje mendore. I ati, plakur Fish, kapiten i një anije vdiq nga infarkti në 1875 dhe nëna e tij, gati gjysëm shekulli më e vogël se i shoqi dhe pa asnjë kacidhe nuk kishte mundësi tjetër veçse jetimoren. Një fat me mure gri, ndëshkime, tallje, qortime, por edhe me një zbulim të ri: Alberti ndiente kënaqësi para dhimbjes fizike dhe grushtat i provokonin orgazma premature.

Në vitin 1879 nëna e tij gjeti një punë dhe i nxori nga jetimorja, por fati ishte shënuar. Në moshën 12 vjeçare filloi një marrëdhënie homoseksuale me djalin e një telegrafisti disi më i madh dhe filloi të fshihej në banjë dhe në pishina publike sepse e eksitonin aromat dhe tingujt. Shkoi akoma më tej, u bë vartës i urofagisë dhe koprofagisë dhe në moshën 20 vjeçare u vendos në Nju Jork nga u kthye në prostitutë dhe dhunues të adoleshentëve. E ëma mendonte se një martesë do ta largonte nga ajo botë e neveritshme dhe në vitin 1898 e detyroi të martohet me një grua 9 vjet më të vogël. U duk sikur kjo martesë funksionoi dhe e nxori nga rruga. Patën 6 fëmijë: Albert, Anna, Gertrude, Eugene, John dhe Henry.

Në ato vite ishte një baba i mirë, kujtonte një detektiv që e ndiqte dhe që në vitin 1903 e arrestoi për përvetësim të fondeve, krim që e futi në burg të Sing Sing-ut. Nju jorku jo vetëm që kishte instaluar një regjim të frikshëm, por edhe sepse ishte vendi i parë që kishte instaluar karrigen elektrike. Duhet deklaruar se marrëdhëniet seksuale mes Albertit dhe të burgosurve ishin legjendare. Megjithatë periudha e tij martesore dhe atërore



Para zhdukjes së 9 fëmijëve të tjerë, Alberi i dërgoi një letër avokatit të tij, ku detajonte për krimin e djalit 4 vjeçar, Billy Gaffney. Sipas kësaj letre-rituali ishte i njëjtë, goditje, gjyftime veshësh dhe hundësh, nxjerrje sysh, prerje ekstremitetesh dhe kanibalizëm deri në kufijtë më ekstreme të barbarisë



nuk ishte veçse një skenar paralel i normalitetit. Nën aparencën e një piktori të pafajshëm përdhunoj jo më pak se njëqind fëmijë, meshkuj që ishin jo më shumë se 6 vjeç. E sikur të mos mjaftonte kjo i shumëfishoi vizitat e tij në bordello duke u kërkuar prostitutave që ta lidhnin pa mëshirë, derisa të gjakosej, i

dukej e mahnitshme tredhja, madje u përpoq t'ia bënte një të vonuari mendtor, i cili arriti të ikte në kohë. Rreth moshës 47 vjeçare e shoqja e braktisi për një burrë tjetër dhe Alberti i shtoi një tjetër të dhënë jetës së tij. Thoshte se dëgjonte zëra, mes tyre atë të apostullit Xhon që i urdhëronte të rrotullohej në tapet, nuk dihet qëllimi i gjithë kësaj. Në moshën 60 vjeçare sulmoi një të sëmurë mendtor Thomas Bedden, në Delaware dhe vrau me thikë një fëmijë zezak edhe ky i vonuar mendtor në Georgetown. Këto ishin hapat e parë të një vepre tragjike të pa imagjinueshme edhe për policët më të stërvitur të romancierit Raymond Chandler. Në nëntor të 1934 një letër anonime i dërgohet prindërve të Grace Budd, një vajzë e zhdukur ku thuhej:

"E nderuar zonja Budd. Në vitin 1894 kishte rënë zija në Kinë. Mishi i çfarëdollojti kushtonte 1-3 dollarë kg. Kaq e madhe ishte vuajtja mes të varfërve, sa që fëmijët më të vegjël se 2 vjeç shiteshin si ushqim. Mund të hyje në çdo dyqan dhe të



Hyri në Sing Sing në mars të 1935, e lidhën në karrigen elektrike në 16 janar të 1936. Në orën 11:06 të mbrëmjes u shpall i vdekur. Kur "Old Sparky", kështu e quanin karrigen në zhargonin e përditshëm, shoi shkëndijat e fundit, shumë burra dhe gra fjetën të qetë atë natë, por frika e ngulur në shpirtin e tyre nuk iku kurrë



kërkoje një fileto. Të prapmet e një djali ose të një vajze janë pjesët më të mira të trupit dhe kishin një çmim më të lartë. Miku im, kapiteni John Davis u kthye në Nju Jork, vodhi dy fëmijë 7 dhe 8 vjeç, i çoi në shtëpi, i zhveshi, i futi në një dollap dhe i godiste disa herë në ditë në mënyrë që mishit të ishte më i butë. Në fillim vrau djalin e madh sepse i kishte vithet më të shëndosha. Çdo pjesë e trupit të tij u gatua dhe u konsumua me përjashtim të kokës, kockave dhe zorrëve. Djali i vogël e kishte radhën. Unë në atë kohë jetoja në rrugën 409E100. Ai më thoshte sesa i mirë ishte mishi i njeriut dhe unë vendosa ta provoj... Të dielën në 3 qershor të 1928 bëra të njëjtën gjë me vajzën tuaj, Grace. I solla një vazo me djathë dhe luleshtrydhe. Hëngrëm bashkë. Më puthi. Me preteksin se do ta çoja në një festë e mbylla në një shtëpi të braktisur në Westescher. Kur më pa plotësisht lakuriq filloi të qante dhe zbriti shkallët. E kapa, e mbyta, e preva në copa të vogla, e gatova dhe e hëngra. Sa të ëmbla dhe të buta ishin vithet e saj në furrë. M'u desh 9 ditë të ha të gjithë trupin e saj.

Nuk e preka edhe pse mund ta kisha bërë. Vdiq e virgjër".

Para zhdukjes së 9 fëmijëve të tjerë, Alberi i dërgoi një letër avokatit të tij, ku detajonte për krimin e djalit 4 vjeçar, Billy Gaffney. Sipas kësaj letre-rituali ishte i njëjtë, goditje, gjyftime veshësh dhe hundësh, nxjerrje sysh, prerje ekstremitetesh dhe kanibalizëm deri në kufijtë më ekstreme të barbarisë. U kap dhe u gjykua nga gjykatësi Frederick Close në Nju Jork dhe pas 10 ditësh beteje mes mbrojtjes dhe prokurorit, gjykatësi e shpalli të shëndetshëm dhe fajtor. Dënimi ishte me vdekje. Hyri në Sing Sing në mars të 1935, e lidhën në karrigen elektrike në 16 janar të 1936. Në orën 11:06 të mbrëmjes u shpall i vdekur. Kur "Old Sparky", kështu e quanin karrigen në zhargonin e përditshëm, shoi shkëndijat e fundit, shumë burra dhe gra fjetën të qetë atë natë, por frika e ngulur në shpirtin e tyre nuk iku kurrë, por as edhe pyetjet rreth tyre. Sa Albert Fish-a, sa përbindësja, sa vrasës, sa përdhunues, sa kanibalë kishte ende dhe me sa duhet të përballeshin ata?

AJNSHTAJNI PROTESTONTE PËR VRASJEN E SHUFLAJT

Agjentët serbë, 87 vjet më parë vranë studjuesin dhe albanologun e madh kroat Milan Shuflay. Ata ia thyen kokën me vare, bastisën apartamentin e tij dhe vodhën dorëshkrimin Kodeksi Albanikus, Vëllimi i Tretë, një vepër madhore për historinë dhe kulturën shqiptare që nuk është gjetur më, shkruan kryeredaktori i gazetës shqiptaro-amerikane "Ilyria", Ruben Avxhiu.

Sipas të gjitha gjasave është shkatërruar nga organizatorët e vrasjes së tij.

Për të është shkruar shumë, po një ngjarje interesante ka qenë protesta publike për vrasjen e tij

nga Albert Ajnshtajni dhe Hajnrish Man (shkrimtar dhe vëllai i të famshmit tjetër Tomas Man), të cilët dënuan publikisht Beogradin për këtë krim. Letra e tyre u botua në faqen e parë të gazetës së njohur "The New York Times". Madje, po ta shihni nga fotografia shoqëruese, kollona e tij është e para në numrin e ditës, të 5 majit 1931.

Letra e protestës që akuzonte drejtpërdrejt për terrorizëm mbretin jugosllav dhe klikën e Beogradit i drejtohej Ligës së të Drejtave


të Njeriut, me qendër në Paris. Për Ajnshtajnin dhe bashkëpunuesin e letrës, vrasja makabre e

albanologut shqiptar ishte një shembull më shumë e terrorizimit të inteligjencës kroate nga regjimi terrorist serbocentrik i Beogradit.



Avni Dehari promovon në Zvicër librin e tij

Në vigjilje të aktiviteteve për të nderuar kryetrimin shqiptar Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, mërgimtarët shqiptarë nga shumë qendra të Zvicrës, bashkë me LAPSH-in, nxënë dhe prindër të shumtë, do të shënojnë dhe festojnë në formë të ndryshme. Pjesë e këtyre festave është edhe përvetësimi i trilogjisë "Gjergjat në drita përkrenaresh" i shkrimtarit Avni Dehari. Grupet e organizimit të këtyre përvetësimeve në shumë qendra të Zvicrës falënderojnë të gjithë ata që kontribuuan në ribotimin e kësaj trilogjie dhe ftojnë dashamirët e librit të marrin pjesë në përvetësimin e këtij libri.



Një film nga Maqedonia në BERLINALE

Filmi debutues i Marisja Nikituk, bashkëproduksion mes Ukrainës, Polonisë dhe Maqedonisë, pati premierën botërore në festivalin e filmit në Berlin në programin "Panorama".

"Këtë vit, ky film është pjesëmarrja e vetme e Republikës së Maqedonisë në Berlinale prestigjioze. Nga ana e Maqedonisë në krijimin e tij morën pjesë montuesi Bllazhe Dulev, Aleksandar Pejovski është bashkë-kompozitor, ndërsa supervizor dhe kreator



i efekteve vizuale është Kërste Gopodinovski me tërë ekipin e artistëve për 3D dhe efekte vizuale",

producenti i filmit. Gjatë festivalit filmi do të ketë pesë projeksione dhe dy projeksione të mbyl-

lura për profesionistët filmik dhe do të garojë për disa çmime – për filmin e parë më të mirë (50.000), çmimin e publikut në "Panorama", çmimin CICA Art Cinema, çmimin Peace Film, çmimin e Heiner Carow, çmimin e Jurisë ekumene dhe për etiketën e Europa sineamas (Label Europa Cinemas). Filmi mori mbështetje financiare nga Agjencia shtetërore ukrainase për film, nga Instituti polak i filmit dhe nga Agjencia për film e Republikës së Maqedonisë.



Në Shkup hapet ekspozita ndërkombëtare "BRIDGE"

Bashkësia kulturore boshnjake në Republikën e Maqedonisë ka hapur të hënën ekspozitën e pestë ballkanike ndërkombëtare "BRIDGE" në Qendrën Informative-Kulturore.

Në ekspozitë janë prezantuar autorë - piktorë nga Turqia dhe Maqedonia. Promotorë të veprave ishin Fehim Huskoviç nga Fakulteti për Arte Figurative në Shkup dhe profesori i historisë së artit Xhemil Bektoviç nga Universiteti Ballkanik Internacional.

Në "Berlinale" mirëpritën kineastët kosovarë

Regjisoria Sarah Veltmeyer dhe tre aktorë nga Kosova kanë pozuar në fotografinë që dokumenton emocionet e tyre pas pritjes së mirë që i bëri audienca e "Berlinales" filmit "Kiem Holijanda".

Fotografia e shpërndarë nëpër rrjete sociale u realizua pas premierës së filmit në festivalin prestigjioz, në kuadër të programit "Generation 14 plus", shkruan "Koha Ditore".

Me "Kiem Holijanda", treshja nga Kosova u është bashkuar yjeve të filmit që kanë parakaluar në edicionin e 68-të të festivalit të filmit në Berlin, si Robert Pattinson, Bill



Murray, Tilda Swinton e të tjerë. Të dielën, në ditën e pestë të "Berlinales", filmi u dha në kinemanë

"CinemaxX". Një tjetër shfaqje do ta ketë të enjten në kinemanë "HKW" me kapacitet mbi një mijë

vendesh e pastaj më 24 dhe 25 do të shfaqet në "Cubix", që ka kapacitet mbi 700 vende.

Në një fshat të izoluar në Kosovë, 13 vjeçari Andi (Andi Bajgora) shet qumësht. Ai mundohet të kursejë para për ta blerë një telefon celular. Vëllai i tij më i madh, Floristi (Florist Bajgora) e ka një ëndërr krejtësisht tjetër, për të cilën familja nuk është në dijeni. Në kastë është edhe aktori kosovar Shpëtim Kastrati.

Në kuadër të "Market Screenings" atje janë shfaqur filmat "Martesa" nga Blerta Zeqiri dhe "Kthimi" nga Kastriot Abdyli.

Fituesit e BAFTA 2018

Katër fituesit e çmimeve në aktrim në Festivalin e Filmit të Britanisë së Madhe 2018, ishin shumë të parashikueshëm këtë vit.

Aktorët që fituan ishin të njëjtit që fituan në Golden Globes, The Critic's Choice Awards dhe SAG Awards muajin e kaluar.

Gary Oldman mori çmimin aktor më i mirë për "Darkest Hour", Frances McDormand fitoi aktorja më e mirë për "The Billboards Outside Ebbing, Missouri", Sam Rockwell fitoi aktori më i mirë mbështetës për "Three Billboards" dhe Allison Janney u emërua aktorja më e mirë mbështetëse për "I, Tonya".



Koha, e mërkurë 21 shkurt, 2018

KUPA E MAQEDONISË, ÇEREKFINALE

VARDARI DHE SHKËNDIJA VAZHDOJNË BETEJËN EDHE NË KUPË

Kjo do të jetë përballja e dytë për vitin 2018 mes Vardarit dhe Shkëndijës, pasi me 14 shkurt këto dy skuadra u përballën në Tetovë në kuadër të javës së 19-të në LPFM-së, duke luajtur 1-1. Nga klubi shqiptar bëjnë të ditur se në Shkup vijin për të marrë rezultat pozitiv dhe për të shënuar së paku një gol, i cili do t'ua kishte lehtësuar punën për ndeshjen kthyesë në Tetovë



Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 20 shkurt - Vardari dhe Shkëndija dy ekipet kuqezi do të përballen sot (e mërkurë) përsëri, por kësaj radhe në kuadër të çerek-finale të Kupës së Maqedonisë. Edhe pse spekulohet me stadiumin në lagjen Gjorçe Petrov, nga FFM konfirmuan se përballja mes dy rivalëve të mëdhenj do të zhvillohet në arenën "Filipi i dytë" me fillim në ora 14. Derisa ndeshja kthyesë do të zhvillohet me 7 mars në stadiumin e qytetit në Tetovë. Ndryshe, kjo do të jetë përballja e dytë për vitin 2018 mes Vardarit dhe Shkëndijës, pasi me 14 shkurt këto dy skuadra u përballën në Tetovë në kuadër të javës së 19-të në LPFM-së, duke luajtur 1-1. Nga klubi shqiptar bëjnë të ditur se në Shkup vijin për të marrë rezultat pozitiv dhe për të shënuar së paku një gol, i cili do t'ua kishte lehtësuar punën për ndeshjen kthyesë në Tetovë. Kështu mendon edhe mesfushori nga Kumanova, Armend Alimi. "Unë mendoj se kjo sfidë do të ketë

dallim nga ndeshja e parë ku presioni do të jetë më i vogël. Besoj se do të jemi më të mirë se ndeshja e parë ku shpresojmë që të dalim me një rezultat pozitiv nga arena "Filipi i dytë". Rezultati pozitiv nënkupton faktin se ne gjithmonë shkojmë për fitore, por do të ishim të kënaqur edhe me një barazim me gol të shënuar. Pa marr parasysh se me cilin rezultat do të përfundojë ndeshja, nuk do të përfundojnë gjërat që në sfidën e parë dhe se ndeshja do të vendoset në stadiumin e qytetit në Tetovë. Luajmë futboll të hapur dhe nuk e kemi problem të shënojmë pa marr parasysh se kundër cilit ekip luajmë. Do të jetë shumë me rëndësi nëse sot shënojmë së paku një gol", deklaroi për gazetën KOHA, Armend Alimi.

Ndërkohë, kjo ndeshje është shpall me

rrezik të lartë, ndërsa siç praktikohet në të kaluarën, edhe kësaj radhe nuk do të ketë tifoz të KF Shkëndija, ndërsa e njëjta do të ndodh edhe në ndeshjen kthyesë, me tifozët e KF Vardar. Nga KF Vardar gjithashtu njoftojnë se në përdorim do të lëshohet vetëm tribuna jugore, ndërsa biletat për këtë ndeshje do të shiten dy orë para fillimit të kësaj përballje, mes orës 12 deri 14, derisa të njëjta do të mund të blihen vetëm me dokument identifikimi. Gjithashtu nga klubi shkupjan apelojnë deri tek tifozët e tyre të vijin në numër sa më të madh dhe njëkohësisht me anim korrekt dhe pa ofendime në baza nacionale dhe raciste, të përkrahin ekipin e tyre. Cekim, që moti janë mësuar emrat e skuadrave që janë plasuar në gjysmëfinale dhe ato janë, Pelisteri, Akademija Pandev dhe Renova.



Salihu zotohet për një turnir të madh

Aziz Salihu zotohet se nuk do të ketë më shtyrje të turneut ndërkombëtar në boks, "Faleminderit SHBA dhe Diasporë". Kryetari i klubit të boksit "Prishtina", Aziz Salihu, shpreson se turneun do ta mbështesin institucionet shtetërore, si Qeveria e Kosovës, Ministria e Sportit dhe po ashtu i ka premtuar mbështetje edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli. "Pas gjithë këtyre mundimeve do të mbajë turneun 'Faleminderit SHBA dhe diasporë'. SHBA-të dhe diaspora na kanë ndihmuar si në kohën e luftës si tani dhe jam i lumtur që do t'i nderojë me këtë turne", tha Salihu në konferencë me gazetarë. "Çka janë 5-7 mijë euro për ta mbështetur këtë turne, që organizohet për të falënderuar SHBA-të dhe diasporën. Do të ketë ndeshje të forta e cilësore. Turnetë si gjithëherë kanë qenë të mira që i kam organizuar kështu do të jetë edhe tani. Lus qeverinë që të më ndihmojë sepse deri me tash 80 për qind për mbajtjen e turneve kam shpenzuar nga xhepi, 20 për qind më ndihmuar të tjerët", tregon 'Zizi'. Fituesi i medaljes së bronzit olimpik në vitin 1984, është i zhgënjyer me përkrahjen që ka deri me tash. "Nuk e kam pritur se më vjen dita e më harrojnë. Prishtina historikisht ka qenë klubi më i mirë në botë. Është gjynah që nuk e kemi një sallë si klub i boksit Prishtina, që nuk kushton më shumë se 40-50 mijë euro", tha Salihu. Gazmend Gashi, drejtor sportiv i KBO Prishtina, tha se në turne marrin pjesë shtatë klube. "Jemi në fazën finale të turneut. Pjesëmarrjen e kanë konfirmuar shtatë shtete: Shqipëria, Mali i Zi, Kroacia, Bullgaria, Maqedonia, Gjermania dhe pjesëmarrës janë edhe boksierët e Kosovës. Do të mbahen tetë meçe, plus 3-4 parameçe me të rinjtë dhe priten meçe cilësore. Pritet të marrin pjesë përafërsisht 40 boksierë", thotë Gashi.

Maqedonia dhe Bosnja barazojnë pa gola

Shkup, 20 shkurt - Përfaqësuesja e Maqedonisë deri 17-të vjeç ka luajtur 0-0 kundër Bosnjës dhe Hercegovinës në ndeshjen e parë miqësore, e cila u zhvillua dje në qendrën stërvitore "Petar Milloshevski" në Shkup. Djemtë e seleksionuesit Goran Staniq ishin më të mirë për dallim prej moshatarëve të tyre nga Bosnja, të cilët ishin të orientuar në mbrojtje. Ndryshe, këto dy

përfaqësues të enjten do të zhvillojnë edhe një ndeshje kontrolluese, të cilat po shërbejnë si përgatitje për kualifikimet në Kampionatin Evropian. Cekim, Maqedonia është pjesë e grupit kualifikues elitare, e cila do të mbahet në Poloni nga 19 e deri më 28 mars, ndërsa kundërshtarët e tyre do të jenë Polonia, Gjeorgjia dhe Republika e Irlandës.



SKËNDERBEU DEL ME KOMUNIKATË TË RE

Trukimi është individual, jo kolektiv

Përmes një komunikate të radhës për shtyp, KF Skënderbeu kërkon të sqarojë opinionin publik, sa iu përket deklaramenteve të bëra nga avokati Zuçereti gjatë seancës dëgjimore në CAS: "Ashtu siç është transkriptuar qartësisht nga regjistrimet e kësaj seance, përfaqësuesi ynë ligjor në vitin 2016 ka komentuar faktin se luhatjet e koeficienteve të basteve "live" për ndeshjet e KF Skënderbeut janë të pakundërshtueshme, por assesi nuk mund të arrihet në një përfundim se ndeshjet janë të trukuara. Ky qëndrim i avokatit Zuçereti është konfirmuar edhe nga CAS, ku në vendimin për moslejimin e

klubit tonë të garojë në "Champions League" 2016-2017, ka saktësuar se në analizë të raporteve të "UEFA BFDS", nuk është e mundur të provohet trukimi i ndeshjeve, apo përfshirja direkt e klubit në këto aktivitete të paligjshme", thonë nga skuadra korçare. "Ndër të tjera, mundësia e përfshirjes së lojtarëve në trukim ndeshjesh është ngritur thjesht si hipotezë nga ana e përfaqësuesit tonë në proces, jo si një akuzë, por si një formë për të evidentuar se në një proces disiplinor, shkeljet dhe shkelësit e disiplinës duhen individualizuar dhe mos të kryhet një proces popullist, ku të gjithë janë

të fajshëm, por asnjëri nuk është fajtor. Ky element ka një prejardhje të drejtpërdrejtë nga praktika gjyqësore e CAS-it dhe gjykatave në rang federal dhe shërben si një garanci për një proces të rregullt e ligjor", thuhet më tej në komunikatën e Skënderbeut. "KF Skënderbeu beson tërësisht në integritetin profesional dhe personal të çdo lojtari, apo anëtarit të stafit teknik të klubit, aktual dhe të shkuar, e nuk do të ngurrojë në asnjë çast t'i mbrojë ata nga çfarëdolloj akuzë të ngritur pa fakte apo bazë ligjore. Së fundi, KF Skënderbeu dënon atë pjesë të medias së shkruar dhe vi-



zive, e cila në padijeni të plotë ndaj fakteve dhe argumenteve ligjore, dekontekstualizon thëniet e përfaqësuesit tonë ligjor për qëllime destabilizuese apo denigruese. Sa iu përket pretendimeve të inspektoreve të UEFA-s në lidhje me këtë keqpërdorim të thënieve të avoka-

ti Zuçereti, përgjigja e KF Skënderbeut do të jepet në rrugë gjyqësore, ku nuk do të kursehem në asnjë çast për të mbrojtur integritetin, rezultatet dhe meritat e familjes tonë të madhe sportive", përfundon komunikatën zyra për shtyp e KF Skënderbeu.

Në bazë të nenit 28 të Statutit të Shoqërisë aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 187/2015, 94/16 dhe 158/16) dhe nenit 2 të Rregullores për kushtet, mënyrën dhe procedurën për shitje të materialit të nxjerrë shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtrati i lumit të Shoqërisë aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë në pronësi të shtetit, Shkup përmes ankandit publik me gojë nr. 0202-3572 të datës 30.09.2016, me autorizim të Drejtorit i përgjithshëm ekzekutiv i Shoqërisë aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë në pronësi të shtetit, Shkup nr. 0204-3308 të datës 10.11.2017 publikon:

THIRRJE PUBLIKE

Për shitje të materialit shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtretërit e lumit

Shoqëria aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë në pronësi të shtetit, Shkup bën shitjen e materialit tepricë shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtrati i Lumit Kriva Reka, në bedelin e KK Moshtenicë dhe KK Dllaboçicë, në gjatësi të përgjithshme prej 990 m, komuna e Kriva Pallankës, në pajtim me pëlqimin e Ekonomisë së ujërave për rregullim të një pjese të shtratit të Lumit Kriva Reka UP1 nr. 11/5-1664/2017 të datës 22.01.2018 të dhënë nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

Çmimi fillestar i materialit tepricë shkarkues – rërë, zhavorr dhe gurë nga shtrati i lumit është 55,00 denarë plus 7 % kompensim për ujëtar plus 18 % TVSH, ndërsa sasia nuk guxon të kalojë më shumë se 11.453,33 m3.

Ngarkimi i materialit të lumit bie në barrë të blerësit.

Shpallja zgjatë 3 (tri) ditë nga dita e publikimit.

Ofertat duhet të jenë në zarf të mbyllur me shenjë "OFERTË – MOS HAP", për Komisionin për realizim të procedurës së ankandit publik, pa adresë, vulë dhe shenja të tjera në të.

Oferta duhet të përmbajë: emrin dhe selinë e firmës, numër tatimor, personi përgjegjës, kontakt telefon, llogari dhe bankë deponuse, me theksim të saktë shumës së ofruar në ofertë të mbyllur.

Së bashku me ofertën parashtrihen dokumentet në vijim për dëshmim të:

1. Gjendjes personale:

- Deklaratë të operatorit ekonomik se në pesë vitet e fundit nuk i është shqiptuar vendim i plotfuqishëm për pjesëmarrje në organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim ose larje parash,
- Vërtetim se nuk i është hapur procedurë për falimentim nga organi kompetent,
- Vërtetim se nuk i është hapur procedurë për likuidim nga organi kompetent,
- Vërtetim nga Regjistri i dënimeve për vepra të realizuara penale të subjekteve juridike se nuk i është shqiptuar dënim i rendit të dytë ndalesë për pjesëmarrje në procedurë për thirrje publike, ndarje të marrëveshjes për furnizim publik dhe marrëveshje për partneritet publik privat,
- Vërtetim nga Regjistri i dënimeve për vepra të realizuara penale të subjekteve juridike se nuk i është shqiptuar dënim i rendit të dytë ndalesë e përkohshme ose e përhershme për kryerje të veprimtarive të veçanta,
- Vërtetim se me vendim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, gjegjësisht ndalesë të përkohshme për kryerje të veprimtarisë së veçantë
- Vërtetim për tatime të paguara.

2. Aftësi për kryerje të veprimtarisë profesionale:

- Dokument për veprimtari të regjistruar – si dëshmi se është i regjistruar si subjekt fizik ose juridik,

Dokumentet e kërkuara nuk guxojnë të jenë më të vjetra se 6 (gjashtë) muaj, ndërsa parashtrihen në original ose kopje të vërtetuar nga ofertuesi.

Së bashku me ofertën duhet të parashtrihet dëshmi për depozitë të paguar në shumë prej 500.000,00 denarë. Ofertuesve që nuk janë të zgjedhur u kthehet depozita e paguar, në afat prej 15 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit.

Depozita duhet të paguhet në llogarinë me numër 200002947890520 deponent Stopanska Banka SHA Shkup.

Hapjen e ofertave do ta realizojë Komisioni për realizim të procedurës për ankand publik, emëruar nga Drejtori i përgjithshëm ekzekutiv i Shoqërisë aksionare Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup më datë 23.02.2018 në ora 10.00 në lokalet e SHA Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup në rr. "3-ta Makedonska Brigada" nr. 10a Shkup.

Shitja e materialit shkarkues bëhet përmes ankandit publik me gojë.

Procedura për ankandin publik realizohet në tri faza:

Faza e parë – përcaktimi i kandidatëve që përmbushin kushtet për pjesëmarrje në ankand

Faza e dytë – identifikim të regjistrimit të pjesëmarrësve

Faza e tretë – ankandin publik

Në ankandin publik mund të merr pjesë vetëm personi përgjegjës i ofertuesit ose personi i autorizuar nga ai.

Pas zgjedhjes së realizuar, SHA Ekonomia e ujërave të Republikës së Maqedonisë, në pronësi të shtetit, Shkup do të lidhë marrëveshje me ofertuesin më të volitshëm të zgjedhur për rregullim të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella, që është i obliguar që të parashtrijë garanci bankare në shumë prej 10% të vlerës së përgjithshme të marrëveshjes.

Informacione më të detajuara mund të merren në numrin e telefonit 078-440-515 – Andrea Najdenovski.

Në bazë të Aktvendimit për formimin e komisionit për ndarjen e bursave me nr. 09-170/1 të dt. 09.02.2018 dhe programit EO, nënzhëri 464110 – bursa për studentë, nga Vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Likovës, për vitin 2018 me nr. 08-860/3 të dt. 25.12.2017, Komuna e Likovës, shpall:

Konkurs për ndarjen e bursave për studentët e regjistruar në studimet deridiplomike, që janë me vendbanim të përhershëm në Komunën e Likovës.

Komuna e Likovës për vitin akademik 2017/2018 do të ndajë bursa për 20 studentë të rregullt të regjistruar në studimet deridiplomike në universitetet publike, edhe atë sipas llojeve vijuese:

TIPI A – 5 bursa për studentët me notë mesatare më të madhe

- Nota mesatare të mos jetë më e vogël se 8,00.

TIPI B - 5 bursa për studentët e fakulteteve të shkencave natyrore, mjekësore dhe teknike, drejtimit: matematikë, fizikë, mjekësi e përgjithshme, stomatologji, elektro, makineri, gjeodezi, ambient jetësor, ndërtime dhe arkitekturë.

- Nota mesatare më e madhe do të ketë përparësi

TIPI C - 10 bursa për studentët që janë të kategorisë sociale.

- Vërtetim për të hyrat familjare prej Drejtorisë për të hyra publike (të dy prindërve)
- Nota mesatare më e madhe do të ketë përparësi

KUSHTET PËR NDARJEN E BURSAVE

Të drejtë për bursë kanë studentët që janë të regjistruar në studime deridiplomike që i plotësojnë këto kushte:

1. Të jenë student të rregullt
2. Mos të kenë përsërit vit gjatë studimeve
3. Mos të jenë shfrytëzues të ndonjë burse ose kredie nga ndonjë institucion ose kompani tjetër dhe
4. Të jenë shtetas të RM-së.

MËNYRA DHE AFATI I PARAQITJES

Studentët e interesuar dokumentet e nevojshme i dorëzojnë në Arkivin e Komunës së Likovës edhe atë duke filluar nga data: 21.02.2018 deri më datë: 07.03.2018 dhe njëherit mund të dorëzohen edhe përmes postës në adresën: Komuna e Likovës, f. Likovë, 1307.

LARTËSIA E BURSËS

Lartësia e bursës për studentë do të jetë në shumë prej 1350,00 denarëve në muaj, në afat prej 9 muajve gjatë studimeve.

DOKUMENTET E NEVOJSHME

- Kërkesë për aplikim në konkurs (të potencohet se për cilin tip konkurron)
- Deklaratë e kandidatit se nuk është shfrytëzues i ndonjë burse tjetër
- Kopje të shtetësisë së RM-së
- Kopje të indeksit (fotokopje e indeksit në tërësi).

Konkursi do të shpallet në ueb – faqen zyrtare të Komunës së Likovës: www.komunaelikoves.gov.mk, në dy gazeta ditore, në gjuhën maqedone dhe në gjuhën shqipe, si dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës së Likovës.

Komisioni në afat prej 5 ditëve nga dita e mbarimit të konkursit do të përgatis listë prej 20 studentëve për të cilët për vendosje do ti dorëzohet Kryetarit të Komunës së Likovës.

Kandidatët të cilët nuk do zgjidhen do të kenë të drejtë në ankesë në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e shpalljes të listës në ueb faqen zyrtare të Komunës së Likovës.

Komuna e Likovës

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie e pune dhe neni 20-g dhe neni 24-d të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik, si dhe në pajtim me Pëlqimin e MASH-it me nr. 12-1525/1 të 5.2.2018, SHMK „Niko Nestor“, -Strugë publikon këtë:

Shpallje publike nr. 3/2018 për pranim të punëtorëve me kohë të pacaktuar

I. SHMK „Niko Nestor“, -Strugë-ka nevojë për punësim për kokë të pacaktuar pune

Nr.rend	Shifra	Titulli i vendit të punës	Nr.i kryerësve
1	OBN 04 01 A01 002	Mirëmbajtës të higjienës	2

1. Secili kandidat duhet t'i plotësojë kushtet e përgjithshme të parapara me Ligj dhe kushtet e veçanta të përcaktuara në Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës të shkollës, gjegjësisht të kenë kryer arsimin fillor.

Koha e punës është 5 ditë pune në javë (prej të hënën deri të premten) në dy ndërrime: ndërrimi i parë fillon nga ora 6.00 deri më 14.00, ndërsa ndërrimi i dytë nga ora 14.00 deri më 20.00.

2. Rroga themelore neto është 12.000,00 denarë.
3. Kandidatët për punësim paraqiten në shpallje nëpërmjet të plotësimit të fletëparaqitjes. Fletëparaqitjen për punë kandidatët mund ta marrin në shkollë.

4. Bashkangjitur me fletëparaqitjen duhet të dorëzojnë :

- dëshmi për arsimimin e kryer (dëftesë original ose të vërtetuar në notar)

- certifikatë të nënshtetësisë të RM-së

Fletëparaqitjet bashkë me dokumentacionin përkatës dorëzohen personalisht në shkollë ose nëpërmjet postës në adresën : rruga „Brigadat proletare“, nr. 49-Strugë, tel. 046/780020, personi për kontakt Erzena Ziba

Shpallja është e hapur 5 ditë pune nga dita e publikimit.

Fletëparaqitjet e parashtruara pas afatit, të paplotësuara dhe jopletësuara nuk do të jenë objekt i shqyrtimit nga ana e Komisionit për zbatimin e procedurës për punësim.

5. Procedura për selektimin e kandidatëve të paraqitur ka të bëjë me kontrollimin e fletëparaqitjeve dhe saktësinë e të dhënave dhe fakteve të parashtruara.

Zgjedhja e kandidatëve të paraqitur do të bëhet në afat prej 15 ditësh nga dita e mbylljes së shpalljes.

**SHMK „NIKO NESTOR“, -STRUGË
U. d. D r e j t o r,
Besime Jonuzi**

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 167/2015 dhe 27/2016), neni 79-d të Ligjit për arsim fillor, ndërsa në lidhje me Pëlqimet e miratuara për punësim për kohë të pacaktuar të punës për vitin shkollor 2017/2018 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës nr. 12-12701/7 të datës 25.01.2018, SHFK "Partenija Zografski", Kisella Voda – Shkup publikon

SHPALLJE Për punësim për kohë të pacaktuar të punës

1. Mirëmbajtës të higjienës për kohë të pacaktuar të punës me orar të plotë të punës – një (1) realizues

Kushtet e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Të jetë i moshës së rritur,
- Të ketë të mbaruar arsimin fillor

Orari i kohës së punës

- Ditët e punës e hënë – e premte
- Orët e punës në javë 40
- Orari i punës me ndërrime prej ora 07:00 deri në ora 15:00 dhe prej ora 11:00 deri në ora 19:00

Neto shuma në të holla e rrogës: 12 000,00 denarë

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrijë:

- Lutje;
- Dëshmi për arsim të mbaruar (original ose kopje të vërtetuar në noter);
- Certifikatë të shtetësisë (original ose kopje të vërtetuar në noter);

Afati për parashtrimin e dokumenteve është pesë (5) ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes. Vendimi për zgjedhje do të realizohet në afat prej 45 ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje.

Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit dhe i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

Dokumentet të parashtrihen personalisht ose përmes postës në adresën SHFK "Partenija Zografski", Kisella Vodë – Shkup, rr. Dositej Obradović nr. 18 – Shkup, tel. 2770 -719.

Në bazë të nenit 135 paragrafi 1 të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 35/2008; 103/2008; 26/2009; 83/2009; 99/2009; 115/2010; 17/2011; 51/2011; 123/2012; 15/2013; 24/2013; 41/2014; 116/2014; 130/2014; 10/2015; 20/2015; 98/2015; 145/2015; 154/2015, 30/2016, 120/2016 dhe 127/2016) dhe nenit 34 paragrafi 2 i Rregullores për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional, bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 138/09, 140/09, 173/11, 194/11, 250/2013 dhe 274/2013), rektori i Universitetit "Shën. Kirili dhe Metodij" në Shkup, me propozim të Dekanit të Fakultetit matematiko-natyror në Shkup, publikon

KONKURS

për zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor të grupit të lëndëve të sferës mësimore-shkencore:

➤ *Ekologjia*

Kushtet: Krahas kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe aktet tjera të Universitetit.

Me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë edhe: biografi të shkurtër, deklaratë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës dhe certifikatë të shtetësisë.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Orari i punës së mësimdhënësit është caktuar në pajtim me aktet e Fakultetit.

Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit.

Dokumentet dorëzohen në Fakultetin matematiko-natyror në Shkup, rr. Arihedova nr. 3, 1000 Shkup.

Universiteti "Shën. Kirili dhe Metodij" në Shkup

Në bazë të nenit 80 dhe nenit 82 paragrafi 1 të Ligjit për arsim fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 103/2008; 33/2010; 116/2010; 156/2010; 18/2011; 42/2011, 51/2011; 6/2012, 100/2012, 24/2013, 14/2014, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15 dhe 145/15) dhe nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 167/15), SHFK "Kosta Racin" f. Podaresh publikon,

SHPALLJE PUBLIKE

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në vitin shkollor
2017/2018

1. 1 (një) mirëmbajtës të higjienës në SHP "Kosta Racin" f. Jargulicë, me orar të plotë të punës;

Vendet e punës nën pikën 1 janë me kohë të pacaktuar. Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me ligj kandidatët e interesuar duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

Për vendet e punës nën pikën 1 orari i punës do të jetë prej ora 06:30 deri në ora 14:30. Paga fillestare për të punësuarit do të jetë 12.000,00 MKD. Krahas fletëparaqitjeve për vendet e punës nën pikën 1 kandidatët të parashtrijë dëshmi për arsimin e mbaruar (fillor) përkatës dhe certifikatë të shtetësisë.

Dokumentet e parashtruara të jenë në original ose kopje të vërtetuara në noter. Dokumentet e nevojshme parashtrihen në arkivin e shkollës.

Shpallja zgjatë pesë ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Lutjet së bashku me dokumentet e theksuara parashtrihen përmes arkivit të shkollës SHFK "Kosta Racin" f. Podaresh, tel. 032/641-414. Zgjedhja e kandidatëve do të realizohet në afat prej 30 ditëve pas përfundimit të shpalljes publike.

**SHFK "Kosta Racin" f. Podaresh
UD Drejtor,
Gordana Manteva Tashkova**

Sipas raporteve të “La Gazzetta dello Sport”, mbrojtësi holandez ka arritur një marrëveshje të gjatë me Interin, në bazë të një bonusi pesëvjeçar prej 4.2 milionë euro në sezon. Një ofertë shumë më e lartë se ajo e Lacios, që ofroi një rinovim njëvjeçar, me 2.5 milionë euro, e cila mbante brenda një klauzolë 25 milionë euro largimi

DEVRIJ NUK RINOVON KONTRATËN ME LACION

INTERI E MERR ME PARAMETRA ZERO

Konfirmimi zyrtar erdhi përpara ndeshjes Lacio-Verona nga Igli Tare se Stefan De Vrij nuk do të rinovojë kontratën me bardhekaltrit dhe është i lirë të gjejë një ekip tjetër. Ose ndoshta e ka gjetur tashmë. Sipas raporteve të “La Gazzetta dello Sport”, mbrojtësi holandez ka arritur një marrëveshje të gjatë me Interin, në bazë të një bonusi pesëvjeçar prej 4.2 milionë euro në sezon. Një ofertë shumë më e lartë se ajo e Lacios, që ofroi një rinovim njëvjeçar, me 2.5 milionë euro, e cila mbante brenda një klauzolë 25 milionë euro largimi. Në fakt, De Vrij, deri disa javë më parë dukej në prag të nënshkrimit. Për të parandaluar “tymin e bardhë” ka menduar “Seg”, agjencia që duket pas interesave të De Vrij, e cila ka siguruar kontratën e majme financiare, të propozuar nga Interi. “Ka një limit për të, se si gjërat shkuan, kjo është një çështje e drejtësisë. Ai ka qenë një profesio-

nist i shquar, ka dhënë aq shumë për Lacion dhe Lacio i ka dhënë aq shumë atij, por në fund të sezonit rrugët tona ndahen. Nuk ka asgjë të keqe, e falënderojmë Stefan për atë që dha, por tani për tani nuk themi arsyt e ndarjes. E vetmja gjë e sigurt është se në botë nuk ka mungesë të lojtarëve dhe ne do të duhet të jemi të mirë në gjetjen e tyre”, – shpjegoi Igli Tare në “Premium”. Humbja e De Vrij me parametër zero, në çdo rast mbetet një goditje e fortë për Lacion, ndërsa blerja e tij do të jetë një marrëveshje e madhe për Interin. Në këtë mënyrë, holandezi do të formonte me Shkrianiar një duet mbrojtës absolut për vitet e ardhshme. Tani, me pak fjalë, vetëm duhet të presim për nënshkrimin dhe zyrtarizimin e tij si zikaltër. Ndërkohë, tifozët e Interit ëndërojnë.



Publicitet

Në pajtim me nenin 17 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve për nxënës dhe aktiviteve tjera të lira për nxënës, si dhe Programit vjetor për punë të SHFK “Mirçe Acev” – Shkup, për vitin shkollor 2017/2018 publikohet

SHPALLJE PUBLIKE Për grumbullimin e ofertave për organizim të ekskursioneve për vitin shkollor 2017/18

PJESA 1. Ekskursion treditör në Ohër, për nxënës të klasës së IX.
PJESA 2. Mësim në natyrë në Ohër, për nxënës të klasës së V.
PJESA 3. Ekskursion dyditor në Strumicë, për nxënës të klasës së V.
PJESA 4. Ekskursion njëditor në Stobi, për nxënës të klasës së III
PJESA 5. Piknik njëditor pranveror – Vodno, për nxënës prej klasës së I deri në të IX.

Lënda e furnizimit është e ndashme.

Kushtet minimale që duhet të përmbushë ofertuesi:

- Që të merr pjesë në procedurë për lidhje të marrëveshjes, ofertuesi duhet të jetë i regjistruar si subjekt juridik për kryerje të veprimtarisë përkatëse turistike ose t'i takojë ndonjë shoqata përkatëse profesionale në pajtim me dispozitatë pozitive në Republikën e Maqedonisë.
 - Që të kualifikohet si i aftë për realizimin e lëndës për furnizim, ofertuesi nga aspekti i aftësisë së vet teknike dhe profesionale duhet të ketë të realizuar në mënyrë të suksesshme së paku 3 (tri) ekskursione për nxënës dhe aktiviteve tjera të lira në 3 (tri) vitet e fundit.
 - Që të kualifikohet si i aftë për realizimin e lëndës së furnizimit ofertuesi duhet të përmbushë kushtet për transport të grupit të fëmijëve, në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilët udhëtojnë grupet e fëmijëve.
- Që të dëshmojë se përmbushë kushtet minimale ofertuesi duhet të parashtrijë:
- Dokument për veprimtaritë të regjistruar të dhënë nga Regjistri Qendror i RM (jo më të vjetër se 6 muaj) dhe Licencë valide (A).
 - Vërtetime të shoqëruara me marrëveshje të lidhura me shkollat për realizim të suksesshëm të së paku 3 (tre) ekskursioneve për nxënës ose aktiviteve tjera të lira në 3 (tri) vitet e fundit.
 - Certifikatë të licencës për kryerje të transportit publik në komunikacionin e brendshëm rrugor të transportuesit Marrëveshje për angazhim të transportuesit dhe Vërtetime (të dhënë nga organi kompetent) për rregullshmëri teknike të makinave për transport publik të bashkëngjitur me lejet e qarkullimit për minimum 2 (dy) autobusë.

Dokumentet të jenë në origjinal ose kopje të vërtetuara me vulë dhe nënshkrim nga personi përgjegjës dhe të shënojnë “E besueshme me origjinalin”.

Oferta e ofertuesit që nuk përmbushë kushtet minimale dhe nuk parashtron dokumentet e kërkuara si dëshmi në bazë të kriterëve nr. 1, 2 dhe 3 të shpalljes, do të refuzohet nga ana e Komisionit si e papranueshme dhe nuk do të merr pjesë në fazat e mëtejshme të procedurës.

Në ditën e nënshkrimit të marrëveshjes ofertuesi i zgjedhur parashtron garanci bankare për realizim kualitativ të ekskursionit në shumë prej 15% të vlerës së përgjithshme të marrëveshjes.

Dokumentacioni me kushtet për kualifikim të ofertuesve, kushtet për realizim dhe të dhënat për aktivitetet e Programit për ekskursione dhe verime mund të merren në arkivin e shkollës çdo ditë pune prej ora 9 deri në ora 15.

Ofertat të parashtrihen: përmes postës deri më 28.02.2018 ose personalisht në arkivin e shkollës deri më 01.03.2018 deri në ora 16:00 kur do të realizohet hapja publike e ofertave. Në hapjen publike mund të marrin pjesë edhe përfaqësues të ofertuesve me autorizim të rregullt.

SHFK “Mirçe Acev” – Shkup
rr. Meçkin Kamen nr. 26

I. Nr. 324/2014

SHPALLJE PUBLIKE (në bazë të nenit 46-b, të Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për përbarim, Gazeta Zyrtare nr. 8 të datës 17.01.2008)

Përbaruesi Vanço Markovski duke vepruar me propozim të kreditort Eshref Ajruli, përmes atit, avokatit Branko Trajkovski nga Tetova dhe vendbanim në rr. Drenoec – Poroj nr. 8, kundër borxhit Husein Memedi nga Tetova me NVAQ dhe vendbanim në rr. Lubo Bozhinovski Pish nr. 69, dhe borxhit pengmarrës Imer Shaqiri nga Tetova me NVAQ dhe vendbanim në rr. Lubotenska nr. 69 në Tetovë, për shkak të realizimit në holla në shumë prej 24.600.000,00 denarë më datë 15.02.2018

FTON

Borxhliu pengmarrës Imer Shaqiri nga Tetova me NVAQ dhe vendbanim në rr. Lubotenska nr. 69 në Tetovë të paraqit në zyrën e përbaruesit Vanço Markovski në rr. Ilindenska nr. 64 Tetovë, për parashtrim të akteve në vijim: procesverbal i. nr. 324/2014 të datës 19.12.2017, të përpiluar në bazë të nenit 84 paragrafi 8 të LP, Procesverbalin për zbrazjen dhe dhënien në pronësi të patundshmerisë i. nr. 324/2014 të datës 19.12.2017, të përpiluar në bazë të nenit 226 paragrafi 1 dhe 189 paragrafi 3 të LP, Procesverbal për shlyjen publike me gojë i. nr. 324/2014 të datës 07.02.2018, të përpiluar në bazë të nenit 175 paragrafi 4 nga LP, Konkluzion për shlyjen e dytë publike me gojë i. nr. 324/2014 të datës 07.02.2018, Konkluzion për përcaktimin e vlerës për shlyjen e dytë i. nr. 324/2014 të datës 07.02.2018, NË AFAT PREJ 1 (NJË) DITE, duke llogaritur nga dita e publikimit të fundit të kësaj thirrje publike në shtypin ditor.

PARALAJMËROHET borxhliu pengmarrës Imer Shaqiri se mënyra e këtillë e dorëzimit llogaritit si dorëzim në rregull dhe se për pasojat negative që mund të dalin i bartë vet pata.

Kjo shpallje paraqet PUBLIKIMIN E KATËRT të thirrjes publike

PËRMBARUES
Vanço Markovski

Në bazë të nenit 17 dhe 19 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore dhe aktiviteve tjera të lira, shkolla fillore komunale “Përparimi” Reçiçë e Madhe, Tetovë publikon :

SHPALLJE PUBLIKE

Për grumbullimin e ofertave për organizimin e ekskursioneve dhe aktiviteve tjera të lira për vitin shkollor 2017/18

- Për realizimin e ekskursionit njëditor për nxënës të klasave III –ta në relacionin Reçiçë e Madhe-Mavrovë
- Për realizimin e ekskursionit njëditor për nxënës të klasave VI-ta dhe IX-ta në relacionin Reçiçë e Madhe-Strugë.

Kohëzgjatja: 1 ditore.

Përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Rregulloren, ofertuesi duhet t'i plotësojë edhe këto kushte:

- Të jetë i regjistruar në përputhje me rregullat e RM për kryerje të veprimtarisë së duhur turistike
- Të ketë të realizuar së paku 3 ekskursione me nxënës dhe aktiviteve tjera të lira në tre vitet e fundit.
- T'i plotësojë kushtet për transport të nxënësve, në përputhje me Ligjin mbi sigurinë në trafik.
- Kriter për zgjedhje të ofertës më të mirë do të jetë çmimi më i ulët dhe plotësimi i kriterëve tjera.

Oferta duhet të përmbajë:

-Çmimin individual dhe të përgjithshëm të shërbimit për maksimum 209 nxënës, mënyra e pagesës, mjeku, udhëheqës.

Ofertuesit ofertat e tyre duhet t'i dorëzojnë në SH.F.K. “Përparimi” Reçiçë e Madhe, Tetovë në afat prej 5 ditëve, llogaritur prej ditës së shpalljes në shtypin ditor.

Dokumentet e pakompletuara si dhe ata të cilat do të dorëzohen pas skadimit të afatit nuk do të shqyrtohen

SH.F.K. “Përparimi”

6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016 dhe 127/2016) Lajmërimin nr. 12-1074/2 të datës 05.02.2018 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së RM dhe Vendimit të u. d. Drejtorit të SHMK Kosta Susinov” nr. vep. 02-200/1 të datës 19.02.2018 shpall:

KONKURS

Për punësim për kohë të caktuar për deri më 31.08.2018

- Mësimdhënës të **gjeografisë** me orar jo të plotë të punës (për 4 orë mësimore) 1-realizues për mësimin në gjuhën turke
- Mësimdhënës të **gjuhës latine** me orar jo të plotë të punës (për 8 orë mësimore) 1-realizues për mësimin në gjuhën maqedonase
- Mësimdhënës të lëndëve profesionale të **drejtimit elektroteknik** me orar të plotë të punës (për 20 orë mësimore) 1- realizues mësimin në gjuhën maqedonase,
- Mësimdhënës të lëndëve profesionale të **drejtimit të elektroteknikës** me orar jo të plotë të punës (për 8 orë mësimore realizues për mësimin në gjuhën maqedonase
- Mësimdhënës të **matematikës** me orar jo të plotë të punës (për 7 orë mësimore) 1- realizues për mësimin në gjuhën maqedonase
- Mësimdhënës të **fizikës** me orar të plotë të punës (për 20 orë mësimore) 1-realizues për mësimin në gjuhën maqedonase
- Mësimdhënës të **gjuhës dhe letërsisë maqedonase** me orar jo të plotë të punës (për 16 orë mësimore) 1-realizues për mësimin në gjuhën maqedonase
- Mësimdhënës të **gjuhës gjermane** me orar jo të plotë të punës (për 10 orë mësimore) 1-realizues për mësimin në gjuhën maqedonase
- Pedagog me orar të plotë të punës (për 40 orë punë) -1 realizues (Pedagogu do të lidhë marrëdhënie pune deri në ditën e marrjes së të punësuarit për kohë të pacaktuar me Marrëveshje për marrëpunëtorit nga shkollë tjetër ose më së voni deri më 31.08.2018)

Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët duhet ti plotësojnë kushtet e parapara nënigj 59 nga Ligji për arsim të mesëm dhe Normativi për kuadër mësimor përkatës në arsimin e mesëm. Shkolla do të organizojë kontroll të mësimdhënësve për sundimin e gjuhës letrare dhe të shkruar në të cilën do të mbahet mësimi. Orari i punës për mësimdhënës dhe pedagogun është pesë ditë pune në javë (prej të hënës deri të premtën). Orari i mësimdhënës është në ndërrime (ndërrimi i parë prej ora 7.30 deri në ora 13.30 dhe ndërrimi i dytë prej 13.30 deri në ora 19.30. Edhe për pedagog orari është në ndërrime, ndërrimi i parë prej ora 7.00 deri në ora 15.00 dhe prej ora 11.30 deri në ora 19.30.

Pagesa bazë - e kuadrit mësimor dhe pedagogut është 21.500,00 denarë. Personi i cili për herë të parë do të punësohen do të ketë rrogë 80 për qind nga pagesa bazë. Ndërsa për mësimdhënësit me orar të plotë të punës pagesa ulet në mënyrë procentuale sipas fondit të orëve.

Kandidatët e paraqitur për kuadrin mësimor dhe pedagog të dorëzojnë dokumentacionin në vijim:

- Lutje (të bashkëngjitur me biografi të shkurtë – CV)
- Dëshmi për arsim të mbaruar përkatës (diplomë apo vërtetim të notarizuar)
- Certifikatë të shtetësisë

Dokumentet e nevojshme të dorëzohen deri të SHMK “Kosta Susinov” Radovish, Kej 8 Shtepmври nr. 8, Radovish (në arkiv). Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor. Zgjedhja e kandidatëve do të realizohet në afat prej 15 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

SHMK “Kosta Susinov” Radovish
U. D Drejtor Goce Dllaz

Në pajtim me nenin 22 dhe nenin 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 143/2014 dhe 167/2015), nenit 80 dhe nenit 82 të Ligjit për arsim fillor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016 dhe 67/2017) si dhe pëlqimit nga MASH (financim i vjetër) për vitin shkollor 2017/2018 nr. 12-10722/2 të datës 07.12.2017, SHF “Goce Dellçev” Demir Hisar publikon

SHPALLJE nr. 2/2018 Për punësim për kohë të caktuar të punës deri më 31.08.2018

- Një mësimdhënës të mësimi klasor me 20 orë mësimore me neto pagesë prej 20.644,00 denarë;
 - Një mësimdhënës të matematikës me 9 orë mësimore me neto pagesë prej 9.300,00 denarë;
 - Një mirëmbajtës të higjienës me 40 orë pune me neto pagesë prej 12.000,00 denarë;
- Fletëparaqitjet me dokumentacionin e nevojshëm kandidatët duhet t'i dorëzojnë në afat prej 5 ditëve të punës prej ditës së publikimit në shtypin ditor ndërsa zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas përfundimit të shpalljes.
- Është e nevojshme që kandidatët të përmbushin kushtet e përgjithshme të parapara me LMP dhe kushtet e posaçme të theksuara në nenin 80 të Ligjit për arsim fillor.
- Orari i punës është paradite (për mësimdhënësit në pajtim me orarin e orëve dhe programit vjetor ndërsa për mirëmbajtësin e higjienës prej ora 06:30 deri në ora 14:30)
- Lutjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrihen në mënyrë të drejtpërdrejtë në shkollë ose në adresën në vijim: SHF “Goce Dellçev” Demir Hisar, rr. Bitollska pn, 7240 Demir Hisar, tel. 047/276331.

UD Drejtor,
Natasha Korunovska

Shes truall të urbanizuar Po+Pr+2 menjëherë në fillim të Industrisë së lehtë “Momin Potok” – Shkup, me sipërfaqe të përgjithshme prej 890 m2 së bashku me objektet ekzistuese prej 180 m2. Çmimi 178.000 euro. Numri i telefonit: 078 – 201 – 960

LIGA E KAMPIONËVE

SEVILJA - MANÇESTER JUNAJTED, PËRBALLJE E TMERRSHME

Gara më e fortë në botë për klube, Liga e Kampionëve, vazhdon edhe sonte, ku në program do të jenë dy ndeshjet e fundit të 1/16 të finales. Sevilja do të pret Mançester Junajtedin, kurse Shakhtari skuadrën italiane Roma

S'ka dyshim se përballja më interesante e natës së sotme do të jetë ajo mes Seviljës dhe Mançester Junajtedit, e cila do të zhvillohet në stadiumin "Ramon Sanchez Pizjuan". Përballje, e cila cilësohet si përballje e tmerrshme. Në prag të kësaj sfide, Murinjo së bashku me grupin e lojtarëve duken të fokusuar për të regjistruar suksesin e radhës që të kalojnë në raundin tjetër. Ende e paqartë mbetet prezenca e Pogbasë, i cili nuk u pa me grupin dhe nuk dihet ende nëse do të jetë apo jo i gatshëm për ndeshjen e sotme. Mesfushori francez mungoi edhe në takimin që Junajted e fitoi 2-0 në FA Kup ndaj Hadersfild në fundjavë. Ndryshe, futbollit të cilin



DYSHET:

SEVILJA - MANÇESTER J.
SHAKHTAR - ROMA

e zhvillojnë futbollistët e Mançester Junajtedit nuk të emocionon shumë, por Hoze Murinjo me Mançester Junajtedin, shihet një nga konkurrentët serioz për trofe. Me lojtarë si Aleksis Sanchez dhe Pol Pogba, fitoret ndaj Seviljës nuk duhet të vihen në diskutim. "Djajtë e kuq" vijnë pas gjashtë fitoreve, dy barazimeve dhe dy humbjeve. Ndërkaq, anëtori i Mançester Junajtedit, Eshli Jang, ka deklaruar se ekipi i tij ka kapacitete të mjaftueshme që të fitojë Ligën e Kampionëve këtë sezon. "Sigurisht që mund të fitojmë. Nuk hyhet në garë për të mos e fituar atë. Këtë do ta synojmë dhe do ta ndjekim çdo ndeshje. E ardhshme është ndaj Seviljës. Kjo është ndeshje e vështirë si te Huddersfild, si te Njukasëll si mysafir. Duhet të koncentrohemi", ka thënë ai për "SkySports". Në anën tjetër, Sevilja ka mundur të marr kundërshtarë edhe më të vështirë se Mançesteri pasi kanë mundur të jenë njëra mes Bajern Muni, Real Madrid dhe Juventus. Forma e tyre



Eshli Jang

Sigurisht që mund të fitojmë. Nuk hyhet në garë për të mos e fituar atë. Këtë do ta synojmë dhe do ta ndjekim çdo ndeshje. E ardhshme është ndaj Seviljës. Kjo është ndeshje e vështirë si te Huddersfild, si te Njukasëll si mysafir. Duhet të koncentrohemi

nuk është e keqe pasi vijnë, sikurse Mançesteri, me 20 pikë të tubuara në 10 ndeshje.

Trajneri i Shakhtar Paulo Fonseca tregtoi së ka skuadër të fortë, kur arriti të dalë nga një grup me klube si Mançester Siti dhe Napoli. Me Romën pritet të jetë një ndeshje e fortë, ndërsa në këtë ndeshjen vijnë pas gjashtë fitoreve, një barazimi dhe tri humbje. Derisa, Roma është klubi më formën më të keqe nga klubet që luajnë në fazën e eliminimit direkt të Ligës së Kampionëve. Nuk duken në garë për titull në Serie A, ndërsa në 10 ndeshjet e fundit kanë tri fitore, tri barazime dhe katër humbje.

GONZALO HIGUAIN KTHEHET SHPEJT

BERNARDESKI HUMB SFIDËN NDAJ TOTENHEMIT

Juventus fitoi derbin kundër Torinos 1-0, duke mbetur në ndjekje të Napoli falë një goli të shënuar në pjesën e parë nga Aleks Sandro, por shqetësuan shumë lëndimet e Gonzalo Higuain dhe Federiko Bernardeski. "Pipita" u detyrua të largohet nga fusha pas vetëm 15 minutash, për shkak të përplasjes me Sirigu, gjë që i shkaktoi atij një dëmtim në kyçin e këmbës. Testet e para treguan një traumë kontuzive (shtrëmbëruese), duke përjashtuar përfshirjen e ligamenteve. Asgjë serioze, veçanërisht për Higuain, i cili duhet të pushojë vetëm ndeshjen e ardhshme të Seria A, ndaj Atalantës. Në profilin e tij në "Instagram", megjithatë, ky lojtar ka shkruar një mesazh të mirë. "Mirëmëngjesi, unë dua t'ju falënderoj të gjithëve: miqtë, shokët, tifozët, njerëzit që nuk e dinë, por dëshirojnë atë që është e mirë për ju. Ju faleminderit shumë të gjithëve. Unë do të kthehem së shpejti për të gëzuar me ekipin dhe me të

gjithë ju", shkroi "Pipita". Sa i përket Bernardeskit, ai filtron vendosmërisht më pak optimizëm të Juventusit. Raporti i parë mjekësor flet për "trauma shtrëmbëruese, përfshirje ligamentare në gjurin e majtë". Sipas "La Gazzetta dello Sport", ish-lojtari i Fiorentinës rrezikon të qëndrojë jashtë për rreth një muaj. Në këtë rast, përtej sfidës së dyfishtë me Atalantën, Bernardeski do të humbasë edhe rikthimin e Ligës së Kampionëve kundër Totenhemit. Priten teste të mëtejshme për të sqaruar shkalën reale të dëmtimit, por përshtypjet e para nuk janë pozitive. Lajmi i keq për Alegrin, i cili sapo kishte gjetur Dybala, pas një ndalimi 40-ditor.





DASHI 21. mars - 20. prill

Perspektivat për jetën sentimentale të çiftëve do jone shumë të mira gjatë kësaj dite. Do iu jepni shumë rëndësi ndjenjave dhe do bëni edhe ndonjë çmenduri të vogël. Beqaret do vazhdojnë të mbeten serish vetëm edhe pse nuk do e ndiejnë shumë vetminë. Për menaxhimin e financave kërkoni ndihmën e eksperteve të fushës dhe mos i besoni askujt tjetër.



DEMI 21. prill - 21. maj

Nuk pritet as problemi me i vogël për jetën tuaj në çift gjatë kësaj dite. Do afroheni me tepër me partnerin dhe do e keni me të lehtë të flisni për gjithçka me të. Beqaret nuk do jone të qarte për ata që duan në të vërtetë prandaj nuk duhet të nxitohen për të marrë vendime. Në planin financiar duhet të dyfishoni kujdesin dhe maturinë. Nuk është koha për investime të mëdha.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Priten ndryshime drastike dot në jetën tuaj në çift kështu që duhet të bëheni gati. Ata që janë me humor të mire do i kalojnë me lehtë vështirësitë që mund t'iu dalin. Beqaret nuk do e kenë aspak mendjen tek dashuria sepse do merren me diçka shumë të rëndësishme. Financat do jone mjaft delikate. Tregohuni të kujdesshëm nëse nuk doni të keni humbje të mëdha.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Jeta sentimentale e çiftëve do ketë përmirësime të ndjeshme gjatë kësaj dite. Do e toleroni me tepër njeri tjetrin dhe do tregoheni me të kuptueshëm. Beqaret do ndihmohen nga Mercuri dhe do e gjejnë personin që do iu përshtatet me tepër. Në planin financiar duhet të shmangni shpenzimet e tejskajshme sepse nuk do arrini dot ta menaxhoni situatën.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Barazia do mbizotërojë gjatë gjithë ditës se sotme në jetën sentimentale të çiftëve. Nuk do kërkoni me shumë sesa jepni dhe çdo gjë do shkojë për mrekulli. Beqaret do hedhin hapat e para drejt një lidhjeje shumë të bukur dhe emocionuese. Në planin financiar duhet gjithë kohës të tregoheni të kujdesshëm. Sikur pak ta tregoni me shpenzimet do keni probleme të mëdha.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Marrëdhënia juaj me partnerin do ketë përmirësime të ndjeshme gjatë kësaj dite. Do i sqaroni me qetësi keqkuptimet dhe do kërkoni falje për ndonjë gabim që mund të keni bërë. Beqaret do jone ndërmjet dy zjarresh dhe nuk do dine nga të kalojnë. Kujdes! Në planin financiar me në fund do keni fat dhe do realizoni të gjitha transaktonet e nevojshme.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Do ëndërroni me shumë sesa duhet sot në jetën tuaj sentimentale dhe kjo mund t'iu përballë me zhgënjime të shumta. Dita nuk do jete aq e mire. Beqaret do kenë ndryshime drastike në jetën e tyre fale disa takimeve impresionuese. Financat do jone shumë të paqëndrueshme kështu që mundohuni të mos shpenzoni me shumë sesa ua mban xhepi.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Gjithë dita do jete e mbushur me emocione të mëdha dhe me kënaqësi sot. Shfrytëzoni sa me shumë që të mundeni sepse nuk vijnë gjithmonë kohe të tilla. Beqaret do vazhdojnë të jone ende në kërkim të shpirtit të tyre binjak dhe nuk do e humbin shpërren deri në sekondën e fundit. Sektori i financave nuk do ketë as problemin me të vogël.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Do tregoheni shumë të arsyeshëm në jetën tuaj në çift dhe nuk do bëni premtime boshë. Marrëdhënia me partnerin do vazhdojë të jete e mire edhe gjatë kësaj dite. Beqaret do kenë takime të shumta dhe do e kenë ata të drejtën për të zgjedhur personin e duhur. Sektori i financave nuk do ketë ndryshime të mëdha. Mundohuni t'i menaxhoni me kujdes të ardhurat.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Dashuria në çift do shkojë me se miri gjatë kësaj dite. Do e kaloni rutinën që iu kishte pushtuar dhe do e shihni më me optimizëm të ardhmen. Beqaret do jone me të privilegjuar dhe do njihen me persona mjaft interesante. Shfrytëzoni ditën! Në planin financiar do jeni shumë të qarte pe rate që duhet të bëni dhe situata do jete e qëndrueshme.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Do iu duhet të merrni disa vendime të rëndësishme sot në jetën tuaj në çift dhe për këtë duhet të mendoheni mire. Askush nuk iu nxiton kështu që harxhoni kohën e duhur. Beqaret që dëshirojnë aventura afatshkurtra do jone të privilegjuar, të tjerët duhet të presin ende. Financat nuk do kenë as problemin me të vogël, kështu që rini të qete në këtë sektor.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Sektori i dashurisë do influencohet pozitivisht nga planetët. Do kaloni momente të paharrueshme në krahët e atij që dashuron dhe asgjë nuk do shkojë keq. Beqaret nuk do e kërkojnë me ngulm personin ideal sepse edhe ashtu si janë nuk po ja kalojnë aq keq. Ekuilibri financiar do jete i turbullt në mëngjes, por me pas do përmirësohet ndjeshëm.



NE KETE DATE

20 DHJETOR 1832
21 SHKURT 1902

KOHA	PERIME TË GJELBRA	SHITJE TË MALLRAVE JASHTE	S.T.	ANGSTREM	METËR PRONAR ÇIFLIGJESH, BEJ	PJESA ORK-ESTRALE E MORIS RAVEL	FJALËT E NGJASHME	EMËR MASH-KULLI IMPULS	BELGJIKË T.N.	UNITED KINGDOM	UJË (turq.) BANOR I KRYEQYTETIT TË KANADASE	AKTORI AMER. PITER LLOJ TEKN. E TRANSM. TË TË DHENAVE	DET I BRENDSHËM NË AZINË QENDRORE	YJET E FILMIT EPOPE	ASSOC. FOR RESEARCH AND ENLIGHT. AUSTRI	KRISËT, PLAS
BESËLIDHJA SHQIPTARE, UDËHEQËS I SË CILËS ISHTE H.Z.																
VEPRIM				ZHDUKJE JO LATIN												CILËSI
R.S. LLOJ DRURI QË RRITET NË INDI			ÇASTET PARA FUNDIT TË JETËS	LIFT												
P					LLOJI NORVEGJI											
VENDLINDJA E H.Z.						FILMI I HALIL BUDAKOVES I PËR-MUAJ-SHËM										
SHKRIN NË UJË					BUKUROSHË SHITËT I MADH AZIATIK											
GRUP ETNIK (lat.)																
KOHA	EMËR FEMRE, HYSNUE KAMPION															
ARSIMIM I MESEM I ORIENTUAR					FLETORË E VOGËL PËR SHËNIME 500 ROMAK											
KOMANDANT I NJË REPARTI TË MADH USHTARAK NË KOHËN E PER. OSMANE																

ZGJIDHJET: IKM, HAMAMET, AKULORE, XHAMADAN, DIDIM, KD, ZENEL, E, EM, TEIN, KISH, BNC, A, KULTI, M, BOLERO, BESA BESË, ABAZ, AKT, ELIMINIM, RS, AGONI, B, UK, PIPAL, SORTA, SU, SHOSHAN, NËNTOKA, TRET, MIS, O TUL, ETNIKUM, ARALI, ISNIJE, DIVAT, AMO, NOTES, ARE, SERDAR, PLASET.

Sudoku

shumë i lehtë

			1		6	3		
	4	9	8	3			2	
3			4					
7		4				5		
4	8	5			1	3	9	
1				9		7		
5			7			8		
		5	6	4	3			
3	4		9					

mesatar

			2	9				
4	8		1	3		9	2	
5			7					3
3	9					8	7	
		5				1		
6	1						4	5
7			2					6
9	6		7	4		5	1	
		6	5					

Shumë i lehtë: 829715643, 654983712, 137246895, 976431258, 485627139, 213859476, 561372984, 798564321, 342198567. Mesatar: 173289564, 486153792, 529476813, 392541687, 845367129, 617892345, 751928345, 751928345, 968734251, 234615978.



APPLE, kujdes nga butoni indian që bllokoi iPhone!

Armiku për iPhone, vjen nëpërmjet aplikacioneve si WhatsApp, iMessage ose edhe mail. Bëhet fjalë për një karakter indian, gjuha 'telugu' për saktësi, e cila godet 'smartphone' me iOS 11.2.5. Ky është një opsion që mund të krijojë probleme, pasi telefoni celular mund të bllokohet duke kërkuar, në rastet më të këqija, rivendosjen e iPhone me rrezikun e humbjes, në rast se nuk e keni bërë më parë një kopje rezervë, të të gjitha të dhënavë. Apple ka

premtuar se do ta zgjidhë defektin me një përditësim tjetër. Nëse marrim karakterin 'vrasës', aplikacioni i hapur do të mbyllet sa herë që përdoruesi përpiqet ta rifillojë atë. Dhe metoda klasike "shutdown and restart" me këtë opsion nuk funksionon. Nëse letra e padëshiruar ofenduese shfaqet nëpërmjet një tabloje njoftimi, telefoni bllokohet. Megjithatë, një zgjidhje, e përhapur në forumet e teknologjisë, këshillohet që të dërgohet një

mesazh që nuk është "i infektuar": në këtë mënyrë mund të kaloni tekstin dashakeqës dhe të fshini të gjithë bisedën. Nëse nuk duam të rrezikojmë të jemi viktimë e ndonjë shkakje të disa miqve, më mirë të çaktivizojmë parashikimet e njoftimeve duke pritur përditësimin e premtuar nga Apple. Ky i fundit, bëjnë të ditur nga kompania, ka lëshuar tashmë një përditësim për PC, veçanërisht për sistemin operativ MacOS 10.13.3. Hig Serra.

"Lind" në laborator njeriu-dele

Grupi i shkencëtarëve të Universitetit të Kalifornisë, që një vit më parë ndërtuan embrionin hibrid mes derrit dhe njeriut, njoftuan në një takim të "Shoqatës Amerikane të Shkencave të Avancuara" se kanë arritur të ndërtojnë një embrion hibrid mes njeriut dhe deles. Sipas tyre, 1 në 10 mijë qeliza të embrionit janë njerëzore, pjesa tjetër janë të deles. Embrioni u shkatërrua pas 28 ditësh, por rezultati, thonë shkencëtarët, është fantastik. "Është një hap gjigant përpara për të mundësuar rritjen e organeve njerëzore tek kafshët dhe më pas përdorimin e tyre për transplant te njeriu", thonë ata. Kjo metodë, sipas Universitetit të Kalifornisë, eliminon dy rreziqet kryesore që hasen deri më tani. Së pari, është refuzimi i organizimit të njeriut ndaj organit të transplantuar të marrë nga një kafshë dhe së dyti, mundësia që njeriu të infektohet me viruse të forta që bartin kafshët. Gjithsesi, për të arritur deri në këtë pikë do të duhen ende disa vite të mira punë.



Pini çaj me banane nëse keni probleme me gjumin

Gjumi është aq i rëndësishëm për shëndetin tuaj në përgjithësi. Pa marrë një pushim të mirë gjatë natës, ju rrezikoni shëndetin të dobët, sëmundje, depresion, tension të lartë dhe energji kronike të ulët. Gjumi është kur truri juaj është "karakterizuar" dhe është i aftë për të kryer aktivitetet tuaja të përditshme. Por për fat të keq për disa njerëz, e kanë të vështirë të flenë, pavarësisht se sa të lodhur mund të jenë. Miliona njerëz në mbarë botën vuajnë nga një lloj

i çrregullimit të gjumit apo gjumit të dobët. Por mos u shqetësoni! Me këtë pije, ju mund të flini gjithë natën dhe për të marrë një relaksim që ju nevojitet për ditë. Bëhet fjalë për çajin me banane. E gjitha çfarë ju duhet është të prini një banane dhe ta vendosni atë në ujë që zien. E lini të vlijë për 10 minuta. Duke përdorur një kullësë, derdhni ujin në një gotë të madhe. Pini një gotë para se të shkoni në shtrat dhe do të keni një gjumë të mirë.

Shkencëtarët krijojnë hibridin e parë njeri-dele

Shkencëtarët kanë krijuar për herë të parë hibridin njeri-dele (pjellë e përzier), kështu duke hapur rrugë për zhvillimin e organeve tek kafshët të cilat mund të transplantohen tek njerëzit. Projekti i suksesshëm i Universitetit "Stanford" mund të hapë dyer për gjetjen e kurave për diabetin e tipit 1 duke krijuar pankreas të shëndetshëm, me qëllim të rregullimit të sheqerit në gjak. Shkencëtarët më parë kishin zhvilluar hibrid njeri-derr, mirëpo ende askush nuk ka shkuar një hap përpara për të zhvilluar organet njerëzore. Megjithatë ekipi nga Stanford, që tashmë kanë kryer me sukses transplantimin e pankreasit tek minjtë, besohet se do të jenë të parët në këtë fushë. Ky zbulim gjithashtu mund të ndihmojë me mungesën e organeve për transplant në tërë botën.


- 362 - Athanasi kthehet në Aleksandri.
1431 - Anglia fillon gjykimin kundër Xhoanit të Arkut.
1440 - Formohet Konfederata Prusiane.
1613 - Mihail Romanov, biri i Patriarkut të Moskës, zgjidhet Car i Rusisë.
1874 - Benjamin Disraeli zëvendëson William Gladstone si Kryeministër i Anglisë.
1918 - Trupat australiane dëbojnë trupat turk nga Xheriko, Palestinën holandeze.
1919 - Grevë revolucionare në Barcelonë.
1922 - Britania e Madhe pranon pavarësinë e Egjiptit.
1937 - Lidhja e Kombeve ndalon "vullnetarët" e nacionaliteteve të huaja të marrin pjesë në Luftën Civile në Spanjë.
1946 - Demonstrata anti britanike në Egjipt.
1972 - Richard Nixon bëhet kryetari i parë amerikan që viziton Kinën.



Në fakt, 1% e njerëzve më të pasur të botës kanë më shumë pasuri se e gjithë pjesa tjetër e njerëzimit, të dhëna këto të publikuara nga Oxfam, një organizatë jofitimprurëse, e cila ka si qëllim kryesor që të ulë nivelin e lartë të varfërisë që ekziston në botë. Raporti, nën titullin "Vlerësoni punën jo pasurinë", nxori në pah një tablo edhe më të zymtë të pabarazisë që ekziston midis më të pasurve dhe më të varfërve. Që të ulin nivelin e lartë të varfërisë në botë, ne duhet të ulin njëkohësisht edhe nivelin e më të pasurve në botë, thuhej ndër të tjera në raportin e Oxfam-it. Qeveritë e vendeve të ndryshme duhet të vendosin rregullore dhe taksim për të ulur nivelin e pasurisë ekstreme, si edhe të kufizojnë ndikimin e individëve apo klaneve të pasura në politikbërje.

BURRI DHE PSIKIATRI

I ankohet burri psikiatrit:
- Më ndihmo doktor, nuk mund ta shoh më me sy gruan time!
- Po e shoh se paskan përfunduar ditët e mira në lidhjen tuaj. Gjërat do të bëhen keq e më keq. Mendoj se do t'ju ndihmonte nëse shkoni në det.
- Jo bre doktor. E keqja është se ajo di not.



Shenja e vërtetë e inteligjencës nuk është njohuria, por imagjinata!
(Albert Ajnshtajn)